
ENVER
HOXHA

The electronic version of the book is created by
http://www.enverhoxha.ru

Juve Hoxha

ENVER HOXHA
1908 — 1985

Botim i Institutit të Studimeve
Marksiste-leniniste pranë
KQ të PPSH

KOMISIONI REDAKTUES

Prof. Foto Çami - Kryetar,
Prof. Sofokli Lazri, Leka Shkurti,
Prof. Agim Popa, Anastas Kondo,
Sevo Tarifa, Prof. Raqi Madhi,
Prof. Vangjel Moisiu, Spiro Dede,
Ajet Simixhiu

GRUPI I PERGATITJES

Spiro Dede, Tatjana Hoxha,
Sulo Gradeci, Fatri Sinani,
Kujtim Ymeri, Nasi Lera

PARAQITJA GRAFIKE

Ksenofon Dilo (Piktor i merituar),
Artion Baboçi, Petrit Kumi,
Pëllumb Aliaj

Fëmijëria dhe rinia

Në lëvizjen komuniste

Në vitet
e Luftës Nacionalçlirimtare

Themeluesi i Shqipërisë së re

Arkitekt i socializmit



ENVER HOXHA-FLAMURI I LUFTES PER LIRI E SOCIALIZEM

RAMIZ ALIA
SEKRETAR I PARE I KQ TE PPSH

Ashtu sikurse duken më mirë në horizont lartësitë e maleve kur largohesh prej tyre, po ashtu rriten dhe bëhen më madhështore figurat e njerëzve të shquar si Enveri, sa më shumë kohë që kalon nga ndarja me ta. Biografia e njerëzve të tillë, që vijnë në jetën e shoqërisë me misione të mëdha, është e shkrirë me historinë e epokave që i lindin, të popujve që u bëhen interpretë dhe të lëvizjeve që u prijnë.

Në figurën e Enver Hoxhës është mishëruar tërë pasuria shpirtërore e popullit tonë. Ai trashëgoi e personifikoi virtytet më të mira të luftëtarëve të përmendur shqiptarë të së kaluarës dhe u bashkoi atyre cilësinë e re të udhëheqësit komunist. Figura e Tij është harmonizim i shkëlqyer i trimërisë dhe i mençurisë, i qëndresës dhe i shpirtit krijues të popullit tonë.

Në shembullin e ndritur të Enver Hoxhës historia provoi edhe një herë të vërtetën e madhe marksiste që asnjë udhëheqës nuk mund të ngrihet në lartësinë e kërkesave të kohës pa pasur rrënjë të thella në popull, pa fituar besimin dhe mbështetjen totale të masave punonjëse. Enver Hoxha u bë një udhëheqës i madh popullor, pse e donte

me gjithë forcën e shpirtit të Tij popullin që e lindi, pse tërë veprimtarinë e vet kolosale revolucionare e vuri në shërbim të lumturisë së masave dhe të përparimit të Shqipërisë.

Emri i Enver Hoxhës është i pandarë nga ai i Partisë që krijoi dhe udhëhoqi për afro gjysmë shekulli. Kur Shqipëria ndodhej në udhëkryq të historisë, kur në pikëpyetje ishte vënë vetë ekzistenca e popullit dhe e kombit shqiptar, situatën e rëndë e ndienin shumë shqiptarë, por të paktë qenë ata që mundën të shikojnë përtej robërisë së zezë ditët e ardhshme të lirisë dhe të begatisë. Mijëra e mijëra ishin patriotët e luftëtarët e ndershëm, që për lirinë e Atdheut nuk u mungonte gatishmëria për të bërë çdo sakrificë, por pak prej tyre mundën ta kuptojnë se ç'i nevojitej luftës së popullit për të arritur fitoren. Enver Hoxha ishte i pari që pa nevojën e domosdoshme të krijimit të Partisë Komuniste, si hallkë kryesore për të shpëtuar Atdheun dhe për të nxjerrë popullin në dritë.

Krijimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë në ato kohë të errëta dhe të turbullta të fillimit të viteve dyzet është një nga aktet shembullore të guximit ideologjik e politik të shokut Enver Hoxha. Nuk ishte e lehtë t'i dilje zot një Shqipërie të tretur nga varfëria, të plaçkitur dhe të pushtuar nga të huajt,siç ishte vendi ynë në ato vite. Nuk ishte e lehtë që të merrje në dorë fatet e popullit dhe të Atdheut pikërisht në momentet më tragjike, më të rënda të jetës së tyre, kur ata u gjendën të braktisur, në qorrsokak e të çoroditur. Vetëm një njeri që ka bindje të patundur në idealin e vet e në fitoren përfundimtare, që ka besim te populli e te flamuri i komunizmit, mund të merrte mbi vete një përgjegjësi të madhe historike, t'u printe masave në luftën për lirinë e Atdheut e për socializmin.

Enver Hoxha projektoi e ndërtoi Shqipërinë e re, Shqipërinë e popullit, Shqipërinë socialiste. Ai jo vetëm e parashikoi dhe e ideoi rrugën që do të ndiqte dhe pamjen që do të merrte Atdheu ynë, por dhe u vu në ballë të luftës e të përpjekjeve të popullit për të bërë realitet ëndrrat dhe aspiratat më të guximshme të të gjithë brezave.

Shoku Enver Hoxha i udhëhoqi popullin dhe Partinë për gati 50 vjet, por e çoi përpara Atdheun me shekuj të tërë. Ai i priu popullit në dy epope të mëdha: në Luftën Nacionalçlirimtare, që përmbysi botën e vjetër të shtypjes dhe shfrytëzimit e i dha popullit shqiptar pushtetin e vet, dhe në luftën për ndërtimin e shoqërisë së re, socializmit ngadhënjimtar. Enveri i udhëhoqi Partinë dhe popullin në shtigje të panjohura, në luftën për industrializi-

min e vendit, për modernizimin e bujqësisë, për lulëzimin e arsimit, të kulturës, artit e shkencës shqiptare. Mbrojtja jonë e pathyeshme është, gjithashtu, vepër e Tij. Ai i mësoi Partinë e popullin tonë të mbështeten në forcat e veta. Duke e zbatuar në çdo etapë këtë parim, Shqipëria jonë bëri një kapërcim të pashembullt nga errësira në dritë, nga feudalizmi në socializëm. Epoka e Partisë dhe e Enver Hoxhës është epoka që rilindi vendin, rilindi njeriun dhe hapi horizonte të pakufishme jete dhe krijimtarie.

Të gjitha zhvillimet politiko-ideologjike, morale e materiale të shoqërisë sonë socialiste, bazën dhe frymëzimin e kanë tek idetë marksiste-leniniste të shokut Enver. Ato janë ide që orientojnë drejt zhvillimesh të reja, më të larta; ide që shikojnë nga e ardhmja dhe ndihmojnë për të ecur drejt saj në mënyrë të sigurt. Populli dhe Partia jonë ato do t'i kenë kurdoherë busull orientimi, udhëheqje për veprim.

Shoku Enver nuk e mësoi komunizmin shkencor në shkolla, në kurse apo në akademi. Si komunist e revolucionar Atë e lindi dhe e rriti shekulli i luftërave të popullit shqiptar për të dalë në dritë të lirisë, e mbrujtën betejat klasore të proletariatit botëror për drejtësi e progres shoqëror. Komunizmi e shkenca marksiste-leniniste gjetën tek Enver Hoxha njeriun e përgatitur e të ditur, të pajisur me cilësitë dhe virtytet e nevojshme për t'i propaganduar, për t'i mbrojtur dhe për t'i zbatuar ato me konsekuencë në realitetin shqiptar.

Në tërë Veprën e shokut Enver është karakteristike uniteti i thellësisë së mendimit me thjeshtësinë e shprehjes. Kjo cilësi e bën Veprën e Tij të kuptueshme për të gjitha kategoritë e punonjësve. Enveri i urrente pompozitetin dhe frazën e fryrë. Në Veprën e Tij teorike nuk ka përkufizime dhe formulime kategorike, si në tekstet shkollore. Ai ishte mendimtar e filozof i shquar marksist, dhe, si i tillë, një armik i papajtueshëm i abstragimeve boshe dhe i teorizimeve akademike.

Shoku Enver kishte një aftësi të veçantë përgjithësuese dhe nxirrte konkluzione shumë të rëndësishme edhe nga një veprim i thjeshtë i praktikës revolucionare të masave. Ai, duke vëzhguar dhe studiuar zhvillimin e lëvizjes së sotme revolucionare, gjendjen ndërkombëtare dhe procesin dialektik të përparimit të shoqërisë shqiptare, trajtoi me kompetencë të plotë shkencore një sërë çështjesh kapitale të revolucionit botëror dhe të ndërtimit socialist në Shqipëri. Mendimi i Tij marksist ka zënë vend si gur i rëndë në çështje të filozofisë e të politikës, të ideo-

logjisë e të ekonomisë, të kulturës e të artit, në çështjet ushtarake dhe në ato ndërkombëtare.

Figura e shokut Enver përfaqëson një shkrirje organike të virtyteve njerëzore. Tek Ai ishin kombinuar në mënyrë të përsosur fisnikëria e idealeve për të cilat luftonte, me ndjenjat e holla dhe bukurinë e Tij shpirtërore. Zemra dhe tërë qenia e Tij reagonte me një humanizëm të thellë ndaj të gjitha ndjenjave dhe shqetësimeve të jetës së popullit. Shoku Enver gëzohej e lumturohej si për vënien në shfrytëzim të një kombinati gjigant, ashtu edhe për lindjen e një qytetari të ri të Republikës; si për prodhimin e grushtit të parë të superfosfatit, ashtu edhe për daljen e një kënge të re. Ai mendonte, projektonte dhe punonte për të ardhmen e lulëzimin e Atdheut, siç kujdesej për kushtet e jetesës të një pensionisti ose të një shtëpie fëmijësh. Ai shqetësohej për çdo mungesë, për çdo dobësi e pakujdesi që pengonte punën, por nuk e zinte gjumi edhe për shëndetin e një shoku. Në figurën e Tij ishin shkrirë në një preokupimet madhore për fatet e Atdheut e të socializmit, me shqetësimin njerëzor për hallet e çdo punonjësi të thjeshtë.

Devocioni ndaj çështjes së popullit e të Atdheut, besnikëria ndaj Partisë dhe konsekuenca ndaj marksizëm-leninizmit, kanë qenë faktorët më të rëndësishëm që bënë të dalloheshin te shoku Enver mendimi i thellë e gjykimi i shëndoshë, largpamësia, urtësia dhe durimi në përgjithësi, guximi dhe trimëria kur duhej guxim e trimëri, por edhe rreptësia kur duhej rreptësi.

Në udhën e saj të lirisë, të pavarësisë së vërtetë dhe të përparimit të pandalshëm shoqëror, Shqipëria e vogël ka ndeshur në vështirësi të panumërta dhe në pengesa të mëdha, në armiq të tërbuar, të egër e dinakë. Por, sa herë që shfaqej rreziku, ishte Enver Hoxha që dilte në ballë të furtunës, ishte Ai që largonte retë e zymta nga horizonti, ishte Ai që ngrinte popullin në këmbë dhe e mbushte atë plot besim e optimizëm. Siç ishte i dashur me popullin, me revolucionarët dhe njerëzit e ndershëm kudo në botë, ashtu ishte i rreptë dhe i prerë me armiqtë, provokatorët, njerëzit e errësirës e të kundërrevolucionit.

Partia e Punës e Shqipërisë me Enver Hoxhën në krye nuk ka bërë kurrë tregti me parimet. Ajo ka demaskuar me një guxim të pashoq politikën agresive të superfuqive, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, u ka çjerrë maskën revizionistëve modernë të të gjitha ngjyrave, hrushovianë, titistë, eurokomunistë e kinezë. Kjo luftë e një rëndësie të jashtëza-

konshme përbën një faqe të ndritur në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Tek Enver Hoxha komunistët e revolucionarët e vërtetë të të gjitha kontinenteve kanë pasur një mik të madh internacionalist dhe një përkrahës të tyre të flaktë. Ja përse ata shkruajnë e flasin me respekt e dashuri për udhëheqësin tonë të lavdishëm.

Fjala dhe mendimi i shokut Enver, direktivat dhe programet që formulonte Ai, përfaqësonin sintezën e mendimit kolegjial të Partisë. Në fjalimet dhe në diskutimet e Tij, shoku Enver nuk bënte gjë tjetër veçse u kthente Partisë dhe popullit mendimin e tyre, të shfaqur e të tërhequr në formën më demokratike, më të drejtpërdrejtë, të sintetizuar dhe të përgjithësuar nga Ai. Uniteti në mendime dhe në veprime i Partisë me shokun Enver buronte nga kjo lidhje e përhershme, që ishte pjesë e metodës së Tij të punës. Ashtu sikurse populli dhe Partia e dëgjonin me vëmendje fjalën e shokut Enver dhe hidheshin në sulm e në aksione për ta vënë në jetë, ashtu dhe Ai e kërkonte me insistim, në mbledhje pune e në kontakte të rastit, fjalën dhe mendimin e shokëve.

Eshtë vështirë të dallosh te figura komplekse e shokut Enver se ç'tipar i Tij ishte kryesor, se ç'anë e Tij ishte përcaktuese. Ai ishte edhe udhëheqës i tipit të ri, edhe burrë shteti i shquar, edhe diplomat i madh, edhe organizator i përsosur, edhe ideolog novator, edhe politikan mendjemprehtë, edhe reformator i jetës shoqërore, edhe arkitekt i ndërtimit socialist. Por ka një veti që karakterizon tërë qenien e Tij: dashuria për popullin. Shoku Enver nuk lindi burrë shteti — dashuria për popullin e për Atdheun e bëri të tillë. Shoku Enver nuk bëri shkollë diplomacie — detyrimi ndaj Shqipërisë e bëri të tillë. Shoku Enver nuk është ideolog e mendimtar i dalë nga aulat e universiteteve — devocioni ndaj kauzës së revolucionit e armatosi me këtë cilësi. Shoku Enver shkollën e organizatorit komunist e kreu në aksionet e luftës partizane për lirinë e pavarësinë e Atdheut dhe në betejat e mëdha të ndërtimit socialist.

Figura e Enver Hoxhës përfaqëson një figurë me vlera të mëdha shoqërore. Komunistët, kuadrot, tërë njerëzit tanë, duhet të mësojnë jo vetëm nga Vepra teorike, por edhe nga veprimtaria e Tij praktike si udhëheqës e si njeri. Ata duhet të mësojnë si ta duan e të jetojnë me popullin, si t'i kuptojnë e t'i zgjidhin hallet e tij; të mësojnë si ta duan e ta mbrojnë Atdheun, si të luftojnë për lumturinë e përparimin e tij, si të ruajnë e të zhvillojnë kurdoherë frymën revolucionare e internacionaliste. Të gjithë duhet të

mësojmë të mos trembemi nga asnjë vështirësi, siç nuk trembej shoku Enver; të orientohemi drejt e pa gabuar në çdo situatë, siç orientohej Ai; t'i organizojmë e drejtojmë punët me dije e kulturë, ashtu si Ai; të jemi kurdoherë përparimtarë e të luftojmë për të renë, siç luftonte Ai; të jemi përherë në sulm, novatorë e vigjilentë ndaj armiqve të klasës, të na rrahë zemra për Atdheun e komunizmin, ashtu siç i rrihte shokut Enver.

Brezi ynë, brezat e sotëm, janë të lumtur që u takoi nderi të jenë bashkëkohës dhe bashkëluftëtarë, secili në frontin e vet, të këtij heroi legjendar dhe mësuesi të pavdekshëm. Por njerëzve tanë dhe brezave që do të vijnë u ka takuar edhe një nder tjetër po aq i madh, nderi i luftëtarëve që do ta çojnë akoma më përpara Veprën e shokut Enver, duke e realizuar plotësisht betimin e shenjtë që kanë bërë Partia dhe populli për ta mbajtur përherë të kuqe Shqipërinë, për ta ruajtur si sytë e ballit unitetin, për të ecur gjithmonë vetëm përpara në rrugën e komunizmit.

Udhëheqës të tillë si Enver Hoxha i lindin epokat dhe kanë përmasa epokale. Ashtu sikurse s'kanë harrim kurrë epokat historike, ashtu mbijetojnë, nderohen dhe respektohen përjetë heronjtë e tyre. Populli ynë është krenar që sa herë do të përmendet emri i këtij biri të lavdishëm të tij, kudo në botë, do të nënkuptohet Shqipëria, komunizmi, liria dhe pavarësia e vërtetë.

Pesëqind vjet populli ynë mbajti gjallë figurën legjendare të Skënderbeut dhe u mbajt gjallë prej saj. Në momentet më dramatike për jetën e kombit, patriotët, demokratët dhe revolucionarët shqiptarë iu drejtuan kësaj figure, e evokuan atë, e bënë flamur betejash të mëdha. Dhe Skënderbeu i ndihmoi.

Ashtu si luftërat dhe bëmat e Skënderbeut kanë frymëzuar atdhedashurinë dhe shpirtin e qëndresës të shqiptarit, emri dhe Vepra e Enver Hoxhës, në shekuj, do të jenë flamur i luftërave të popullit tonë për socializmin dhe begatinë e Atdheut. Shoku Enver Hoxha, me Veprën e vet madhështore, do të frymëzojë gjithmonë komunistët e popullin për punë të mëdha, për progres të pandalshëm. Ai do të jetë gjithnjë i pranishëm në gëzimet e në preokupimet e shoqërisë sonë. Brezat e sotëm dhe të ardhshëm do të udhëhiqen nga mësimet e Tij. Përpara çdo çështjeje të madhe, përpara çdo vështirësie e pengese, ata do të kërkojnë këshillën e Enverit.

Dhe Enveri do t'i ndihmojë. Ai do t'u japë përgjigje me Veprën e Tij.

"Qyteti im i dashur, ku kam lindur, të jam mirënjohës për jetë, pse ti më rrite, ti më mësove, ti më dhe forcë të kryej detyrën ndaj atdheut dhe të luftoj për fitoren e atyre që shtypeshin, e atyre që vuanin nga mjerimet dhe nga uria" ENVER HOXHA

Pamje nga Gjirokastra.

1



2

3

1. Shtëpia ku lindi Enver Hoxha (e restauruar). **2.** Halil Hoxha. **3.** Gjylo Hoxha. **4.** Pjesëtarë të Kuvendit të Vlorës më 1912. Sipër, në radhën e dytë, nga e majta në të djathtë, i gjashti — Hysen Hoxha. **5.** Çeta kryengritëse në Cepo të Gjirokastrës më 1912. **6.** Hysen Hoxha.

Enver Hoxha lindi më 16 tetor 1908 në një familje atdhetare gjirokastrite. Nëna e Tij, Gjyloja, ishte një grua e thjeshtë e popullit, babai, Halili, që kishte njohur, para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, vuajtjet e emigrantit ekonomik, me të ardhurat e pakta të një nëpunësi të vogël përballonte me vështirësi nevojat e familjes dhe shpenzimet për rritjen dhe arsimimin e pesë fëmijëve. Në qytetin e Tij të lindjes, në një ambient të lidhur ngushtë me luftërat për çlirimin kombëtar dhe përparimin e Shqipërisë, Enver Hoxha kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme.

4

5



6

Më 28 Nëntor 1912 luftërat e pareshtura për liri kundër pushtimit osman u kurorëzuan me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Kuvendin e Vlorës. Në këtë ngjarje të madhe mori pjesë si delegat i Gjirokastrës edhe xhaxhai i Enver Hoxhës, Hysen Hoxha, atdhetar i njohur e me autoritet, kryetar i disa shoqërive patriotike e kulturore të qytetit, iniciator i shkollës së parë shqipe në Gjirokastër. Hysen Hoxha luajti një rol të ndieshëm në edukimin qytetar e atdhetar të Enver Hoxhës veçanërisht gjatë mungesës së babait të Tij, kur ky ndodhej në emigracion ekonomik në SHBA.

1

2

Numër rendor	Emën e mbiemën, besim, datë e vendi i lindjes, banim i nxânësit dhe i prindëvet a i mprojtësit të tij	Datë e të hymit në shkollë	Datë e të hymit në klasë	Klasë	numër renduer i regjistrit të përdite-shëm	sjellë	zell	besim	mësim shëkimi	këndim	shkrim e orthografi	ushtrime gramatikore	hartim	gluhë e huaj	arithmetikë e gjeometri	histori natyre	dituni natyre	gjeografi	histori	kaligrafi	vizatim	kângë	gymnastikë	punë dore	bulgësi
81	Enver Hoxha Mehmed Lindur në Gjirokastër më 16-X-1908 në Gjirokastër Jalonte Hafiz Hoxha Jalonte	1921		I																					
				II																					
				III																					
				IV																					
				V	4																				
				VI	3	1	1	1	2	2	1	1	2	1	1	1	1	1	2	2	-	2	-	1	

3

Në mars 1913, vetëm tre muaj e gjysmë pas Shpalljes së Pavarësisë, Gjirokastra dhe krahinat përreth u pushtuan nga shovinistët grekë, që u zëvendësuan 3 vjet më vonë nga imperialistët italianë. Enver Hoxha do ta kalonte fëmijërinë nën regjimin e pushtimit (1913-1919), në mes qëndresës së përhershme popullore, e cila u kurorëzua nga Lufta e Vlorës më 1920 me çlirimin e territoreve të pushtuara nga të huajt. Qysh nga kjo periudhë, përmes ngjarjeve dramatike dhe përpjekjeve për liri e për ruajtjen e tërësisë tokësore të vendit, u rrënjos tek Enver Hoxha i ri dashuria e madhe për atdheun, për lirinë e pavarësinë e tij.

4

6

5

1. Forca ushtarake të pushtimit në Kalanë e Gjirokastrës gjatë Luftës së Parë Botërore. **2.** Enver Hoxha nxënës në Liceun francez të Gjirokastrës. Viti shkollor 1923-1924. **3.** Fleta e amzës me notat e tremujorit të parë të klasës së 5-të të shkollës qytetëse. **4.** Nxënës dhe mësues të shkollës "Drita". 1. 7. 1921. Në rreshtin e fundit, nga e djathta në të majtë, i katërti — Enver Hoxha. **5.** Shkolla "Drita". (Ndërtesa majtas. Viti 1920).

Në vitet 1917-1923 Enver Hoxha ndoqi mësimet në shkollën qytetëse "Drita", që u hap me përpjekjet e atdhetarëve gjirokastritë në kushtet e rënda të pushtimit italian. Bashkë me hapat e parë në rrugën e diturisë, i riu Enver Hoxha në këto vite njohu edhe ngjarjet e mëdha të lëvizjes demokratike të 1920-1924-s, që lanë mbresa të pashlyeshme tek Ai.

1

2

3

1. Enver Hoxha — i treti, nga e djathta në të majtë — në mes të afërmve dhe pjesëtarëve të familjes së Tij. Viti 1926. **2.** Pjesëtarë të grupit teatral të shoqërisë "Studenti" të Gjirokastrës. Në rreshtin e parë, i pari nga e djathta — Enver Hoxha. **3.** Enver Hoxha në vitin shkollor 1926-1927. **4.** Nxënës dhe mësues të Liceut francez të Gjirokastrës gjatë një ekskursioni. Majtas, në rreshtin e fundit, i dyti, nga e majta në të djathtë - Enver Hoxha. Viti 1924. **5.** Me nxënës dhe mësues të Liceut të Gjirokastrës. Në rreshtin e dytë, i treti, nga e djathta në të majtë — Enver Hoxha. **6.** Nxënës dhe mësues të Liceut të Gjirokastrës. Në rreshtin e dytë, i treti, nga e majta në të djathtë — Enver Hoxha.

Pasi përfundoi shkollën qytetëse "Drita" (1917-1923) Enver Hoxha vazhdoi studimet në Liceun francez, të sapoçelur në Gjirokastër (1923-1927). Në këtë periudhë, nxënës i zellshëm, i etur për dije e kulturë, Ai u formua edhe si një i ri demokrat revolucionar. Admirues i Avni Rustemit, simpatizues i shoqërisë përparimtare "Bashkimi", i revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit 1924, Enver Hoxha, pas kthesës kundërrevolucionare dhe ardhjes në fuqi të A. Zogut (dhjetor 1924), do të rreshtohej me forcat kundërshtare të regjimit obskurantist e mesjetar që sundonte në Shqipëri.

"... për ditë me radhë këndonim në frëngjisht. . . ç'kishte ngjarë në Rusi. Një botë e re filloi të agonte në trurin tim të ri. Ishte shkëndija e parë e një zjarri të madh, që më ndriti në shtëpinë e një proletari të varfër. . . Duhej të ishte viti 1926".

Enver Hoxha

5

4

6

16-vjeçari Enver Hoxha ishte ndër iniciatorët dhe sekretar i shoqërisë "Studenti" të Gjirokastrës, që u krijua në ditët e para të korrikut 1924. Kjo shoqëri, me veprimtarinë e vet kulturore-artistike, evokonte dashurinë për atdheun, për lirinë dhe demokracinë. Kur elementët reaksionarë, pas vendosjes së sundimit zogist, kërkuan mbylljen e klubit "Studenti", Enver Hoxha ishte në krye të revoltës të nxënësve përparimtarë. Në vitin 1926 Enver Hoxha, i cili në bankat e shkollës ishte njohur dhe entuziazmuar me Revolucionin Francez të shekullit të 18-të, ra për herë të parë në kontakt me idetë e Revolucionit Socialist të Tetorit, që kishin depërtuar prej vitesh në Shqipëri. Këto ide, që përfaqësonin një botë të re, një ideologji të re — komunizmin, u rrënjosën më the-Më, në ndërgjegjen e Enver Hoxhës gjatë vazhdimit e përfundimit të studimeve të mesme në Korçë (1927-1930).

1

''Kur na doli bursa për në Korçë, gëzimi im ishte i madh, i papërshkruar . . . Po hapej një faqe e re e jetës sime, me shpresa të mëdha, me ëndrra të bukura, me mendime dhe me një ndjenjë përgjegjësie më të madhe për detyrat e mia të djalërisë ndaj familjes dhe atdheut''.



2

1. Pas përfundimit të vitit të tretë të Liceut francez të Gjirokastrës. 18. 6. 1927.
2. Korça në vitet '30.

"Liceu i Korçës ishte një qendër përparimtare dhe revolucionare . . . nga çka mësonim dhe lexonim atje, ne armatoseshim kundër regjimit feudal . . ."

Enver Hoxha

2

1

3

1. Pamje e godinës së Liceut të Korçës. **2.** Me studentë gjirokastritë në Liceun e Korçës. Në rreshtin e dytë, nga e djathta në të majtë, i treti — Enver Hoxha. Mars 1928. **3.** Me një grup shokësh në oborrin e konviktit të shtetit në Korçë. I katërti, nga e majta në të djathtë — Enver Hoxha.**4.** Nxënës në klasën e 2-të të Liceut të Korçës. Viti 1927. Nga e djathta — Enver Hoxha me Elmaz Konjarin. **5.** Nxënës i kursit të filozofisë të Liceut të Korçës. 6. Dyqani i Koci Bakos në Korçë.

Ndjekja e mësimeve në Liceun francez të Korçës luajti rol të rëndësishëm në edukimin e të riut Enver Hoxha me ide përparimtare e revolucionare. Veprat e rilindësve tanë dhe të letërsisë së huaj demokratike e përparimtare, me të cilat u njoh këtu, rrënjosën më thellë tek Ai dashurinë për gjuhën shqipe, për thesarët kulturorë të atdheut dhe për kulturën e madhe progresiste e revolucionare botërore. Historia e revolucioneve franceze ishte për Enver Hoxhën e për liceistët e tjerë, bij të popullit, një mësim i madh që u shtonte urrejtjen dhe i përgatiste për luftë kundër regjimit feudal të Zogut.



4

5

6

Korça e viteve 1927-1930 ishte për Shqipërinë e asaj kohe një qendër e madhe qytetare, me një klasë punëtore relativisht të zhvilluar dhe nga më revolucionaret, elementë të së cilës kishin përqafuar idetë e komunizmit dhe kishin krijuar në vitin 1927 bërthamën e grupit të ardhshëm komunist "Puna" (Grupi Komunist i Korçës). Në këtë qytet demokrati revolucionar Enver Hoxha e ndien veten pranë punëtorëve të guximshëm e të përparuar korçarë dhe lidhet për herë të parë me lëvizjen komuniste shqiptare. "Manifesti i Partisë Komuniste", që punëtori komunist Koci Bako ia dha të shoqëruar me porosinë: "Këndoje, përktheje, mbaje fshehur dhe ma kthe prapë", vepra të tjera të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe komunistët shqiptarë i dhanë Enver Hoxhës atë orientim, që do të bëhej qëllimi më i madh dhe i vetëm i jetës së Tij.

1

2

3

1. Në vitin e fundit të studimeve në Liceun e Korçës. 2. Në shkallët e bibliotekës së Korçës. Viti 1930. Nga e majta në të djathtë, i pesti — Enver Hoxha. 3. Liceistë në kohën e lirë në kodrat rreth qytetit të Korçës. Në rreshtin e tretë, i pari nga e majta — Enver Hoxha. 4. Në vitin 1930. 5. Në vitin e parë të studimeve në Monpelje. Majtas — Enver Hoxha me Abaz Xhomon. 6. Me studentë të huaj dhe shqiptarë në Monpelje. Viti 1933. I pari nga e majta — Enver Hoxha. 7. Monpeljeja, e famshme për universitetin e saj.

Në verën e vitit 1930 Enver Hoxha përfundoi me rezultate të larta studimet në Liceun e Korçës. Pas shumë përpjekjesh, në tetor 1930 iu dha e drejta për të vazhduar me bursë studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Monpeljesë në Francë. Në pamundësi për të ndjekur me shpenzimet e veta studimet e larta për shkencat shoqërore, ashtu siç dëshironte, Enver Hoxha u fut në fakultetin, për të cilin iu dha bursa.

4



5



6

7

Enver Hoxha u regjistrua dhe filloi studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por pasion i Tij mbetën shkencat shoqërore. Gjatë viteve të studimit në Monpelje Ai i kushtoi mjaft kohë studimit të veprave letrare, historike, filozofike e, në mënyrë të veçantë, studimit të literaturës marksiste-leniniste dhe ndoqi leksione e konferenca në klubet punëtore të drejtuara nga PK e Francës.

1

2



3

Pushimet verore gjatë viteve të shkollës Enver Hoxha i kalonte në vendlindje. Çmallej me prindërit, motrat, të afërmit e me shokët që i donte dhe i çmonte shumë. Ai vlerësonte te shokët nder-shmërinë, zgjuarsinë, vullnetin për të mësuar e, mbi të gjitha, de-votshmërinë për t'i shërbyer atdheut.



4

5

1. Mes pjesëtarëve të familjes në Gjirokastër. **2.** Me një grup shokësh në fshatrat e krahinës së Lunxhërisë të Gjirokastrës. Nga e majta në të djathtë i dyti — Enver Hoxha. **3.** Me motrën Sanon. **4.** Student në Monpelje. Viti 1933. **5.** Enver Hoxha me një shokun e tij student.

Në nëntor të vitit 1933 qeveria zogiste i preu bursën Enver Hoxhës. Pas orvatjeve të pasuksesshme për të gjetur ndonjë punë që të mund të vazhdonte studimet, Enver Hoxha largohet nga Monpeljeja dhe shkon në Paris, me shpresën për të gjetur punë dhe për të vazhduar atje Fakultetin e Drejtësisë.



MBRETNIJA SHQIPTARE
MINISTRIJA E ARSIMIT

Tiranë, më 6/II/ 1934

Nr. 3121/II ex 33

Shkurtimi:

Këshillit Kontrpllues.

Tiranë.

Lutemi të merrni shenim se, me fund Mars 1934 i pritet bursa definitivisht studentit Enver Hoxha në Francë.

Ministri i Arsimit:

KONTROLUES

Nr. 286

2

3

1

1. Enver Hoxha. **2.** Faksimile e vendimit për prerjen e bursës. **3.** Pamje e një mitingu të punëtorëve parizianë. **4.** Punonjës i Konsullatës Shqiptare në Bruksel. **5.** Faksimile e dokumentit të regjistrimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Lirë të Belgjikës në Bruksel. **6.** Me një bashkatdhetar në Anversë, Belgjikë. **7.** Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Lirë të Belgjikës në Bruksel.

Në kryeqytetin e Francës, në Parisin e komunarëve, Enver Hoxha njihet me komunistë francezë, futet në ambientet e punëtorëve parizianë dhe merr pjesë në mitingjet e organizuara nga PK e Francës. Në klubet e edukimit marksist të PK të Francës në lagjet e punëtorëve, Ai studion pjesë e komente për veprën madhore të K. Marksit "Kapitalin" dhe veprën e F. Engelsit "Anti-Dyringun".

4

6



EXTRAIT DU REGISTRE DES INSCRIPTIONS DES ARCHIVES DE L'UNIVERSITE

OFFICE DES RENSEIGNEMENTS UNIVERSITAIRES

93

Monsieur HOXHA, Enver

né à Gjinokaster (Albanie)

le 3 octobre 1908

adresse : Légation d'Albanie 156, rue de la

nationalité : Albanaise

N° d'ordre	Année académique	Année d'études	Etudes (Ecoles) : E.S. Etudes spéciales : Notariat E.S. Cours isolés : C.I.	Date de la session	Résultats des examens
821	1934/35	Spéciale cand.ph.et let. prép.au droit	E.S.	juillet 19	
821	1934/35	1ère année de doctorat en droit		juillet 19	
				octobre 19	
				juillet 19	
				octobre 19	
				juillet 19	
				octobre 19	
				juillet 19	
				octobre 19	

S.V.P.

16 OCT. 1984

DE BRUXELLES

D. Roosevelt

BRUXELLES 5

5



7

Me përpjekjet e veta dhe me përkrahjen e disa shokëve shqiptarë, Enver Hoxha në vitin 1934 caktohet nëpunës në Konsullatën Shqiptare në Belgjikë. Në Bruksel regjistrohet e ndjek studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Lirë të Belgjikës dhe thellohet më tej në studimin e marksizëm-leninizmit. Idetë e kësaj teorie të ballafaquara me gjendjen në Shqipëri e me lëvizjen e proletariatit, sidomos të atij francez, luajtën rol të veçantë në formimin e Enver Hoxhës me botëkuptimin dhe shpirtin revolucionar të komunistit të vendosur. Për veprimtarinë e Tij revolucionare, që ra në sy të agjentëve të Zogut, në vitin 1936 pushohet nga puna me motivacionin se e kishte kthyer konsullatën në arsenal të literaturës marksiste.



1

2

Gjatë viteve të studimit e të punës në Francë e në Belgjikë, në kthimet e në largimet nga atdheu, Enver Hoxha është ndalur shpesh në qytetin Bari të Italisë. Në këtë qytet atij iu dha mundësia të hynte në mjediset e emigrantëve antizogistë, që ishin larguar nga Shqipëria pas dështimit të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të vitit 1924 dhe të njihte nga afër gjendjen morale e politike të tyre. Kjo njohje i shërbeu Enver Hoxhës më pas, gjatë përpjekjeve të PK të Shqipërisë për t'i ngritur dhe për t'i hedhur në luftë kundër pushtuesve italianë grupet e ndryshme të nacionalistëve.

3



DEMOKRATIA

I XII. Gjirokastrë, e Shtune 1 Gusht 1936 Nr 5

CEREMONIA E INAUGURIMIT
te varrit të Patriotit te math
Bajo Topullit

Flet Enver Hoxha

Pardje te Premten u-mbus... plot gjashte vjet qe kur t, o Ba... na u-ndave nga gjiri i Shoqer... Shqiptare. Me gjith... ate, na duk... si kur ke qene dje, aq i gjalle esht... kujtim i yt ne zemrat e pa nj... te djaleris qe te njohu dhe te çmo... nga veprat e larta e patriotike qe... kushtove kesaj toke te shume vuaj... tur.

Djaleria Shqiptare besnike ne principet t'uaja, gjunjezohet para ketij qivuri modest dhe me admi... rim çuditet se s'i ju o veterane aq te pake ke... i lene vepra aq te shu... ma per sgjimin e ndjenjes kom... betare, per lirin e Kombit mbare dhe kur? Ne nje kohe kur k... qene vetem nje grusht njerzish, ku...

...t'a gjejme, veprat e juaja ... mbushin zemrat t'ona plot ... energji, se ju kini punuar ... per ideal, ju kini qene larg ... teresat dhe ambicjet perso... per ju gieja me e shenjt ishte ...

Se qe e gjetem kete Shqipe... le, kete Shqiperi qe na i pre... ju, me gjakun e zemres, nuk ... te ndjehemi krenare po qe ... do t'i sjel im nje permiresim ... Shqiptare qe ju e deshte ... Ju bete sa mundet, po ne ... ketyre 25 vjete s'kemi bere ... duhet, por djaleria qe po me... ju zotohet, mbi kete var qe ... faltorja me e shëujte e çdo ... tarit, se nuk do t'i mungoje ... dhe as kura ua kur ka ... ardhur puna qe te pregati... nje Shqiperi me te lumtur, nje ... me te begateshme.

Ne te rinjte nuk do te kemi per ... kolltukun, por mb revajtjen e ... bashkimin e vertete te ... nje bashkim qe do t'a kete

5

4

1. Me nipin dhe motrën, Fahrijen, në qytetin Bari të Italisë. **2.** Në Bari në prag të kthimit në atdhe. **3.** Duke i folur popullit nga ballkoni i Bashkisë në Shkodër. Shtator 1936. **4.** Homazh patriotëve të rënë. Shkodër, shtator 1936. **5.** Faksimile e fjalës së mbajtur para varrit të Bajo Topullit, të botuar në gazetën "Demokratia". 1 gusht 1936.

I mbetur pa punë dhe pa mjete për të përfunduar studimet universitare, Enver Hoxha, në verën e vitit 1936, u kthye përfundimisht në Shqipëri. Pak ditë pas kthimit në vendlindje, Enver Hoxha, tashmë i brumosur me botëkuptimin komunist, u betua në emër të djalërisë shqiptare para varrit të patriotit të shquar Bajo Topulli. Dy muaj më vonë, Ai mori pjesë në misionin e lartë e kuptimplotë: gjetjen në fushën e Shtoit të eshtrave të patriotëve Çerçiz Topulli e Muço Qulli për t'i kthyer në vendlindje dhe shprehu në një fjalim të shkurtër para popullit të Shkodrës nderimin për patriotët e lëvizjes kombëtare shqiptare.

1

2

1. Pedagog në Liceun Kombëtar të Korçës. **2.** Në dimrin e vitit 1937-1938 në Korçë. **3.** Ali Kelmendi. **4.** Në Gjirokastër në vitin 1936. Nga e majta në të djathtë — Enver Hoxha, Emin Shtino, Masar Topulli.

Pas kthimit në atdhe, preokupimi i parë i Enver Hoxhës ishte rivendosja e lidhjeve me lëvizjen komuniste shqiptare. Në korrik 1936 Ai u njoh në Gjirokastër me militantin e shquar komunist, Ali Kelmendin.që kishte luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e në shëndoshjen e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Para se qeveria zogiste ta dëbonte nga atdheu Ali Kelmendin, Enver Hoxha takohet dhe bisedon disa herë me të për probleme të zhvillimit të lëvizjes komuniste e punëtore. Pas kthimit në Shqipëri autoritetet zogiste, që e shihnin me dyshim, e lanë Enver Hoxhën muaj të tërë pa punë. Pas shumë përpjekjesh Ai u caktua si pedagog i jashtëm, që paguhej për aq orë sa bënte mësim, në gjimnazin e Tiranës dne vetëm në prill të vitit 1937 u emërua mësues në Liceun e Korçës, por përsëri "me orë speciale".

3

4



1

3

2

4

5

6

7

1. Miha Lako. **2.** Pilo Peristeri. **3-4.** Pamje nga pazari i Korçës, qendër e punëtorëve korçarë. **5.** Mes nxënësve dhe mësuesve të Liceut të Korçës. **6.** Midis një grupi anëtarësh të shoqërisë "Puna" dhe të "Shoqërisë së punëtorëve rrobaqepës". Korçë 1938. **7.** Enver Hoxha. 1939.

Në Korçë Enver Hoxha futet në ambientet punëtore dhe rivendos menjëherë lidhjet, tashmë në mënyrë të organizuar, me Grupin Komunist. Lidhet ngushtë me militantët komunistë Miha Lako, Pilo Peristeri e të tjerë dhe, me horizontin teorik e veprimtarinë praktike, bëhet shpejt një ndër anëtarët më aktivë të Grupit Komunist të Korçës dhe të lëvizjes komuniste në Shqipëri. I ngarkuar nga Grupi Komunist i Korçës për të punuar veçanërisht me nxënësit e me mësuesit, profesori komunist Enver Hoxha me propagandimin e ideve demokratike e komuniste, me fjalën e zjarrtë në mbrojtje të të drejtave të popullit, fitoi simpatinë e nxënësve, mësuesve e intelektualëve përparimtarë dhe u bë një nga edukuesit kryesorë të organizatës jashtëshkollore "Rinia korçare".



1

Viti 1939. Një rrezik shumë serioz, prelud i tragjedisë më të madhe të popullit shqiptar, kërcënonte Shqipërinë. Italia fashiste,që nëpërmjet koncesioneve të shumta e pakteve skllavëruese politike e kishte shndërruar Shqipërinë në një gjysmëkoloni, filloi përgatitjet për pushtimin ushtarak të saj. Përballë këtij rreziku, rrjedhim logjik i politikës antikombëtare të regjimit, mbreti Zog dhe çifligarët e borgjezia e madhe shqiptare, të shitur te kapitali italian, nuk ndërmorën asnjë hap për të organizuar qëndresën e armatosur kundër agresionit fashist. E vetmja forcë e organizuar, e vendosur dhe e aftë për ta ngritur popullin në luftë për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut ishin komunistët. Enver Hoxha u shqua mes anëtarëve të Grupit Komunist të Korçës për demaskimin në popull e veçanërisht në rininë shkollore të qëllimeve të fashizmit dhe për propagandimin e domosdoshmërisë së krijimit të një lëvizjeje të gjerë antifashiste. Në ditët e para të prillit 1939 u bënë të njohura botërisht planet e fashizmit italian për pushtimin e Shqipërisë. Në të katër anët e vendit shpërthyen demonstrata të fuqishme të organizuara dhe të udhëhequra nga komunistët. Me iniciativën e anëtarëve të grupeve komuniste e të atdhetarëve në Tiranë dhe në qytete të tjera u krijuan qendra të rekrutimit të vullnetarëve për luftën kundër agresionit fashist. Në mbledhjen e organizuar në Bashkinë e Korçës Enver Hoxha bëri thirrje për mobilizimin dhe armatosjen e popullit të ngritur në këmbë, të gatshëm për të luftuar e për të mbrojtur me gjak lirinë e pavarësinë e vet dhe për dënimin e mbretit kapitullant e tradhtar. Më 7 prill 1939 fashizmi italian shpërtheu agresionin kundër Shqipërisë. I tradhtuar dhe i lënë pa armë nga mbreti dhe nga qeveria, i paorganizuar dhe pa asnjë ndihmë e përkrahje nga jashtë, populli shqiptar, që përdori kundër armikut "atë.gjuhë që Evropa e kishte harruar", nuk mundi ta ndalonte agresionin dhe pushtimin e vendit. Rezistenca e përgjakshme dhe heroike e atdhetarëve shqiptarë në të gjitha portet e Shqipërisë e gjetkë, që i pritën me plumba agresorët, u shtyp nga hordhitë fashiste të armatosura gjer në dhëmbë. Shqipëria u pushtua.

1. Në fillim të pranverës së vitit 1939 në Korçë me Manol Konomin. **2.** Demonstratë e popullit të Tiranës më 5 prill 1939 kundër rrezikut të agresionit fashist. **3.** Pamje nga zbarkimi i pushtuesve italianë në Durrës. 7 prill 1939. **4-5.** Pamje nga shtrirja e pushtimit fashist italian në Shqipëri.

2



3

4



5

1

2


MBRETNIJA SHQIPTARE
MINISTRIJA E ARMEMIT

3

1. Mësuesi komunist revolucionar - Enver Hoxha. **2.** Pamje nga demonstrata antifashiste e 28 nëntorit 1939 në Korçë **3.** Faksimile e vendimit të pushimit nga puna.

Pushtimi fashist krijoi në të gjithë vendin një atmosferë terrori e pasigurie dhe vuri në pikëpyetje vetë ekzistencën e popullit e të kombit shqiptar. Duke ndier tërë peshën e rëndësisë historike të momentit, Enver Hoxha ishte ndër të parët që diti të shikonte përtej errësirës fashiste ditët e ardhshme të lirisë. I ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrat e revolucionarit komunist, Ai u bë qysh në ditët e para të pushtimit fashist një agjitator i zjarrtë i idesë së luftës çlirimtare në radhët e rinisë shkollore. Për veprimtarinë revolucionare dhe qëndrimin e vendosur e të hapët antifashist, pas daljes në ballë të demonstratës së 28 nëntorit 1939, Enver Hoxha pushohet nga puna dhe nxirret jashtë kuadrit të arsimit.



1

Me vendim të qendrës së Grupit Komunist të Korçës, në fillim të vitit 1940 Enver Hoxha erdhi në Tiranë për t'u hedhur menjëherë në veprim revolucionar për bashkimin e grupeve komuniste dhe krijimin e kushteve për formimin e PKSH. I bindur për karakterin e gabuar të rrugës së ndjekur nga krerët për bashkimin e grupeve komuniste me marrëveshje midis tyre, Enver Hoxha ishte i pari që kuptoi se krijimi i Partisë do të arrihej nëpërmjet veprimit nga poshtë, me bashkimin e bazës së grupeve komuniste. Nën maskën e tregtisë, Ai iu përvesh energjikisht punës për realizimin e kësaj detyre jetike për fatet e popullit e të atdheut dhe e shndërroi shumë shpejt dyqanin "Flora" në Tiranë në qendrën kryesore të lëvizjes komuniste në Shqipëri.

1. Enver Hoxha. **2.** Qemal Stafa (1920-1942). **3.** Vasil Shanto (1913-1944). **4.** Pamje e jashtme e dyqanit "Flora" në Tiranë. **5.** Në dyqanin "Flora". Nga e djathta në të majtë — Enver Hoxha, Ilo Dardha, Pilo Peristeri.

2

3

4

5

Në luftë me frymën e grupazhit e të sektarizmit, Enver Hoxha i dha hov punës për sheshimin e mosmarrëveshjeve, për gjetjen e gjuhës së përbashkët dhe për bashkëpunimin midis anëtarëve të grupeve për kryerjen e aksioneve revolucionare. Duke vendosur lidhje të shëndosha me komunistë militantë të grupeve të tjera që vepronin në Tiranë, ku shquheshin Qemal Stafa e Vasil Shanto, Enver Hoxha punon e lufton për formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

1

2

Në vazhdim të përpjekjeve për bashkimin e grupeve komuniste dhe për formimin e Partisë, gjatë vitit 1940 dhe në fillim të vitit 1941, Enver Hoxha shkoi në qytetet Shkodër, Durrës, Fier, Kuçovë e Gjirokastër, ku u takua e bisedoi me komunistë të grupeve të ndryshme. Veprimi më i rëndësishëm i përbashkët i grupeve komuniste dhe një fitore e madhe në rrugën e bashkimit të komunistëve në një parti të vetme ishte demonstrata e madhe antifashiste që shpërtheu në Tiranë më 28 tetor 1941. Enver Hoxha ishte organizatori kryesor i kësaj demonstrate. Duke qëndruar në radhët e para të saj, Ai ra në sy të spiunëve dhe mundi t'i shpëtojë arrestimit në sajë të gjakftohtësisë e të zgjuarsisë së vet. Që nga këto momente e deri në prag të Çlirimit të Shqipërisë, Ai e zhvillon veprimtarinë e vet në ilegalitet.

4

C/
COPIA

R. QUESTURA DI TIRANA
Gabinetto

N° 04801 Tirana,11;15.11.1941 XX°

Risp. a h° 05974 del 13 corr:

OGGETTO: 28 Ottobre - Dimostrazione di studenti albanesi.-

Direzione Centrale di Polizia TIRANA

Compagnia CC.RR. Interna TIRANA

In conformità alle disposizioni ricevute ed in rif.imento al
ta di cui sopra informo che quest'ufficio ha finora pr.vveduto nei
guardi dei seguenti individui che ebbero a partecipare alla dimostr
one studentesca del 28 Ottobre u/s.,nel modo come affianco di ciasc
indicato:
) HOXHA Enver di Halil e di Durje Çuçi nato ad Argirocastro,di anni
32,residente a Tirana Via Dibra,commerciante - da arrestare - già
diffidato:

3

1. Pamje nga demonstrata e 28 tetorit 1941 në Tiranë. **2.** Në qytetin e Shkodrës në vitin 1941. **3.** Faksimile e urdhrit të arrestimit për pjesëmarrjen në demonstratë. **4.** Enver Hoxha, organizatori kryesor i demonstratës së madhe antifashiste në Tiranë.

''Akti i madh që kreu Enver Hoxha në atë Nëntor të turbullt e të errët të vitit 1941 duke themeluar Partinë Komuniste, i dha dritën që i mungonte popullit shqiptar, i dha mendjen për të parë të ardhmen, i dha shtabin që do ta udhëhiqte në luftën titanike për jetë a vdekje''.

Ramiz Alia

2



3



REZOLUCIONI I MBLEDHJES SË GRUPEVE KRYESORE KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KRIJIMIN E PARTISË

[Nëntor 1941]

REZOLUCION

I. Situata politike

VI. Detyrat politike

4

Në Mbledhjen e Grupeve kryesore Komuniste të Shqipërisë, që më 8 Nëntor 1941 themeloi Partinë Komuniste të Shqipërisë, Enver Hoxha, me platformën ideologjike, politike e organizative që paraqiti e mbrojti, me luftën parimore që udhëhoqi kundër tezave likuidatore, i përkrahur edhe nga pjesëmarrës të tjerë të mbledhjes, e vuri Partinë e sapolindur në themele të shëndosha marksiste-leniniste. I zgjedhur nga Mbledhja Themeluese anëtar i Komitetit Qendror të Përkohshëm të Partisë dhe i ngarkuar me drejtimin e punës së tij, Enver Hoxha u vu menjëherë në ballë të punës e të përpjekjeve për organizimin e PKSH dhe lidhjen e saj me masat. ''Rezolucioni i Mbledhjes së Grupeve kryesore Komuniste të Shqipërisë'' dhe ''Thirrja e Parë e KQ të PKSH drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë'', të shkruara nga Enver Hoxha në nëntor 1941, ushtuan si kushtrim i fuqishëm lufte për komunistët dhe mbarë popullin.

1. Enver Hoxha, themelues i Partisë Komuniste të Shqipërisë. **2.** Shtëpia ku u themelua PKSH në Tiranë. **3.** Faksimile e Thirrjes së Parë të KQ të PKSH drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë. **4.** Faksimile e Rezolucionit të Mbledhjes së Grupeve kryesore Komuniste të Shqipërisë — dokumentit të parë programatik të PKSH.

1



KUESTURA MBRETNORE E TIRANES

Nr. 2095 Gab. Tiranë, me: 25-6-1943/XXI/

LANDA: Enver Hoxha i Hoxhit dhe i Gjikes lindun në Gjinokaster - 1918 - komunist, -

KUESTURAVE MBRETNORE:

Gjirokastër - Berat - Dibër - Durrës - Elbasan - Pejë - Korpçë - Prishtinë - Prizren - Shkodër - Vlonë -
Komandës Kompanisë Mbrendëshme të Gjindarmerisë Mbret.
Komandës Kompanisë Jashtëme të Gjindarmerisë Mbretnore
Skuadrës Politike të Kuesturës Mbretnore - Tiranë
Skuadrës Gjyqësore të Kuesturës Mbretnore - Tiranë
e për nj. Drejtorisë së P.të Policisë - Tiranë

Në përgjegjen e Qarkoreve të kalueme të ksajë Zyrë dhe me lutje qi të dendësohen shorbimet dhe hetimet për gjetjen e rreshtimin e të sipërshkruemit komunist'i rrezikshem, njoftoj se ky asht i goditur me urdhën rreshtimi të datës 16 të k.m. Nr. 990/43 i lëshuem nga Prokurorija e Përgjithëshme e Gjyqit Posaçem të Shtetit, pse i denuem me vendimin 20/6/1943/XXI/ me vdekje.

KUESTORI
(P. Papalalo)

Con riferimento alle precedenti circolari di questo Ufficio e con preghiera di voler intensificare i servizi e le indagini per il rintraccio e l'arresto del soprascritto comunista pericoloso, comunico che questo è colpito da ordine di arresto in data 16 corrente nr. 990/43 emesso dalla Procura Generale del Tribunale Speciale dello Stato [illegible] con sentenza 20/6/u.s. alla pena di morte.

Il Questore
(P. Papalalo)

2

3

4

5

1. Fotografi e bërë nga Qemal Stafa, e përdorur në një letërnjoftim fals. **2.** Dokument i armikut për arrestimin dhe dënimin me vdekje të Enver Hoxhës. **3.** Shtëpia e Bije Vokshit, ku u themelua organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë më 23 Nëntor 1941. **4.** Shtëpia e Adivije Agollit, ku u zhvillua Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë. **5.** Shtëpia e Ilmije Kosturit, një nga bazat ilegale në Tiranë ku është strehuar dhe ka punuar Enver Hoxha. **6-7.** Fotomontazh i organeve kryesore të shtypit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. **8.** Shtëpiamuze ku u shtyp numri i parë i gazetës "Zëri i popullit".

Në kushtet e terrorit më të egër dhe i dënuar me vdekje në mungesë nga gjyqet e fashizmit, Enver Hoxha ua kushtoi të gjitha energjitë mendore e fizike realizimit të detyrave të ngarkuara nga Partia. Më 23 Nëntor 1941 Ai mori pjesë dhe drejtoi në emër të KQ të PKSH mbledhjen për themelimin e organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë. Me iniciativën dhe nën drejtimin e Tij zhvilluan me sukses punimet në Tiranë Konsulta e Parë e Aktivit të PKSH (prill 1942), Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë (qershor 1942) dhe një numër mbledhjesh të tjera të organizatave e të forumeve të Partisë. Analizat dhe vendimet e këtyre mbledhjeve dhe veprimtaria e dendur revolucionare e Enver Hoxhës për zbatimin e tyre patën rëndësi jetike për forcimin ideologjik, politik e organizativ të Partisë dhe i dhanë një hov të ri punës së saj.

6

7

8

Enver Hoxha, autori i trakteve të para që shpërndanë komunistët qysh para themelimit të PKSH, u bë iniciatori dhe drejtuesi i "Zërit të popullit", organit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që doli me vendim të Komitetit Qendror. Në kryeartikullin e numrit të parë dhe në gjithë artikujt e tjerë të shkruar nga Enver Hoxha në këtë gazetë dhe në organet e tjera të shtypit gjatë periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, propagandohen vija politike e Partisë, lufta antifashiste e popullit shqiptar, tregohen rrugët për çlirim kombëtar, demaskohen me forcë pushtuesit dhe tradhtarët. Artikujt e Enver Hoxhës janë model i publicistikës dhe i letërsisë së re politike që lindi në Shqipëri në kohën e luftës çlirimtare.



1



2

1. Me Myslim Pezën. **2.** Pamje e sallës ku u mbajt Konferenca e Pezës. **3.** Enver Hoxha, frymëzuesi dhe organizatori i Konferencës së Pezës. **4.**Myslim Peza. **5.** Haxhi Lleshi. 6. Mustafa Xhani. **7.** Nexhmije Xhuglini, pjesëmarrës në Konferencën e Pezës.

Në zbatim të detyrës themelore të Partisë së porsakrijuar për bashkimin politik të popullit në luftë kundër pushtuesit, Enver Hoxha vendosi lidhje të ngushta me njerëz të thjeshtë të qytetit e të fshatit, me intelektualë e nacionalistë atdhetarë etj. dhe me këmbënguljen e sipas shembullit të Tij komunistët e intensifikuan veprimtarinë e tyre në qytet e në fshat. Në luftë me përpjekjet e pseudoatdhetarëve e me konceptet antimarksiste Ai argumentoi mundësinë e bashkimit politik të popullit nga poshtë dhe domosdoshmërinë e udhëheqjes së Frontit nga Partia Komuniste e Shqipërisë. Me punën e përditshme me masat, me përpunimin e platformës politike dhe organizative, Enver Hoxha dha kontribut të drejtpërdrejtë në përgatitjen, organizimin dhe drejtimin e Konferencës, që u mblodh më 16 shtator 1942 në Pezë, ku u hodhën themelet politike të Frontit Nacionalçlirimtar të popullit shqiptar.

3



4



5

6

7

Që në themelimin e saj, PKSH, e orientuar nga mendimi marksist-leninist i Enver Hoxhës, e lidhi luftën për dëbimin e pushtuesit me vendosjen e një regjimi demokratik e popullor në Shqipërinë e çliruar. Konferenca e Pezës, që vuri themelet e pushtetit popullor në Shqipëri, si bazë për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë pranoi tezat e parashtruara nga Enver Hoxha në referatin "Këshillat Nacionalçlirimtarë si organe bashkimi e lufte të popullit shqiptar".

1.Mbledhje e popullit për zgjedhjen e këshillit nacionalçlirimtar. **2.** Enver Hoxha me një grup shokësh para kasolles së Shmilit. **3.** Kasollja në Qafë-Shmil.

Populli shqiptar i priti me entuziazëm vendimet historike të Konferencës së Pezës, thirrjen e Enver Hoxhës për bashkim në luftë kundër pushtuesit. Radhët e Frontit Nacionalçlirimtar u shtuan; u forcua aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, që përbënte bazën më të gjerë të këtij Fronti. Numri i këshillave nacionalçlirimtarë, që krijoheshin drejtpërsëdrejti nga masat e popullit nën udhëheqjen e Partisë, u rrit me shpejtësi si në zonat e çliruara, ashtu edhe në të paçliruarat. Bashkimi i popullit në Frontin Nacionalçlirimtar, ngritja e këshillave, forcimi e zgjerimi i luftës së armatosur dhe ngritja e ndërgjegjes atdhetare të popullit vinin në rend të ditës organizimin e kryengritjes së përgjithshme popullore.

2

3

Në dhjetor të vitit 1942 Enver Hoxha largohet nga Tirana dhe kalon në malësitë e Elbasanit, ku ishte baza kryesore e organeve udhëheqëse të Partisë e të luftës deri në dhjetor 1943. Vëmendje të veçantë në këtë periudhë i kushton Ai organizimit e zgjerimit të luftës së armatosur, e cila qysh në fillim qe orientuar nga Partia si një luftë partizane me përmbajtje thellësisht popullore e revolucionare. Në krye të Partisë Ai përpunon vijën politike të Luftës Nacionalçlirimtare në përputhje me zhvillimin e situatave, udhëheq hap pas hapi zbatimin e saj. Mbledhja e Komitetit Qendror të Përkohshëm, që u zhvillua nën drejtimin e Enver Hoxhës në fshatin Qafë-Shmil të Elbasanit në fund të dhjetorit 1942, parapriu Konferencën e Parë të Vendit të PKSH, që do të vinte në rend të ditës organizimin e kryengritjes së përgjithshme popullore.

1. Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i PKSH. **2.** Mes partizanëve të Batalionit të Mokrës. **3.** Pamje e sallës ku u zhvillua Konferenca e Parë e Vendit e PKSH. **4.** Me Sami Bahollin në Labinot. **5.** Mes partizanëve të çetës së Bërzeshtës. Enver Hoxha — i pesti nga e majta në të djathtë.

1

Në pranverën e vitit 1943 në Labinot pranë Elbasanit, nën drejtimin e Enver Hoxhës u përgatit dhe zhvilloi punimet Konferenca e Parë e Vendit e Partisë Komuniste të Shqipërisë (17-22 mars). Për problemet që analizoi, për përpunimin më thellë e më gjerë të vijës së përgjithshme të Partisë dhe për vendimet historike që mori, Konferenca e Parë e Vendit pati rëndësinë e një kongresi partie. Konferenca zgjodhi Komitetin Qendror Definitiv, Byronë Politike dhe Enver Hoxhën Sekretar të Përgjithshëm të PKSH.

2

4

3



5

Referati i mbajtur nga Enver Hoxha në Konferencën e Parë të Vendit të PKSH për çështjet organizative të Partisë në lidhje të ngushtë me organizimin e kryengritjes së përgjithshme dhe veprimtaria aktive e Tij pas Konferencës për përcaktimin dhe zbatimin e masave konkrete për organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i dhanë hov kryengritjes së përgjithshme të armatosur të popullit shqiptar.



1

Në muajt maj-qershor 1943 Enver Hoxha,në bashkëpunim me Hysni Kapon e shokë të tjerë të qarkorit të Vlorës, drejton në Vlorë e Mallakastër punën për shpartallimin e fraksionit të rrezikshëm antiparti. Gjatë veprimtarisë për shpartallimin e fraksionit, si dhe gjatë takimeve e bisedave me shokë drejtues të Partisë, me komunistë, me komandantë të çetave e të batalioneve, me partizanë e patriotë, në krahinat e Skraparit e të Gorë-Oparit, të Korçës e të Mokrës Ai njeh më nga afër gjendjen dhe jep një kontribut të madh për forcimin e organizatave të Partisë e të reparteve të ndryshme partizane në këto zona.

1. Me Vasil Shanton. Labinot 1943. **2.** Enver Hoxha, Komisari Politik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Spiro Moisiu, Komandanti i këtij shtabi drejtojnë veprimet luftarake të forcave partizane. **3.** Në përurimin e batalionit "Hakmarrja". Vithkuq, korrik 1943. **4.** Enver Hoxha, Komisar Politik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

2

3

4

Më 10 korrik 1943, në zbatim të vendimit të Konferencës së Parë të Vendit të PKSH, me propozim të Enver Hoxhës, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçirimtar vendosi njëzëri formimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Sekretari i Përgjithshëm i PKSH, Enver Hoxha, u caktua Komisar Politik i Shtabit të Përgjithshëm.

1

2

Me iniciativën e KQ të PKSH e personalisht të Enver Hoxhës dhe me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, nga 4-9 shtator 1943 u mblodh në Labinot Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare. Në bazë të referatit të mbajtur nga Enver Hoxha, konferenca pranoi konkluzionet e Komitetit Qendror të PKSH dhe i shpalli këshillat nacionalçlirimtarë si pushteti i vetëm i popullit në Shqipëri. Me këtë vendim Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare, që dënoi me forcë kompromisin tradhtar me Ballin Kombëtar për ndarjen e pushtetit, u dha një goditje të fortë përpjekjeve të reaksionit për marrjen e pushtetit dhe afirmoi një realitet të madh historik: lindjen e pushtetit popullor në zjarrin e luftës.



1-2. Mes delegatëve të Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare. Labinot, shtator 1943. **3.** Në ditët e zhvillimit të Konferencës në Labinot. Në këmbë, nga e majta në të djathtë — Baba Faja Martaneshi , Myslim Peza, Enver Hoxha. Ulur — Ramadan Çitaku.

3

Më 9 shtator 1943 Italia fashiste kapitulloi, por vendin e ushtrisë pushtuese të saj në Shqipëri e zuri ushtria gjermane. Po këtë ditë, Enver Hoxha, në emër të Komitetit Qendror përgatiti direktivat për komitetet e PKSH në qarqe në lidhje me gjendjen e krijuar pas kapitullimit të Italisë dhe për luftën kundër pushtuesit të ri. Të nesërmen, më 10 shtator, Enver Hoxha nënshkroi thirrjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe të Shtabit të Përgjithshëm drejtuar popullit për t'i dhënë më tepër hov kryengritjes së përgjithshme për çlirimin e plotë të Shqipërisë e për të marrë pushtetin.

1

Udhëheqësi i PKSH dhe Komisari Politik i Shtabit të Përgjithshëm vuri të gjitha aftësitë dhe talentin e Tij për krijimin, rritjen dhe forcimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Enver Hoxha ndoqi me kujdes personalisht punën për formimin e formacioneve të mëdha të ushtrisë, për organizimin dhe kompletimin e tyre me armatime e me kuadro ushtarakë e politikë. Ai mori pjesë drejtpërdrejt në formimin dhe organizimin e formacioneve të para të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Brigadave I, II, III Sulmuese.

1. Enver Hoxha, organizator dhe udhëheqës i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. **2.** Në formimin e Brigadës II Sulmuese. Shëngjergj, 28 nëntor 1943. **3.** Në Stanet e Linosit. Nga e majta në të djathtë — Medar Shtylla, Enver Hoxha, Spiro Koleka. Prapa — Spiro Moisiu. Dhjetor 1943. **4.** Çast pushimi. I dyti nga e majta në të djathtë — Enver Hoxha. Shëngjergj 1943.

2

3

4

1

2

3

1.Me Medar Shtyllën. Çermenikë 1943. 2. Në Shmil në dimrin e vitit 1943-1944. Nga e majta në të djathtë - Enver Hoxha, Kosta Boshnjaku, Spiro Moisiu. 3. Gjatë Mësymjes armike të Dimrit 1943-1944. Nga e majta në të djathtë - Sami Baholli, Enver Hoxha, Teodor Heba. 4. Me Spiro Moisiun në ditët e fundit të Mësymjes armike të Dimrit.

Gjakftohtësia, guximi, pjekuria marksiste-leniniste, mbështetja e fuqishme te populli dhe besimi i patundur i Enver Hoxhës në fitore spikatën me forcë gjatë muajve të zhvillimit të mësymjes më të madhe e më të egër armike në dimrin e vitit 1943-1944. I rrethuar së bashku me një pjesë të Shtabit të Përgjithshëm nga forca të shumta gjermano-balliste, në kushtet e jashtëzakonshme të dimrit në terrenet e ashpra malore të zonave të Çermenikës, Shëngjergjit e Martaneshit, Enver Hoxha ruajti lidhje me Partinë dhe ushtrinë, i orientoi ato për përdorimin e taktikave të shkathëta në përshtatje me rrethanat e vështira konkrete, goditi ashpër çdo shfaqje çorganizimi, paniku e fryme disfatiste dhe luftoi për të ruajtur e ngritur kudo më lart frymën luftarake e besimin në fitore.

4

Me ndihmën e gjithanshme e të përditshme të njerëzve të thjeshtë të popullit, me optimizmin e vendosmërinë revolucionare që e karakterizonte, Enver Hoxha dhe pjesëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm kapërcyen të gjitha vështirësitë dhe pas gati tre muajsh dolën nga rrethimi dhe kaluan në qarkun e Korçës. Përballimi dhe çarja e rrethimit është një shembull i shkëlqyer i lidhjeve të ngushta të Partisë Komuniste e të Enver Hoxhës me popullin, i dashurisë së popullit për Partinë, i harmonizimit të mençurisë së udhëheqësit me bujarinë dhe atdhetarizmin e zjarrtë të njerëzve të thjeshtë.

1. Enver Hoxha në ditët e kundërmësymjes së Ushtrisë Nacionalçlirimtare. **2.** Drejt Kongresit historik të Përmetit. **3.** Mes një grupi delegatësh të Kongresit të Parë Antifashist Nacionalçlirimtar. Përmet, maj 1944.

1

Mësymja armike e Dimrit 1943-1944 dështoi dhe Ushtria Nacionalçlirimtare, me urdhër të Enver Hoxhës u hodh në kundërmësymje strategjike e po çlironte njerën pas tjetrës krahina të tëra të vendit. Duke vlerësuar se me rrethanat e krijuara çlirimi i plotë i Shqipërisë ishte i afërt, në muajin prill 1944 Enver Hoxha, në emër të udhëheqjes së PKSH, i parashtroi Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar propozimin për thirrjen e një kongresi, që do të ligjësonte pushtetin e këshillave nacionalçlirimtarë, krijimin e shtetit të ri shqiptar me qeverinë e tij demokratike dhe me ushtrinë e vet të rregullt.

2

3

Më 24 maj 1944 filloi punimet në qytetin e Përmetit Kongresi i Parë Antifashist Nacionalçlirimtar, që themeloi shtetin e ri shqiptar të demokracisë popullore. Kongresi, ku përfaqësohej gjithë populli shqiptar, vendosi të mos njihej asnjë qeveri tjetër që mund të formohej brenda ose jashtë Shqipërisë, t'i ndalohej Zogut kthimi në Shqipëri, të rishikoheshin e të prisheshin të gjitha marrëveshjet politike dhe ekonomike të lidhura nga regjimi i Zogut me shtetet e huaja në dëm të interesave të popullit, të vazhdonte lufta kundër pushtuesve gjermanë e tradhtarëve shqiptarë deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe në vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore në të gjithë vendin.

„ . . . Kongresi i Përmetit, një nga ngjarjet më të rëndësishme të epopesë së Luftës sonë Nacionalçlirimtare, një monument i ngritur nga lufta dhe mençuria e Partisë dhe e popullit, një vepër e madhe me rëndësi kolosale për të ardhmen e Shqipërisë".

Enver Hoxha

1

Në Kongresin e Përmetit Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i PKSH, u zgjodh anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe u emërua President i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili kishte atributet e Qeverisë Provizore, dhe Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

2

3

4

1. Duke mbajtur raportin në Kongresin e Përmetit. **2.** Duke dalë nga salla ku zhvilloi punimet Kongresi i Parë Antifashist Nacionalçlirimtar. I pari nga e djathta — Enver Hoxha. **3.** Mes anëtarëve të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Nga e majta në të djathtë — Spiro Moisiu, Omer Nishani, Enver Hoxha, Myslim Peza, Haxhi Lleshi, Hysni Kapo. **4.** Enver Hoxha, President i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

1



2

Më 28 maj 1944, Komandanti i Përgjithshëm, Enver Hoxha i dha urdhër Ushtrisë Nacionalçlirimtare të hidhej në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit gjermanë dhe për shkatërrimin rrënjësor të Ballit Kombëtar, të Legalitetit dhe të të gjitha forcave reaksionare. Po këtë ditë filloi mësymja tjetër e madhe e trupave gjermane, që njihet me emrin Mësymja e Qershorit. Ushtria Nacionalçlirimtare, që tashmë numëronte në radhët e saj dhjetëra mijë luftëtarë, nën udhëheqjen e Enver Hoxhës përballoi me sukses të gjitha operacionet dhe doli fitimtare mbi armikun. Forcat hitleriane dhe të tradhtarëve të vendit që morën pjesë në Mësymjen armike të Qershorit u shpartalluan. Enver Hoxha, që drejtoi veprimet luftarake të UNÇSH për shpartallimin e kësaj mësymjeje, përpunoi dhe udhëhoqi zbatimin e planit strategjik për çlirimin e plotë të Shqipërisë.



3

1. Enver Hoxha, Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. **2.** Njësi e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare në marshim. 3. Në ditët e Mësymjes armike të Qershorit 1944.

Shokut ENVER HOXHA

Kryetarit të Komitetit Antifashist Nacional Çlirimtar

N'emër të popullsis së Sektorit t'onë Ju dër-

Nr. 1

Zonë e lirë, 2/7/44

...ARTIKU TË DHËNIE.

...dëna thirje që u bëjnë teknikëve të no... ...ire Kolektivëto thirje i ndërmoni(jo ... ...në vende ku ka teknikë të tillë, i ... ...teknikë, i...

...jës që bën ...ë ...ëtbë lëshime ose shkel direkti... ...i dhe popullin kalon nga ...jyqi ushtrimk dhe dënohe... ...i parashikuara.

Vdekje Fashizmit-Liri Popullit.
Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë
Nacional-Çlirimtare Shqipëtare
Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha.

Enver Hoxha

1

...o luitës... ...idonos shokët që punojnë ...ë dhëna për ekzekutimin e ...duhet të foreshen për të

Për Komitetin Që
Partisë Komuniste Sh
(Vallona)

...oqnore

...in Qendror
...te Shqiptare
...xha)

...rali Hoxha

...ë 14 Qershor 1944

...Ardhja Gjermane ... ofensivë e madhe nuvjet... ...llmjet,shkarkimi i ule... ...të vështira të cilat d... ...Flenxtarë të lodhu... ...drejtave të popullit t... ...ror armikun Gjerman dhe kulmlirimit o trathtor... ...do të hasim akoma pengesa,do të shvillojnë edhe lu... ...limin e plagosur,por ne do t'i kapërxejmë të gjit... ...ne bëjmë një luftë të drejtë për të çliruar po...

Vdekje Fashizmit-Liri

Komandanti
Ushtris Nacional...
...Gjene...

...Vdekje Fash...
Komandant i Përgji...
...hqiptar Gjeneral-K...
...Enver Ho...

16

KOMITETI ANTIFASHIST
NACIONAL - ÇLIRIMTAR
KRYESIJA

Nr. 1/07

Më 11 - VII -

Zonë e lirë më 18/7/1944

DEKRET

...Kuvendi u ...ngyrtue ...ne u pranue propozimi i Komandës së Përgji...
...nme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare,

dekretojmë :

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit.

Kryetari i Komitetit
Antifashist Nacional-Çlirimtar
Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha.

Enver Hoxha

...shillit Nacional Çlirimtar t... ...shullës P...
Lorcë.

...vë falenderoj për përkushtetjon... ...u nxehtë g... ...popullit të sektorit t'onë që dërgoni m... ...ë të lartë,që Përfaqësija e Komitit ë n... ...sin e I-rë Antifashist të Përmetit.

Vdekje Fashizmit-Liri Popull...
Kryetari i Komitetit Antifa...
Nacional-Çlirimtar...
General Kolonel Enver Hoxha

Enver Ho...

Zon'e lirë,1 Gusht 944

Këshillit Nacional-Çlirimtar të Qarkut

K o r ç ë s

Falenderojmë për urimet që na dërgoni dhe marrim njoftim
gënaqësi për sigurimin t'uaj se do jemi zbatues besnik të di-
ivave të ktij Komitoti,të cilat do jenë gjithmon shprehja e
notit dhe aspiratave të popullit.
Transmetoni popullit Qarkut Korçës sigurimin e Komitetit
o t'a kryej misionin e naltë të ngarkuar nga Përfaqësija Kombë-
në Kongresin e I-rë Antifashist Nacional-Çlirimtar,me tër fu- II/1944
e tija,për t'a vazhduar luftën dhe më ne tërbim kundra okupa-
t dhe tradhëtarëve deri në fitoren e plotë për vendosjen e
kracisë popullore.

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

Kryetar'i Komitetit Antifashist
Nacional-Çlirimtar
Zheneral-Kolonel
(Enver Hoxha)

X/944

nal-Çlirimtar

it-Liri Popullit
më i U.N.Ç.
nel
)

Vdekje Fashizmit-Liri Popullit.
Komandant'i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqip.
Zheneral-Kolonel
(Enver Hoxha)

Popull shqipetar.
Tani jane minutat e fundit te llogarive. Tregohu i fo
dhe i bashkuar rreth frontit nacional-çlirimtar, sot me teper se
kurre, dhe tradhetoreve jepu lekun, por lekun me plumb ne balle.
Asnje leke, asnje metelik per qeverine tradhetare te
Tiranes dhe gangsterat fqinjeve te vendit tone.

VDEKJE FASHIZMI - LIRI POPULLIT
KOMITETI ANTIFASHIST NË Q. I SHQIPËRISË
P r e s i d e n t i :
(Enver Hoxha)

Komandant'i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral-Kolonel
(Enver Hoxha)



2

1. Në zyrën e punës në Odriçan. **2.** Në pyllin e Odriçanit. **3.** Faksimile të letrave, qarkoreve, urdhrave, udhëzimeve e radiogrameve të Kryetarit të Komitetit Antifashist dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare gjatë muajve qershor-shtator 1944.



1

2

Në mbrojtje të interesave të popullit e të atdheut Enver Hoxha u ndesh drejtpërsëdrejti me presionet, ndërhyrjet dhe shantazhet e misioneve ushtarake angleze e amerikane, që bënë ç'ishte e mundur, në mënyrë të maskuar e të hapët, për të sabotuar Luftën Nacionalçlirimtare, për të përkrahur reaksionin ballist e zogist dhe për të rivendosur në Shqipëri pushtetin e vjetër. Me sensin e qartë klasor, me mençurinë e një politikani marksist-leninist dhe me guximin e një udhëheqësi revolucionar Enver Hoxha kuptoi qysh në fillim qëllimet e fshehta të misioneve aleate, ia bëri ato të qarta gjithë Partisë dhe demaskoi çdo orvatje të tyre për sabotimin e luftës çlirimtare dhe marrjen e pushtetit nga populli.

„Kur Partia Komuniste e Shqipërisë lëshoi zërin e kushtrimit për të shpëtuar atdheun tonë të dashur nga kthetrat e fashizmit, rinia shqiptare qe e para që iu përgjigj thirrjes së saj, qe e para që u hodh në luftë, mbushi njësitet guerile të qyteteve dhe të maleve, të përbëra nga bijtë më të zgjedhur të popullit tonë, mbushi batalionet partizane, të cilat u zmadhuan në brigada e divizione e që sot përbëjnë Ushtrinë tonë të rregullt Nacional-çlirimtare".

Enver Hoxha

3

4

Në verën e vitit 1944 Partia vendosi të thirrej Kongresi i Parë i organizatës së Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH). Fjalimi i Enver Hoxhës në këtë Kongres, që i filloi punimet më 8 gusht 1944 në Helmës të Skraparit, u bë një program i madh pune për këtë organizatë.

1. Helmës, gusht 1944. **2.** Në Helmës. Nga e majta në të djathtë - Enver Hoxha, Omer Nishani, Ramadan Çitaku dhe shefi i misionit amerikan pranë Shtabit të Përgjithshëm. **3.** Enver Hoxha duke përshëndetur Kongresin e Parë të BRASH - it. **4.** Enver Hoxha duke shkuar në fushën ku u zhvillua Kongresi i Parë i BRASH-it.

1

1. Reparte partizane të UNÇSH në marshim në tokat e Jugosllavisë. **2.** Me komunistin internacionalist, Miladin Popoviçin. **3-4.** Populli i Beratit pret Enver Hoxhën dhe udhëheqësit e tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare.

Në shtator 1944, Komandanti i Përgjithshëm u dha urdhër Brigadës V dhe Brigadës III Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare të kalonin në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj nga pushtuesit gjermanë. Dy muaj më vonë, me vendim të KQ të PKSH dhe me urdhër të Enver Hoxhës, Divizionet e Pestë dhe të Gjashtë të UNÇSH, menjëherë pas Çlirimit të plotë të Shqipërisë, vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në Jugosllavi, ku së bashku me repartet e UNÇ Jugosllave, gjatë muajve dhjetor 1944 dhe janar-shkurt 1945,çliruan Malin e Zi, Sanxhakun dhe pjesën jugore të Bosnjës.

2

3

4

Në mes të shtatorit 1944, kur pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte çliruar, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, e mbledhur në Odriçan, miratoi propozimin e Enver Hoxhës për kthimin e Komitetit Antifashist në Qeveri Demokratike dhe vendosi të thirrej për këtë qëllim Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Në muajin tetor, Enver Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare hynë në qytetin e lirë të Beratit, ku më 20-23 tetor zhvilloi punimet Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.

,,Vendimi historik... për shndërrimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike ishte një hap historik i domosdoshëm, një rrjedhim logjik i luftës dhe i revolucionit popullor nën udhëheqjen e Partisë. Me këtë vendim marrja e pushtetit politik nga ana e masave punonjëse, që me luftë kishin rrëzuar pushtetin e vjetër, bëhej një realitet de facto dhe de jure''.

Enver Hoxha

1

2

Në raportin e mbajtur në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar Enver Hoxha foli për veprimtarinë e Komitetit Antifashist qysh nga koha e krijimit dhe propozoi kthimin e tij në Qeveri Demokratike. Më 22 tetor 1944 Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi njëzëri kthimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike Provizore të Shqipërisë. Me detyrën e Kryetarit të Qeverisë Demokratike, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar ngarkoi Enver Hoxhën.

1. Duke mbajtur raportin në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. **2.** Duke dalë nga salla ku zhvilloi punimet Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në Berat.

1

2

3



4

1. Mes anëtarëve të Qeverisë Demokratike. Nga e majta në të djathtë — Myslim Peza, Enver Hoxha, Spiro Koleka, Medar Shtylla, Haxhi Lleshi. **2.** Enver Hoxha dhe anëtarë të tjerë të Qeverisë Demokratike në Berat. **3.** Para hyrjes së selisë të Qeverisë Demokratike në Berat. **4.** Enver Hoxha, Kryetar i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë.

1

2

3

1. Enver Hoxha, ideatori dhe udhëheqësi i revolucionit popullor në Shqipëri. **2.** Mes partizanëve dhe popullit të qytetit gjatë kohës që Qeveria Demokratike e Shqipërisë qëndroi e punoi në Berat. **3.** Nisja e Qeverisë Demokratike nga Berati për në Tiranë. **4-5.** Enver Hoxha në krye të Qeverisë Demokratike hyn në Tiranën e çliruar.

«Po ktheheshim në Tiranën tonë të dashur dhe, për herë të parë pas kaq vjetësh, hynim atje jo ilegalë, me emra e me dokumente false, por lirisht e, për më tepër, fitimtarë»

Enver Hoxha

4

5

Me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm, Enver Hoxhës, Korparmata e Parë filloi luftën për çlirimin e kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës. Pas 19 ditë luftimesh të përgjakshme rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi, beteja për çlirimin e Tiranës u kurorëzua me sukses. Dy ditë para Çlirimit të plotë të vendit, më 27 nëntor 1944, Qeveria Demokratike e Shqipërisë, e kryesuar nga Enver Hoxha, niset nga Berati për në Tiranë. Pas dy ditësh udhëtimi nëpër rrugët e shkatërruara nga lufta, Qeveria Demokratike hyri fitimtare në Tiranën e çliruar.

1

2

3

4

Më 28 Nëntor 1944, në 32-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë populli i kryeqytetit, që kishte mbajtur dhe mbrojtur komunistët që themeluan Partinë, që kishte njohur Enver Hoxhën në ballë të demonstratave dhe kishte strehuar guerilasit, që kishte ndier në shpinë mizoritë dhe shkatërrimet e pushtuesve e të tradhtarëve vendës dhe kishte luftuar kundër tyre me heroizëm, e priti krahëhapur Qeverinë e vet të Parë Demokratike.

5

Në fjalimin me rastin e Ditës së Pavarësisë dhe të ardhjes së Qeverisë Demokratike në Tiranë, Enver Hoxha, nga tribuna e thjeshtë në bulevardin e kryeqytetit, i bëri thirrje popullit shqiptar, që me luftë ishte bërë zot i fateve të veta, të shtrëngonte radhët rreth pushtetit popullor, rreth Frontit dhe Qeverisë Demokratike për të ruajtur fitoret e arritura e për të realizuar perspektivat që i hapte marrja e pushtetit.

1. Nëna dhe të afërm të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare në pritje të hyrjes së Qeverisë Demokratike në Tiranë. **2-3.** Populli i Tiranës pret me gëzim anëtarët e Qeverisë së Parë Demokratike. **4.** Mes entuziazmit të popullit të Tiranës. **5.** Duke u ngjitur në tribunë së bashku me anëtarë të tjerë të Qeverisë Demokratike.



''Sot po hapet një faqe tjetër e historisë sonë, një faqe që është në dorën tonë ta bëjmë po aq të lavdishme, sa edhe luftën tonë kundër okupatorit, dhe kjo është lufta për rindërtimin e Shqipërisë, për ngritjen e ekonomisë, për ngritjen e kulturës e të arsimit të popullit tonë, për ngritjen e nivelit shoqëror, ekonomik e politik të tij... Duhet të kuptojmë edhe këtu, ashtu si e kuptuam në luftën e armatosur, se, për t'i kryer këto detyra, për t'i dhënë popullit një jetë më të lumtur dhe më të begatshme, duhet që populli i tërë të jetë faktori i kësaj vepre të madhe''.

ENVER HOXHA

1

1. Duke mbajtur fjalimin me rastin e Ditës së Pavarësisë dhe të ardhjes së Qeverisë Demokratike në Tiranë.

1945. Shqipëria po hynte në një epokë të re. Kurorëzim i revolucionit popullor, kjo epokë u lidh ngushtë me emrin e Partisë e të Enver Hoxhës, që, në krye të PKSH e të Qeverisë Demokratike Provizore, mbajti mbi supe peshën e rëndë dhe të vështirë të drejtimit dhe të forcimit të shtetit të ri. Frymëzues e organizator i betejave historike të popullit shqiptar për ndërtimin e Shqipërisë së re për 40 vjet me radhë pas Çlirimit, themeluesi dhe udhëheqësi i Partisë vuri në shërbim të atdheut gjithçka: energjitë fizike e mendore, talentin dhe aftësitë e shquara, kulturën dhe dijet e tij të gjera. Gjatë katër dekadave u shpalos në thellësinë e gjerësinë e vet personaliteti i madh i Enver Hoxhës si revolucionar, burrë shteti e marksist-leninist i shquar.

1. Dhjetor 1944.

1

2



3

1. Në përurimin e një ure të rindërtuar. 1945. **2.** Përurimi i kanalit për tharjen e kënetës së Maliqit. 1947. **3-7.** Pamje nga Shqipëria e pasluftës.

4

5

6



7

Qeverisë Demokratike Provizore të kryesuar nga Enver Hoxha i duhej ta niste punën për të ndërtuar gjithçka nga themelet. Mjerimi i trashëguar nga e kaluara, bujqësia tepër e prapambetur, industria primitive, popullsia analfabete në shumicën dërrmuese të saj, rëndohej edhe më shumë nga shkatërrimet dhe pasojat e luftës: qytete e fshatra të djegura, komunikacione të paralizuara, humbje të mëdha njerëzore e materiale. Divizionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare luftonin nazistët në territorin e Jugosllavisë, ndërsa brenda vendit po u jepeshin goditjet e fundit mbeturinave të reaksionit e komploteve të organizuara me mbështetjen e anglo-amerikanëve. Vendin e kërcënonte uria.

1

Atdhetarizmi, entuziazmi dhe energjitë e pashtershme të popullit ishin të vetmet pasuri të Shqipërisë në vitet e para të pushtetit popullor. Enver Hoxha i kushtoi kujdes të veçantë edukimit e mobilizimit revolucionar të popullit, të masave punonjëse të Shqipërisë së re. Ashtu si gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pas Çlirimit të vendit, Ai, me dashurinë dhe autoritetin e madh që gëzonte në popull, ishte një faktor i rëndësishëm i unitetit dhe i entuziazmit të popullit shqiptar për të ndërtuar Shqipërinë e re.



2

1. Miting popullor në Tiranë. 1945. **2.** Në Kongresin e Parë të Frontit Demokratik. Gusht 1945.

2

3



4

1

92-93 Në betejat e para për ndërtimin e Shqipërisë së re.

2

3

1-3. Reforma Agrare. Gjatë ndarjes së tapive të para të tokës në fshatin Gorre të Lushnjës. Nëntor 1945.

Nën udhëheqjen e Enver Hoxhës, Partia dhe shteti i demokracisë popullore menjëherë pas Çlirimit të vendit zbatuan një sërë reformash me karakter demokratik e revolucionar, të cilat u hapën udhë shndërrimeve në bazën dhe superstrukturën e shoqërisë shqiptare. Qëndrimi i prerë e parimor i Enver Hoxhës qe vendimtar për shpartallimin e rezistencës së klasave të përmbysura, si dhe të pikëpamjeve e veprimtarisë oportuniste e liberale që mbronin interesat e feudo-borgjezisë, për kryerjen e reformave radikale në Shqipëri. Reforma Agrare, e cila filloi të zbatohej në vitin 1945, ishte një ndër fitoret e mëdha që i siguroi revolucioni fshatarësisë shqiptare. Ajo realizoi ëndrrën e saj shekullore për tokë. Shtetëzimi i mjeteve kryesore të prodhimit ishte një tjetër veprim revolucionar, i cili, bashkë me Reformën Agrare, hapën rrugën e vendosjes së ekonomisë mbi baza socialiste.

2

1

3

Për më shumë se dyzet vjet me radhë ishin të dy krah për krah, në një jetë bashkëshortore të karakterizuar nga një miqësi e dashuri e thellë, e cila kishte lindur që në vitet e luftës, në punën e përbashkët si ushtarë të revolucionit. Komuniste e orëve të para, militante e vendosur e Partisë dhe e rinisë që në ato vite, një nga kuadrot e shquar të Partisë në vitet e socializmit, Nexhmije Hoxha qe për shokun Enver jo vetëm shoqja e dashur dhe e respektuar e jetës, por një ndihmëse e bashkëpunëtore e afërt, e cila i qëndroi pranë në luftë e në punë, në gëzimet e shqetësimet, i lehtësoi peshën e madhe që mbante mbi supe.

4

1. Në shtëpinë e shokut Enver Hoxha, dhoma ku bëheshin mbledhjet e Byrosë Politike në vitet e para pas Çlirimit. **2.** Enver Hoxha dhe Nexhmije Hoxha në vitin 1945. **3.** Shtëpia e banimit e Enver Hoxhës në vitet 1945-1973. **4.** Kryetari i KANÇ-it, Omer Nishani i jep shokut Enver Hoxha dekoratën "Hero i Popullit". 1945.

1

2



3

Fitorja e shkëlqyer e Frontit Demokratik në zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 konfirmoi edhe një herë besimin e popullit shqiptar te Partia Komuniste. Ishin krijuar tërë kushtet që populli, nëpërmjet përfaqësuesve të vet, të vendoste formën e regjimit të ri. Më 11 Janar 1946 Shqipëria u shpall Republikë Popullore. Enver Hoxha u ngarkua me detyrën e lartë të Kryetarit të Qeverisë së parë të Republikës. Nga viti 1946 deri në vitin 1954 Ai dha një kontribut të shquar në funksionet e Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të ministrit të Jashtëm të RPSH.

1. Enver Hoxha flet në Asamblenë Kushtetuese në emërtë Qeverisë. Janar 1946. **2.** Duke shkuar drejt ndërtesës së Asamblesë. Janar 1946. **3.** Para ndërtesës së Asamblesë Kushtetuese populli pret shpalljen e Republikës. 11 Janar 1946.

1

2

3

4

Njohja, afirmimi dhe mbrojtja e të drejtave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare ishin aspektet më të rëndësishme të politikës së Republikës Popullore të Shqipërisë në vitet e para të Çlirimit. Si Kryeministër e ministër i Jashtëm, Enver Hoxha me veprimtarinë e Tij politike e diplomatike, me kontaktet me burra shteti e përfaqësues të vendeve të ndryshme, punoi për forcimin e pozitës ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Pjekuria, vendosmëria e dinjiteti me të cilat Ai përfaqësoi Shqipërinë në arenën ndërkombëtare u shfaqën qartë në veprimtarinë si kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, në gusht-shtator 1946, ku Enver Hoxha mbrojti të drejtat e Shqipërisë si pjesëtare e koalicionit antifashist.

1. Pas mbledhjes për përvjetorin e parë të çlirimit të Tiranës. Nëntor 1945. **2.** Duke folur në Konferencën e Paqes në Paris. 21 gusht 1946. **3.** Në sallën ku u zhvillua Konferenca e Paqes. **4.** Në Aeroportin e Tiranës pas kthimit nga Parisi. Shtator 1946.

1

2

3

4

1. Kuç, tetor 1947. **2.** Mallakastër, shtator 1947. **3.** Drashovicë, tetor 1947. **4.** Mes një grupi fëmijësh në pragun e Vitit të Ri 1947. **5.** Në Gjirokastër, tetor 1947.

5

PKSH dhe Enver Hoxha ishin të bindur se nuk ishin konferencat apo konventat ndërkombëtare ato që do të siguronin pavarësinë dhe zhvillimin e vërtetë kombëtar. Në unitet rreth Partisë, me punë e vigjilencë, me dije e përpjekje do të ndërtohej, do të mbrohej e afirmohej Shqipëria e re. Një nga lajtmotivet më të fuqishme që përshkon jetën e Enver Hoxhës është dashuria dhe respekti i Tij për popullin, për njerëzit e thjeshtë. Enver Hoxha i udhëhoqi masat me një bindje të thellë se janë ato që bëjnë historinë.

1

2

3

4

1. Me J.V. Stalinin. Moskë, korrik 1947. **2.** Enver Hoxha pritet në Aeroportin e Moskës nga zëvendëskryetari i qeverisë sovjetike, V. Molotov. Korrik 1947. **3.** Në Stadiumin Qendror të Moskës gjatë një manifestimi fizkulturor-sportiv. Korrik 1947. **4.** Populli i kryeqytetit përshëndet shokun Enver Hoxha pas kthimit nga vizita në Bashkimin Sovjetik. Korrik 1947.

Në korrik 1947, me ftesë të qeverisë sovjetike, Enver Hoxha në krye të një delegacioni qeveritar të nivelit të lartë shkoi për një vizitë zyrtare në Bashkimin Sovjetik. Gjatë kësaj vizite Ai u takua për herë të parë me J.V. Stalinin, nxënësin dhe vazhduesin besnik të veprës së V.I. Leninit, revolucionarin dhe udhëheqësin e madh të komunizmit botëror, strategun e fitores kundër fashizmit. Gjatë viteve 1947-1951 Enver Hoxha do të takohej e do të bisedonte disa herë personalisht me J.V. Stalinin, duke ruajtur përshtypje të pashlyeshme për këtë personalitet të madh marksist-leninist. Kjo vizitë si dhe bisedimet që zhvilloi Enver Hoxha me J.V.Stalinin i shërbyen forcimit të lidhjeve reciproke, e bënë më të njohur luftën e Partisë e të popullit shqiptar kundër fashizmit, forcuan më tej pozitën e autoritetin e shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

1

2

1. Shoku Enver Hoxha vendos një kurorë në Mauzoleun e V.I.Leninit në Moskë. Moskë, mars 1949. **2.** Në Muzeun e V.I. Leninit në Moskë. **3.** Me Gj.Dimitrovin dhe V. Kolarovin. Sofje, dhjetor 1947. **4.** Gjatë vizitës në Bullgari.

3

4

Në dhjetor 1947 Enver Hoxha kryesoi delegacionin qeveritar të RPSH gjatë një vizite zyrtare në RP të Bullgarisë.ku u takua me një personalitet tjetër të shquar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, me Gjergj Dimitrovin, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste dhe Kryeministër i RP të Bullgarisë. Gjatë vizitës në këtë vend, Enver Hoxha njohu nga afër heroin legjendar të Lajpcigut. Te Dimitrovi Ai gjeti një mik të sinqertë që prej vitesh kishte ndjekur me simpati luftën e popullit e të komunistëve shqiptarë për liri e demokraci, kishte ndihmuar, si një nga drejtuesit e Kominternit, zhvillimin e lëvizjes komuniste në Shqipëri.

Në vitet 1944-1948 Partia dhe shteti shqiptar u vunë përpara një situate kërcënuese të shkaktuar nga veprimtaria antimarksiste e antishqiptare e PKJ dhe personalisht e J.B. Titos. Në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare Enver Hoxha ishte ndeshur shumë herë dhe u ishte përgjigjur me gjakftohtësi e prerë qëndrimeve e insinuatave antimarksiste e antishqiptare të udhëheqësve të partisë jugosllave, për të vënë nën drejtimin e kontrollin e tyre Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Pas Çlirimit të vendit Enver Hoxha, duke mbrojtur e duke zbatuar me konsekuencë vijën revolucionare të Partisë, me mbështetjen e masës dërrmuese të Partisë, luftoi për të shmangur pasojat e ndërhyrjes jugosllave, e cila vazhdonte të thellohej, duke arritur kulmin e vet në Plenumin e 8-të KQ të PKSH (shkurt 1948). Qëllimi i Titos dhe i drejtuesve të Jugosllavisë ishte aneksimi i RPSH nga Federata Jugosllave. Për t'ia arritur kësaj ata.punuan për minimin e unitetit të Partisë Komuniste të Shqipërisë e të udhëheqjes së saj, për sabotimin e zhvillimit ekonomik të vendit, për izolimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, sidomos nga Bashkimi Sovjetik e vendet e tjera socialiste. Në bashkëveprim me elementët e rekrutuar prej tyre deri në udhëheqjen e PKSH, goditjen kryesore e drejtuan kundër Enver Hoxhës, i cili ishte pengesa e pakapërcyeshme për planet e tyre dhe gëzonte një autoritet absolut në Parti e në popull. Enver Hoxha ishte faktor vendimtar dhe frymëzuesi i luftës së Partisë për shpartallimin e këtij komploti të rrezikshëm. Ai mbrojti vijën e Partisë nga sulmet dhe akuzat e jugosllavëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Enver Hoxha hodhi poshtë kategorikisht kërkesat e Titos për bashkimin e ushtrive, për futjen e divizioneve jugosllave në Shqipëri dhe për bashkimin e Shqipërisë me Federatën Jugosllave. Në këto momente kyç të historisë Enver Hoxha mbajti mbi supe një barrë të rëndë.

1



2

1. Në shtëpinë ku më 8 Nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë. Nëntor 1948. **2.** Duke hyrë në godinën ku zhvilloi punimet Kongresi I i PKSH. 8 Nëntor 1948. **3.** Shoku Enver Hoxha duke mbajtur raportin në Kongres.

Më 8-22 nëntor 1948 u mbajt në Tiranë Kongresi I i PKSH. Enver Hoxha mbajti raportin për punën dhe veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë. Kongresi e zgjodhi shokun Enver Hoxha Sekretar të Përgjithshëm të Partisë. Në mënyrë të sintetizuar shoku Enver u bëri një analizë të thellë gjendjes së Shqipërisë deri në pushtimin e saj nga Italia fashiste, forcave politike në shoqërinë shqiptare të kohës, lëvizjes komuniste në Shqipëri, deri në krijimin e PKSH, dhe vijës së ndjekur nga ajo gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Në mënyrë të veçantë shoku Enver Hoxha argumentoi rrezikshmërinë e veprimtarisë antishqiptare e trockiste të udhëheqjes së PKJ dhe të grupit armiqësor në shërbim të tyre. Orientimet themelore të Kongresit për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, për ndërtimin e bazave të socializmit në Shqipëri, u mbështetën në raportin e mbajtur nga Enver Hoxha.

3

1

2

3

1. Mes zgjedhësve të zonës elektorale nr. 108 në Tiranë. Maj 1950. **2.** Enver Hoxha, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, gjatë një inspektimi në zonën juglindore të vendit. 1949. **3.** Vizitë në spital ushtarëve të plagosur në luftimet kundër provokacioneve monarko-fashiste në kufijtë juglindorë. Gusht 1949.

1

2

Veprimtaria e gjithanshme teorike e praktike, udhëheqëse dhe organizuese e Enver Hoxhës në vitet '50 është shkrirë në themelet socialiste që u hodhën në ato vite në industri, bujqësi, kulturë, në ndryshimet rrënjësore në botën shpirtërore të njerëzve tanë. Veçanërisht, pas likuidimit të shkatërrimeve të luftës, filloi të materializohet programi i Partisë për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit. Me veprat e para industriale e bujqësore, me hapat që hodhi përparimi i arsimit e i kulturës në këto vite, nisi sfida heroike që u bëri populli shqiptar shekujve të prapambetjes. Në çdo hap përpara që bënte atdheu në rrugën e përparimit, në çdo vepër të re, në çdo arritje në ekonomi e në kulturë, ishin të pranishëm mendimi dhe veprimtaria e Enver Hoxhës.

3

4



5

6

1-2. Përurimi i Hekurudhës Tiranë-Durrës. Shkurt 1949. **3.** Në mbledhjen solemne për hapjen e tri instituteve të para të larta arsimore. Nëntor 1951. **4.** Enver Hoxha pret shiritin e përurimit të hidrocentralit «V. I. Lenin». Nëntor 1951. **5.** Në Maliq pas tharjes së kënetës. Tetor 1950. **6.** Në kombinatin e tekstileve «Stalin», ndër veprat e para të mëdha të industrisë sonë. Nëntor 1951.

1

1. Enver Hoxha mban raportin në Kongresin e 2-të të PPSH. 31 mars 1952. **2.** Në Konferencën e bujqve të dalluar. Shkurt 1952. **3.** Në Konferencën Kombëtare të punonjësve të NBSH-ve e SMT-ve. Mars 1954. **4.** Takim me Komandantin në ditën e festës së Ushtrisë Popullore. 10 korrik 1954. **5.** Në pushimin mes seancave të Konferencës Kombëtare të kultivuesve të pambukut. Qershor 1950.

2

3

4

5

Në Kongresin e 2-të të PPSH (31 mars - 7 prill 1952) u përpunua e u thellua më tej programi për zhvillimin e ekonomisë socialiste. Raporti i Enver Hoxhës dhe vendimet e Kongresit vunë theksin veçanërisht në shpejtimin e industrializimit të vendit, për të siguruar zhvillimin me ritme të larta të forcave prodhuese. Këtij synimi i shërbente edhe plani i parë pesëvjeçar, i cili u aprovua në Kongres. Në vitet që pasuan, zbatimi në jetë i vijës së përcaktuar nga Partia, nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha, solli fuqizimin e ekonomisë socialiste, ngritjen e një sërë veprash të industrisë së rëndë e të lehtë.

1

2

3

1. Enver Hoxha flet në mitingun e përmortshëm në ditën e varrimit të J.V. Stalinit. 8 mars 1953. **2.** Enver Hoxha dhe Hysni Kapo, në emër të KQ të PPSH, vendosin një kurorë para monumentit të J.V. Stalinit në Tiranë. **3.** Pamje nga mitingu i përmortshëm.

Më 5 mars 1953 komunistët dhe proletariati botëror, të gjithë popujt pësuan një humbje të rëndë: vdiq J.V.Stalini. Me dhimbje e priti këtë lajm të hidhur Partia dhe i gjithë populli shqiptar, të cilët kishin parë te J.V. Stalini një udhëheqës revolucionar të shquar e të papërkulur ndaj imperializmit e reaksionit, një mbrojtës të lavdishëm të çështjes së revolucionit e të popujve, një mik të madh e të sinqertë të Partisë e të popullit shqiptar. Në vitet që do të vinin, Enver Hoxha, me principialitet e guxim, do ta mbronte J.V.Stalinin, veprën e tij. Për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për shokun Enver Hoxha qëndrimi ndaj J.V.Stalinit ishte mbrojtja e kauzës së marksizëm-leninizmit, të revolucionit, së cilës Stalini i qëndroi besnik.



Në vitet '50 Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila në krye të popullit ishte mobilizuar për të çuar përpara zhvillimin dhe forcimin e vendit, iu desh të ballafaqohej me një armik të rrezikshëm e të fuqishëm, me revizionizmin hrushovian, që pas vdekjes së J.V.Stalinit mori pushtetin në Bashkimin Sovjetik. Enver Hoxha ndiqte me vëmendje e shqetësim proceset e evolucionit revizionist në Bashkimin Sovjetik. Nga viti 1953 deri në vitin 1960 Ai pati takime e mori pjesë në mbledhje të përbashkëta me udhëheqës sovjetikë e të partive të tjera komuniste e punëtore. Nga këto, si dhe nga veprimet konkrete politike Ai gjykonte mbi natyrën e vërtetë antimarksiste të grupit drejtues hrushovian. Shoku Enver Hoxha që në hapat e parë të sulmit frontal të N. Hrushovit ndaj marksizëm-leninizmit e sistemit socialist doli kundër koncepteve e qëndrimeve të tij. Në krye të udhëheqjes së PPSH Ai përcaktoi një vijë të drejtë e taktika të zgjuara, duke pasur parasysh interesat e lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist, interesat e marksizëm-leninizmit e të revolucionit. Veçanërisht, pas Kongresit të 20-të të PK të BS, Partia jonë dhe personalisht Enver Hoxha reflektuan thellë për kthesën kundërrevolucionare që po kryente udhëheqja sovjetike hrushoviane. Në këto situata të rënda, Enver Hoxha, që s'u ishte nënshtruar asnjëherë presioneve dhe shantazheve të N.Hrushovit për t'i imponuar Partisë sonë kursin e vet, iu kundërvu platformës revizioniste të Kongresit të 20-të, afirmoi parimet themelore të teorisë marksiste-leniniste. PPSH dhe Enver Hoxha ishin ndër të parët që kuptuan dhe i shpallën luftë kësaj force të rrezikshme kundërrevolucionare që kishte lindur në Bashkimin Sovjetik. Zhvillimet e mëvonshme vërtetuan drejtësinë e qëndrimeve të tyre. Vija e ndjekur nga Partia e Punës e Shqipërisë nën udhëheqjen e Enver Hoxhës ishte vendimtare për mbrojtjen e socializmit në Shqipëri, ajo siguroi pavarësinë e vendit, rriti prestigjin e autoritetin e Shqipërisë socialiste në botë.

1

2

3



4

1. Në qytetin e Vlorës për festimin e 45-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. 28 nëntor 1957. **2.** Në ditën e përurimit të Pallatit të Pionierëve në Tiranë. Dhjetor 1957. **3.** Me një delegacion të shqiptarëve të Argjentinës. Maj 1958. **4.** Mes kooperativistëve të Starovës, në Berat. Tetor 1958.

1

2

3

5



4

1. Pamje e godinës qendrore të Universitetit të Tiranës. **2.** Hapet universiteti i parë shqiptar. 16 Shtator 1957. **3.** Në Uzinën e Përpunimit të Naftës në Qytetin Stalin. Dhjetor 1957. **4.** Në ditën e përurimit të hidrocentralit «Karl Marks». Janar 1958. **5.** Me rastin e 50-vjetorit të lindjes, Enver Hoxhës i jepet titulli «Hero i Punës Socialiste». 16 tetor 1958.

Pas shekujsh të tërë luftërash me robërinë, shtypjen dhe injorancën, Shqipëria, atdheu i një populli që kurrë s'e ndau dashurinë për liri nga etja për kulturë e përparim, shikonte të plotësohej ëndrra e rilindësve, e patriotëve të mëdhenj për Gjithëmësonjëtoren shqipe. Enver Hoxha në krye të Partisë i hapi kombit dyert e dritës, të arsimit, të shkencës. Më 16 shtator 1957 Ai pret shiritin e përurimit të Universitetit të Tiranës.

1

2

3



4

1. Një udhëtim në det. Me shokët Ramiz Alia e Rita Marko. **2.** Mes shokësh e bashkëpunëtorësh të afërt. **3.** Në kooperativën bujqësore të Gostimës, Elbasan. **4.** Në një fshat të Tiranës. **5.** Me fëmijët. **6.** Një shëtitje familjare.

1

2

3

Veprimtaria e Enver Hoxhës si politikan e diplomat, pjesëmarrja e roli i Tij në marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit shqiptar, janë aspekt i rëndësishëm i personalitetit të Tij të madh. Ai ishte jo vetëm ideator e frymëzues i politikës së jashtme të vendit tonë, por gjatë jetës së vet prej udhëheqësi komunist revolucionar, Enver Hoxha ndikoi personalisht në zbatimin e saj, në realizimin e objektivave që synonte politika e jashtme e Shqipërisë socialiste. Pas Çlirimit të vendit, deri në vitin 1960, Enver Hoxha ka qenë në mjaft vende të botës e ka marrë pjesë në një numër të madh mbledhjesh e konferencash ndërkombëtare. Gjatë këtyre udhëtimeve e vizitave, si dhe në Shqipëri, Ai është takuar me mjaft per-

4

5

6

7

sonalitete të huaja, me kryetarë shtetesh e qeverish, me udhëheqës partish e organizatash politike të vendeve të ndryshme të botës. Sikurse në të gjithë veprimtarinë e Enver Hoxhës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në këto takime e bisedime shpesh të vështira e në rrethana të acaruara, janë shfaqur aftësitë e Tij të rralla si politikan e diplomat, logjika e fortë e njohja e gjerë e problemeve, vendosmëria në mbrojtjen e pozitave parimore të një politike të jashtme revolucionare. Veprimtaria e Enver Hoxhës ka peshë të rëndë në afirmimin dinjitoz të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, në mbrojtjen e interesave të saj jetike, në simpatinë që fitoi ajo te popujt e njerëzit përparimtarë të botës.

1. Takim me V.Pikun, president i RD Gjermane. Berlin, janar 1959. 2. Me Kryeministrin e Republikës Çekosllovake V. Shiroki. Tiranë, qershor 1957. 3. Një takim gjatë vizitës zyrtare në Çekosllovaki. Janar 1959. 4. Me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Punëtore Rumune G.Georgiu Dezh. Pekin, shtator 1956. 5. Me Kryeministrin e RP të Bullgarisë A. Jugov gjatë vizitës në Shqipëri. Janar 1957. 6. Gjatë vizitës në RP të Kinës. Shtator 1956. 7. Takim me kryeministrin e RDP të Koresë Kim Ir Sen në Aeroportin e Phenianit. Shtator 1956.

1

2

3

4

1. Në një miting të punëtorëve të një uzine të Leningradit. Prill 1957. **2.** Takim me Kryeministrin e RP të Hungarisë, F. Munih. Budapest, Janar 1959. **3.** Me Aiditin, kryetar i PK të Indonezisë. 1959. **4.** Gjatë vizitës në Jugosllavi. Korrik 1946. **5.** Duke ndjekur paradën për 40-vjetorin e Revolucionit të Tetorit. Moskë, nëntor 1957. **6.** Me Sekretarin e Përgjithshëm të PK të Francës, M. Torez.Nëntor 1959.

5

6



1

1. Në dhomën e punës në shtëpi. 1960.
2. Duke folur në një miting spontan të popullit të Beratit. 1961.

Në fundin e viteve '50 marrëdhëniet midis PPSH dhe PK të BS u acaruan së tepërmi. Ngjarjet kundërrevolucionare në Poloni e Hungari në vitin 1956 , bashkëpunimi i grupit të Hrushovit me Titon, synimet dhe përpjekjet brutale të udhëheqjes sovjetike për t'i imponuar Partisë sonë vijën e vet revizioniste e kundërrevolucionare, po zbulonin fytyrën e vërtetë të saj. Në dhjetor 1956 dhe në prill 1957, në Moskë Enver Hoxha u shprehu hapur Hrushovit e bashkëpunëtorëve të tij kundërshtimin parimor të PPSH për një sërë problemesh të rëndësishme të lëvizjes komuniste e punëtore dhe të gjendjes ndërkombëtare. Enver Hoxha në gjithë këtë periudhë ndiqte me vëmendje e shqetësim atmosferën e rëndë që po krijohej në lëvizjen komuniste e në kampin socialist duke reflektuar për shkaqet e saj. Në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (shkurt 1957) shoku Enver Hoxha trajtoi probleme të rëndësishme të zhvillimit botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duke arritur në konkluzione të cilat binin ndesh me idetë dhe frymën revizioniste të Kongresit të 20-të të PK të BS. Në Mbledhjen e Moskës (nëntor 1957) Enver Hoxha dha një kontribut të shquar që dokumenti i aprovuar atje të kishte në themel parimet revolucionare marksiste-leniniste. Pas vizitës. zyrtare të N. Hrushovit në Shqipëri (maj 1959) hendeku u bë më i thellë, për shkak të pozitave të papajtueshme të të dyja palëve. Në qershor 1960, në Mbledhjen e Bukureshtit, konflikti me revizionistët hrushovianë shpërtheu hapur. Delegacioni i PPSH, i orientuar nga udhëzimet e përpikëta e të vazhdueshme të Enver Hoxhës, kundërshtoi përpjekjet e Hrushovit për të diktuar në kampin socialist. Më 16 nëntor 1960, shoku Enver Hoxha mbajti fjalën historike në Mbledhjen e 81 Partive në Moskë, ku u bëri një kritikë dërrmuese koncepteve dhe veprimtarisë antimarksiste të grupit hrushovian. Nga kjo kohë filluan sulmet dhe presionet sovjetike u bënë të hapëta e të gjithanshme. Principialiteti revolucionar dhe qëndrimet e vendosura të Enver Hoxhës i shpëtuan Partinë dhe popullin nga tragjedia që përgatitnin sundimtarët e Moskës dhe aleatët e tyre.

2

1

2

3

1. Duke përshëndetur nga selia e Komitetit Qendror manifestimin popullor në prag të Kongresit të 4-t të P P S H. Shkurt 1961. **2.** Mes delegatëve të Kongresit të 4-t të P P S H. Shkurt 1961. **3.** Mes një grupi malësoresh nga Kopliku, ardhur në Tiranë me rastin e Kongresit të 4-t të P P S H. Shkurt 1961. **4.** Duke folur në Kongresin e 4-t të Partisë. Shkurt 1961.

4

Në shkurt 1961 u mbajt Kongresi i 4-t i PPSH. Ky Kongres zë një vend të veçantë në historinë e Partisë. Ai konfirmoi përfundimin e etapës së ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit. Enver Hoxha bëri bilancin e kësaj periudhe dhe e orientoi Partinë dhe vendin drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ndryshe nga ç'shpresonin revizionistët, me gjithë përpjekjet e të dërguarve të Hrushovit dhe të disa delegacioneve të tjera, Kongresi i 4-t aprovoi plotësisht vijën e ndjekur nga Komiteti Qendror i Partisë në luftën kundër revizionizmit modern. Fjala e Enver Hoxhës në Kongresin e 4-t të PPSH pati një jehonë të gjerë në mbarë popullin shqiptar. Ajo çoi peshë zemrat e njerëzve dhe shtoi krenarinë për Partinë dhe dashurinë e popullit për birin e tij të shquar, Enver Hoxhën.



2

1

3

1. Me shokun Gogo Nushi. 2. Në bazën ushtarako - detare të Vlorës. 1961. 3. Në kooperativën bujqësore të Pojanit të Korçës. Maj 1960. 4. Në mbledhjen solemne kushtuar 20-vjetorit të themelimit të P P S H dhe 44-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit. 5. Berat. Nëntor 1961. 6. Takim me shkrimtarë dhe artistë. Korrik 1961.

Detyrat e mëdha që do të zgjidheshin gjatë etapës së re në të cilën hyri vendi, ndërtimi i bazës materialo-teknike të socializmit, si dhe vështirësitë që krijoi tradhtia e revizionistëve hrushovianë, kërkonin mobilizimin e plotë të Partisë e të popullit. Si kurdoherë, Enver Hoxha i jepte një rëndësi vendimtare çelikosjes së lidhjeve Parti-popull, unitetit dhe mobilizimit të masave për realizimin e programit të saj revolucionar. Në vitet '60 Enver Hoxha me personalitetin e Tij të shquar si udhëheqës i Partisë dhe i popullit shqiptar, ishte faktor themelor i atij uniteti të madh që bëri të mundur përballimin e situatave që u krijuan pas konfliktit të hapët me revizionizmin hrushovian. Partia dhe Ai vetë zhvilluan një veprimtari të dendur e intensive që masat të kuptonin vijën e Partisë, perspektivën e zhvillimit të vendit, çelikosjen e mbrojtjes së tij. Më 7 nëntor 1961, në mbledhjen solemne me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe 44-vjetorit të Revolucionit të Tetorit, Enver Hoxha, në përgjigje të sulmeve publike të

4

5

6

N.Hrushovit kundër Partisë sonë në Kongresin e 22-të të PK të BS, demaskoi botërisht veprimtarinë e shëmtuar kundërrevolucionare e antishqiptare të renegatëve sovjetikë, zbuloi rrënjët dhe synimet e kësaj veprimtarie, afirmoi qëndrimin e palëkundur të Partisë sonë për çështjet themelore të teorisë dhe praktikës revolucionare. Lufta me revizionizmin hrushovian,që po zhvillohej prej vitesh në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, tashmë u shndërrua në një polemikë të hapët në të cilën Partia e Punës e Shqipërisë dhe personalisht Enver Hoxha do të shquheshin për qëndrimet konsekuente e të vendosura. Gjatë viteve '60,si dhe më pas, shoku Enver Hoxha me krijimtarinë e Tij teorike e publicistike u shqua si një njohës i thellë e mbrojtës i flaktë i teorisë revolucionare marksiste-leniniste. Artikujt e shumtë të shkruar prej Tij, si dhe veprat e tjera të kësaj periudhe ndriçojnë qartë këtë aspekt të personalitetit të madh të Enver Hoxhës.

"Figura e personaliteti i rrallë i Enver Hoxhës ndritën me një shkëlqim të veçantë edhe atëherë kur tradhtia oportuniste mbuloi lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia jonë e Punës me shokun Enver në krye nuk e lejoi revizionizmin modern të kalonte në Shqipëri. Dhe ai nuk kaloi pse Enver Hoxha e kishte kalitur Partinë në betejat e ashpra politike për mbrojtjen e pavarësisë e të socializmit, e kishte edukuar atë t'i qëndronte kurdoherë besnike marksizëm- leninizmit, të ishte deri në fund e papajtueshme me ideologjitë armiqësore të proletariatit".

Ramiz Alia

Portret i vitit 1961.

1

2



3

1. Një takim me ushtarakë në përvjetorin e festës së çlirimit. Nëntor 1964. **2.** Mes popullit të Peshkopisë. Qershor 1960. **3.** Një buqetë me lule te busti i Ismail Qemalit. Vlorë, 28 Nëntor 1962. **4.** Mes veteranëve të luftës për liri e pavarësi kombëtare.

Në momentet historike që kalonte populli shqiptar përkujtimi i datave të shënuara të historisë së tij merrte një karakter solemn. Ato ishin shembull e burim frymëzimi për brezat e sotëm të atdheut. Prania e Enver Hoxhës në këto festa, i kthente ato në një betim që populli bënte para Partisë dhe udhëheqësit të saj. Ai kishte gjithnjë dëshirë të ishte pranë njerëzve, mes bashkëluftëtarëve, mes popullit e rinisë në këto ditë të shënuara. Përkujtimi i 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare në nëntor 1962 në Vlorë, ishte një nga këto festa ku populli demonstroi para Enver Hoxhës gatishmërinë e vet për t'i shtuar historisë faqe të tjera, të ndritura e të lavdishme.

4

1

1. Në peshkim. 1959. **2.** Çast pushimi. 1962. 3. Në malin e Dajtit. 1964.

2

3

Këto fotografi fiksojnë çaste të kohës së lirë të Enver Hoxhës. Gjatë verës, pas periudhave veçanërisht të ngarkuara, të dielave apo në ditë festash, këto ishin pauza çlodhëse të cilat atij i pëlqente t'i kalonte në natyrë, mes shokëve të afërt apo në familje. Këto ishin momente pushimi nga punët e përditshme korente, nga mbledhjet, nga takimet zyrtare. Por edhe gjatë këtyre orëve e ditëve në dukje të qeta, mendimet shkonin te hallet e atdheut, të popullit. Studionte, shkruante, meditonte, i pashkëputur për asnjë çast nga detyrat e preokupimet e Tij të mëdha.

1

2



3

4

5

1. Në shkollën e mesme „Qemal Stafa" në Tiranë. 1965. **2.** Në përvjetorin e formimit të batalionit "Fuat Babani" të Devollit. Gusht 1965. **3.** Një vizitë në Uzinën e Telave në Shkodër. Qershor 1964. **4.** Mes efektivit të një reparti të Ushtrisë Popullore. Janar 1966. **5.** Duke bërë konkluzionet e një stërvitjeje ushtarake. Janar 1966.

Situatat e vështira që i ishin krijuar atdheut, rreziqet që i kërcënoheshin, kërkonin në ato vite një unitet të çeliktë të kombit, një përgatitje të gjithanshme ekonomike, politike e ushtarake të masave popullore. Enver Hoxha, udhëheqësi i Partisë, qe farkëtuesi i këtij uniteti, qe faktor i fuqishëm në përballimin e provës së viteve '60. Mendimi, puna e Tij drejtuese e organizuese, autoriteti i madh e dashuria e thellë që gëzonte, qenë gurë themeli të unitetit të popullit rreth Partisë, të zhvillimit të gjithanshëm të vendit, të sigurimit të mbrojtjes së atdheut.

1

Më 1-7 nëntor 1966 zhvilloi punimet në Tiranë Kongresi i 5-të i PPSH. Enver Hoxha, në raportin që mbajti në Kongres, parashtroi një sërë konkluzionesh të rëndësishme për shkaqet e degjenerimit të partisë e të shtetit sovjetik. Ai nënvizoi rolin që luajtën në tragjedinë sovjetike fenomene të tilla si: burokratizmi e teknokratizmi, krijimi i kastave e i shtresave të privilegjuara, humbja e vigjilencës revolucionare dhe sklerotizimi i partisë së klasës punëtore. Analizat e konkluzionet e shokut Enver Hoxha patën rëndësi vendimtare për parandalimin e një procesi të tillë edhe në Shqipëri. Me iniciativën dhe nën drejtimin e Tij, Partia kishte filluar të merrte masa të rëndësishme praktike për shmangien dhe eliminimin e shfaqjeve të burokratizmit, të nënvleftësimit të masave punonjëse. Kongresi i 5-të theksoi domosdoshmërinë e thellimit të revolucionit ideologjik si hallkë themelore për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist, për forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletariatit. Kjo do të ngrinte në një shkallë më të lartë rolin trahsformues të ideve revolucionare marksiste-leniniste për zhvillimin e gjithë shoqërisë. Vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë u dhanë një hov të madh lëvizjeve të fuqishme revolucionare në vendin tonë. Pas këtij Kongresi u ngrit në një shkallë më të lartë veprimtaria e masave punonjëse në të gjitha fushat e jetës së vendit, lindën një sërë iniciativash revolucionare të frymëzuara nga idetë e vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë.

2

3

1. Enver Hoxha mban raportin në Kongresin e 5-të të PPSH. Nëntor 1966. **2-3.** Në pushimet midis seancave të Kongresit.

1. Me nënën. Tiranë, 16 tetor 1966. **2.** Me nënën e Heroit të Popullit Asim Zeneli. Gjirokastër, dhjetor 1966. **3.** Në shtëpinë ku lindi në Gjirokastër. **4.** Me vëllanë e Heroit të Popullit Myzafer Asqeriu. **5.** Në rrugët e qytetit të lindjes.

1

2

3

4

5

Sa emocione dhe kujtime i ngjallte Enver Hoxhës qyteti i Tij i lindjes, Gjirokastra e dashur, Gjirokastra e fëmijërisë dhe rinisë! Çdo rrugë, çdo gur i kujtonte copëza të tilla jete që njeriu i mbart kurdoherë me mall me vete. Vizitat në Gjirokastër, bisedat me njerëzit e thjeshtë, shëtitjet në rrugët e gurta e karakteristike për këtë qytet, ishin për Enver Hoxhën jo vetëm çaste çmalljeje, por edhe një burim i pashtershëm dashurie për popullin, për atdheun. Tek Enver Hoxha dashuria për qytetin ku kishte lindur ishte e pandarë nga dashuria për tokën amtare. Kjo dashuri e shkrirë në mënyrën më harmonike mishëronte tek Ai një nga tiparet e Tij më njerëzore.

Në fundin e viteve '60, pas Kongresit të 5-të të Partisë, Enver Hoxha është iniciatori i masave që u morën për thellimin e revolucionit ideologjik, për forcimin e Partisë e të shtetit, për perfeksionimin e mëtejshëm të bazës e të superstrukturës së shoqërisë. Këto ishin fryt i një reflektimi të thellë për rezultatet që ishin arritur në Shqipëri në zhvillimin material e shpirtëror, si dhe për përvojën e shkaqet e degjenerimit të partive e të shteteve të klasës punëtore në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera. Më 6 shkurt 1967 Enver Hoxha mori pjesë në mbledhjen e përbashkët të disa organizatave-bazë të Partisë të Tiranës, ku mbajti fjalimin e tij të njohur "Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i pushtetit", i

Duke folur në një miting popullor. Qershor 1967.

cili pati një jehonë të madhe e të menjëhershme në gjithë vendin. Reflektimet e konkluzionet e Enver Hoxhës në fjalimet e materialet e tjera të Tij për probleme kapitale të zhvillimit ideologjik, politik e ekonomik të vendit u përqafuan nga Partia dhe populli, dhanë shkëndijën për shpërthimin e lëvizjeve revolucionare që krijuan një atmosferë të shëndetshme në shoqërinë shqiptare. Edhe në këto vite u konkretizua lidhja e ngushtë e popullit me Partinë, u konfirmua vitaliteti i asaj praktike që kishte ndjekur ajo,në të cilën Partia paraprinte me përgjithësimet e idetë e veta revolucionare dhe masat,duke i realizuar ato në jetë.hapnin perspektiva të reja zhvillimi e përparimi, i jepnin Partisë përvojën e re revolucionare.

1

2

3

1. Një ndalesë gjatë rrugës Vlorë-Dhërmi. Shkurt 1968. **2.** Mes metalurgëve të Rubikut. Maj 1968. **3.** Shijak, shkurt 1967. **4.** Në Uzinën e Plehrave Azotike në Fier. Qershor 1968.

4

Lëvizjet popullore dhe masat konkrete që mori Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit krijuan një atmosferë të gjallë, dinamike pune dhe krijimi. Ato i dhanë një impuls të fuqishëm veprimtarisë së masave punonjëse për të realizuar vijën e Partisë për fuqizimin e ekonomisë popullore, veçanërisht për thellimin e industrializimit të vendit. Duke kapërcyer vështirësitë e krijuara nga sovjetikët, Shqipëria vazhdoi rrugën e vet drejt përparimit. Në vitet '60 ekonomisë iu shtuan një sërë veprash e degë krejt të reja të industrisë. Metalurgjia, industria kimike e ajo mekanike, energjetika, minierat morën një zhvillim të vrullshëm.



3

1

2

4

1. Gjatë një shëtitjeje në Vlorë. 1968. 2. Në uzinën "Traktori" në Tiranë. 1969. 3. Një vizitë në Uzinën Metalike në Gjirokastër. 1966. 4. Mes punëtorëve të Kombinatit të Trikotazhit në Korçë. 1970. 5. Me ndërtuesit e Hidrocentralit të Vaut të Dejës. 1967.

5



1 **2**

1. Çast pune. **2.** Faksimile artikujsh, tezash e shënimesh të Enver Hoxhës në vitet '60.

Në vitet '60 Enver Hoxha zhvillon një veprimtari veçanërisht të dendur krijuese publicistike. Polemika e madhe me revizionizmin modern dhe situatat e ndërlikuara politike ndërkombëtare qenë një impuls i fortë për reflektime të thella, të cilat u pasqyruan në një numër të madh artikujsh të botuar në këtë kohë. Enver Hoxha thellon më tej analizën e kthesës kundërrevolucionare në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera të ish-kampit socialist, duke arritur në konkluzione e përgjithësime të rëndësishme për një sërë çështjesh kapitale të teorisë e të praktikës së revolucionit. Publicistika e Enver Hoxhës karakterizohet nga patosi revolucionar, nga frymëzimi për të mbrojtur e afirmuar çdo gjë të re, përparimtare, për të dënuar e demaskuar shtypjen e njeriut e të popujve, çdo gjë të shëmtuar e regresive në kohën tonë. Në të pas-

qyrohet njohja e thellë e filozofisë dhe e historisë, ndjekja e vëmendshme e zhvillimeve aktuale, kultura e gjerë dhe e thellë e autorit. Në shkrimet e Enver Hoxhës u pasqyruan qëndrimet revolucionare të PPSH dhe të shtetit shqiptar ndaj politikës hegjemoniste të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik në botë, dënimi i luftës së SHBA-së kundër Vietnamit e popujve të Azisë Juglindore, i agresionit izraelit kundër vendeve arabe, i politikës neokolonialiste në Afrikë, në Amerikën Latine e gjetkë nga metropolet imperialiste. Me indinjatë të thellë u dënua nga Partia e populli shqiptar sulmi kundër Çekosllovakisë në gusht të vitit 1968, të cilin Enver Hoxha në shkrimet e Tij e quajti një agresion fashist. Me propozimin e Tij, në shtator 1968, u shpall denoncimi i Traktatit të Varshavës dhe dalja e Shqipërisë nga ky traktat, që ishte bërë tashmë vegël e politikës imperialiste të Bashkimit Sovjetik.



1. Në Kongresin e 4-t të Frontit Demokratik. Shtator 1967. **2.** Me Myslim Pezën në 25-vjetorin e Konferencës së Pezës. Shtator 1967. **3.** Mes kooperativistëve në rrethin e Kukësit. Maj 1970. **4.** Në ndërmarrjen bujqësore "Lufta e Vlorës" të Llakatundit. Gusht 1970.

1

2



3

4

Takimet me popullin, udhëtimet e vizitat në krahinat dhe qytetet e vendit, në Veri e në Jug, edhe në këto vite, janë pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e punës dhe e veprimtarisë së Enver Hoxhës. Në momente të ngarkuara me ngjarje, me zhvillime të reja, Ai gjen kohë të shkojë mes popullit, të bisedojë me të, sepse Enver Hoxha i kushtonte vëmendje të posaçme sqarimit të masave, shpjegimit të vijës e të politikës së Partisë, masave të reja që merrte Partia për përparimin në ekonomi, ideologji e kulturë. Çdo problem që kishte vendi, çdo rrezik që i kërcënohej atdheut ishte objekt i këtyre bisedave të udhëheqësit me popullin.

1

2

3

Idetë e Enver Hoxhës i dhanë shkëndijën shpërthimit të asaj situate të gjallë revolucionare, që fryu si një rrymë e freskët dhe e shëndetshme në jetën e shoqërisë. Gjithçka e re, përparimtare që ishte futur në jetën dhe në shpirtin e njerëzve gjatë viteve të socializmit u ngrit kundër mbeturinave të forcave të errësirës, të prapambetjes, të shtypjes shpirtërore. Veçanërisht, femra shqiptare, skllavja e dyfishtë e së kaluarës, gjeti te Partia dhe Enver Hoxha forcën për të luftuar, guximin për të arritur atë që vetëm socializmi mund ta bënte realitet: çlirimin e plotë ekonomik, politik e shoqëror. Fjala e 6 shkurtit si dhe fjalimi i shokut Enver Hoxha "Mbi disa aspekte të problemit të gruas shqiptare" në qershor 1967, qenë një thirrje e re për popullin e Partinë, për gratë dhe të rejat e Shqipërisë për të ecur me guxim përpara për të vënë në vend një padrejtësi të trashëguar nga historia e shoqërisë me klasa antagoniste.

4

5

6

1. Në Kombinatin e Tekstileve në Berat. 1969. **2.** Në një takim me të reja malësore që mësojnë në një kurs në Durrës. 1968. **3.** Mes punëtorëve korçarë. 1970. **4.** Një takim me punonjës në Vorë. 1970. **5.** Një bisedë me specialistë të kooperativës bujqësore të Petrelës. 1971. **6.** Takim me veteranë në selinë e KQ të PPSH. 1970.

1

2

3

4

5

1-3. Në rrethin e Dibrës, pas tërmetit. Dhjetor 1967. **4.** Bisedë me specialistë të ndërtimit. **5.** Takim me shoferë, që transportojnë materiale ndërtimi, gjatë udhëtimit në zonat e dëmtuara.

Në dhjetor 1967, në një dimër të ashpër si rrallë ndonjëherë, një tërmet i fuqishëm goditi disa rrethe të Veriut. Veçanërisht të ndieshme ishin dëmet në rrethin e Dibrës. Në këtë fatkeqësi, të shkaktuar nga forcat e verbra të natyrës, popullit të krahinave të dëmtuara iu gjendën pranë Partia dhe pushteti popullor, gjithë populli shqiptar. Me porosi të udhëheqjes së Partisë e personalisht të Enver Hoxhës, të gjitha shpenzimet për ndërtimin e banesave e të objekteve të tjera të dëmtuara e të shkatërruara u përballuan nga shteti. Në ato ditë të vështira udhëheqësi i Partisë dhe i popullit shkoi vetë në rrethin e Dibrës për t'u dhënë zemër njerëzve, për t'u çuar fjalën dhe kujdesin e ngrohtë të Partisë.

1

Historia e kombit kishte për Enver Hoxhën një kuptim të madh. Ajo ishte dëshmi e vitalitetit të popullit shqiptar, e etjes së tij për liri e përparim, për dije e kulturë. Vepra e madhe e brezave të mëparshëm, e luftëtarëve popullorë, e burrave të shquar që kishte nxjerrë toka shqiptare ishte për të objekt respekti e admirimi. Përkujtimi i ngjarjeve të mëdha të historisë ishte për Enver Hoxhën një evokim i ndërgjegjshëm, nga i cili brezat e sotëm të kombit merrnin mësime të çmuara. Personalisht Enver Hoxha kishte një pasion të madh për historinë dhe shkencat e lidhura me të. Ai ndiqte studimet e zbulimet e reja për historinë e epokave të kaluara po aq me vëmendje, sa edhe zhvillimet e historisë bashkëkohore. Si udhëheqës i Partisë e si mendimtar marksist-leninist,

2

3

4

5

Ai dha një kontribut të madh në zhvillimin e shkencës sonë historike dhe tregoi një kujdes të veçantë për studimin e thellë të historisë së kombit, të gjuhës e të traditave të shquara të tij. Qëndresa e popullit shqiptar të udhëhequr nga Skënderbeu kundër invazionit osman në Evropë, ishte pjesë e krenarisë dhe e ndërgjegjes kombëtare. Por ajo epokë ishte edhe një simbol, një shembull frymëzues, dëshmitare e vazhdimësisë të cilësive të popullit tonë të trashëguara e të përtëritura brez pas brezi. Pesëqind vjet pas vdekjes së Skënderbeut Shqipëria qëndronte përsëri në këmbë e gjallë, mishërim i forcës së një populli që kishte gjetur rrugën e vet drejt së ardhmes, që kishte forcën dhe vullnetin për të ecur, që kishte udhëheqësin që e printe.

1-3. Në 500-vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Krujë, janar 1968. **4.** Para përmendores kushtuar Kuvendit të Lezhës. Lezhë, janar 1968. **5.** Në sheshin "Skënderbej", me skulptorët autorë të monumentit kushtuar Heroit Kombëtar, pak çaste pas përurimit të tij. Tiranë, janar 1968.

1

2

3

4

5

6

7

1. Duke folur në mitingun e të rinjve vullnetarë në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier. Gradishtë, 28 qershor 1968. **2-6.** Mes vullnetarëve të hekurudhës. Qershor 1968. **7.** Udhëtimi i parë nga Fieri në Tiranë.

Për brezat e rinj të Shqipërisë së re Enver Hoxha ishte jo vetëm udhëheqësi i dashur i popullit, i Partisë,por edhe mësuesi, prindi dhe njeriu i afërt.Epoka e socializmit i hapi rinisë shqiptare rrugët e gjera të përparimit, të jetës së lumtur, të dijes e të kulturës. Për Enver Hoxhën rinia ishte një pasuri e madhe, e çmuar e kombit, ajo që i jepte atdheut jetën e gjallërinë. Preokupimi për rritjen dhe edukimin e saj ishte përherë i pranishëm në gjithë veprimtarinë e Tij si udhëheqës i Partisë, si një preokupim për të ardhmen e kombit. Prandaj rritja e shëndetshme e brezave të rinj e, mbi të gjitha, formimi i tyre si njerëz të së ardhmes, me mendime të përparuara, me kulturë të gjerë e dije të thella, si njerëz që do t'i kushtoheshin popullit dhe atdheut, është një nga kujdeset e mëdha të shokut Enver Hoxha gjatë gjithë jetës së Tij.

1

2

3

1. Korçë, nëntor 1967. **2.** Me gurskalitësit e vegjël të Beratit. Shkurt 1969. **3.** Në shtëpinë e fëmijëve "8 Nëntori", Tiranë. Nëntor 1969. **4.** Një pushim i shkurtër në rrugën Tiranë-Shkodër. Qershor 1967. **5.** Vlorë. Shkurt 1968. **6.** Pranë ushtarëve. Shëngjin, gusht 1967.

Pas punëve intensive Enver Hoxha çlodhej duke u ndodhur mes njerëzve, mes fëmijëve. Takohej me ta, shtrëngonte fort duart dhe niste thjesht një bisedë e ngrohtë dhe e çiltër. Emocionet e natyrshme të këtij takimi treteshin menjëherë, sepse biseda e tyre ishte vazhdimi i asaj bisede të madhe dhe të pandërprerë që udhëheqësi zhvillonte çdo orë e çast me popullin e Tij. Kujtesa e pashtershme e popullit i përcjell nëpër vite këto takime të paharruara.

4

5

6

1

2

3

4



5

1. Gjatë një shëtitjeje në një rrugë të Tiranës. Maj 1970. **2-3.** Në Llogara. Gusht 1969. **4.** Në Ujin e Ftohtë në Vlorë. Gusht 1969. **5.** Në Karaburun. Janar 1972.

2

1

3

Në Gjirokastrën aq të dashur për të, mes njerëzve që e presin. Ka dëshirë të kuvendojë me ta, të çmallet me qytetin. Dhe një mbrëmje, ka dëshirë të dalë në qetësinë e natës, nëpër sokakët e heshtur. Të dëgjojë kumbimin e hapave nëpër gurët e Qafës së Pazarit, që ndoshta i kujtojnë tingujt që lëshonin prokat e këpucëve tek bridhte me vrap nëpër rrugicat e fëminisë. Të ecë, sokak më sokak, portë më portë, t'i tregojë shoqes së Tij, Nexhmijes, gjeografinë e qytetit dhe historitë e bukura të viteve që kanë shkuar...Por, qyteti s'fle. Dikush hap perden e dritares, dikush kthehet nga puna dhe... rruga mbushet me njerëz. Merr fund vetmia, mësimi i gjeografisë, udhëtimi në fëmini. Por s'ka asnjë shenjë keqardhjeje në sytë e Tij, tek u flet e i dëgjon me buzë në gaz.I pëlqente Enverit të bisedonte shtruar me njerëzit.



1-4. Një shëtitje natën nëpër rrugët e qytetit të lindjes. Gjirokastër, maj 1969.

"Kam pasur një mall të madh të vija një herë në Dragobinë tuaj, të dëgjuar aq shumë për trimëri, që t'ju shikoja, në radhë të parë, ju malësorët, prindër, vëllezër, motra, djem e çupa të mira që jetoni në këtë skaj të largët të atdheut, ku të parët tanë dhe ju vetë keni luftuar e tani po punoni me vrull për jetën e re, për socializmin. Dëshiroja të vija një herë këtu për të parë këtë vend të mahnitshëm, nga më të bukurit e Shqipërisë, të shihja jo vetëm bukuritë e tij të mrekullueshme natyrore, por edhe madhështinë e tij të një kështjelle historike të pamposhtur".

Enver Hoxha

1

2

1. Shokët Enver Hoxha dhe Ramiz Alia vendosin një kurorë në bustin e Heroit të Popullit Bajram Curri. Maj 1970. 2. Dragobi. 31 maj 1970.

Zonat e Veriut, ku dikur mbretëronin varfëria dhe prapambetja e theksuar, në vitet e Partisë po jetonin një zhvillim të vrullshëm e të gjithanshëm ekonomiko-kulturor. Socializmi përfshiu të gjithë vendin në një proces transformimi që siguronte zhvillimin harmonik të krahinave, të Jugut e të Veriut. Hapja e minierave të reja, e uzinave dhe fabrikave, kishte sjellë edhe në Veri një frymë të re përparimi, kishte bërë të lindte e të forcohej atje, krahas fshatarësisë kooperativiste, edhe një klasë punëtore e zhvilluar. Për vetë Enver Hoxhën, takimet me popullin patriot të malësive të Veriut gjatë kësaj vizite që bëri Ai në qershor 1970 ishin jo vetëm një bisedim i ngrohtë dhe i çiltër, por edhe një forcë e pashtershme që populli ia kishte dhënë kurdoherë Partisë, me patriotizmin e tij të flaktë, me luftën për përqafimin e së resë dhe të ideve të Partisë për transformimin rrënjësor të gjithë jetës, në të gjitha aspektet e saj.

1



2

3

1. Gju më gju me malësorët e Hasit. Qershor 1970. **2-3.** Valbonë. Qershor 1970.

1

2

1. Duke folur në mitingun e popullit të rrethit të Pukës. Qershor 1970. **2.** Nga vizita në rrethin e Shkodrës. Qershor 1970. **3-6.** Pamje nga takimi me veteranë dhe pjesëtarë të familjeve që kanë qenë baza strehimi gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Tetor 1971.

3

5

4

6

Enver Hoxha ruajti të pashlyeshme gjatë gjithë jetës së Tij dashurinë dhe respektin për njerëzit e thjeshtë të popullit, për ata njerëz që gjatë viteve të vështira të luftës e strehuan në shtëpitë dhe kasollet e tyre, për ata që i dhanë lirisë bijtë dhe bijat e tyre. Në çdo vizitë që bënte nëpër rrethet e ndryshme të Shqipërisë, ndër njerëzit e parë që do të takonte qenë veteranët e luftës, prindërit, bijtë e bijat e të rënëve. Mes popullit dhe udhëheqësit gjatë gjithë viteve u krijuan lidhje të tilla shpirtërore, lidhje që mund të krijohen vetëm mes birit dhe prindit. Megjithëse vitet rridhnin dhe flokët e Enver Hoxhës zbardheshin, Atij të gjitha nënat i thirrën thjesht, Bir. Enver Hoxha kishte mall për t'i takuar, për të biseduar, për të kujtuar. Dhe kishin ç'të kujtonin!

1

2

3

4

Në Kongresin e 6-të të PPSH (1-7 nëntor 1971), Enver Hoxha përgjithësoi përvojën e punës së Partisë, të lëvizjeve të fuqishme revolucionare të masave punonjëse e të gjithë popullit shqiptar për thellimin e revolucionit socialist në të gjitha fushat. Ai bëri një sërë përgjithësimesh të rëndësishme për forcimin e diktaturës së proletariatit, nëpërmjet tërheqjes gjithnjë e më të gjerë e më aktive të masave në drejtimin e vendit. Shoku Enver theksoi domosdoshmërinë e thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, si një detyrë imperative për t'i mbyllur shtigjet degjenerimit të shtetit e të shoqërisë socialiste. Fitorja e socializmit, çdo hap përpara i revolucionit nuk mund të kuptoheshin pa çlirimin shpirtëror të njerëzve. Me vlerë të madhe teorike e praktike ishin konkluzionet marksiste- leniniste të shokut Enver Hoxha për rolin udhëheqës të Partisë, për forcimin e kalitjen e saj ideologjike, politike e organizative.

1. Enver Hoxha mban raportin në Kongresin e 6-të të PPSH. Nëntor 1971. **2.** Në ditën e përfundimit të punimeve. 7 nëntor 1971. **3-4.** Në pushimet midis seancave të Kongresit.

1

2



3

4

5

6

7

Enver Hoxha e konsideronte vendimtar kuptimin e thellë të vijës dhe të direktivave të Partisë nga masat punonjëse. Ai jep një sërë orientimesh për zbërthimin e vendimeve të Kongresit në popull, në organizatat e Partisë në bazë, në kolektivat punonjës në qytet e në fshat. Vetë Ai, në bisedat e takimet me kuadro drejtues të Partisë,të shtetit e të ekonomisë, me punëtorë, fshatarë, me popullin, e quante një moment tepër të rëndësishëm shpjegimin e qartë të politikës së jashtme e të brendshme të Partisë, të programit të saj për zhvillimin e gjithë vendit, por edhe për çdo rreth, krahinë e qytet.

1. Në Çorovodë. 27 nëntor 1971. **2.** Pas vizitës në Muzeun e rrethit të Skraparit. **3.** Në mitingun e popullit të Çorovodës. **4, 6.** Vizitë në Uzinën Mekanike në Poliçan, Skrapar. **5.** Me Heroin e Popullit, Zylyftar Veleshnja. Berat, dhjetor 1971. **7.** Mes artistëve amatorë të Skraparit. 28 nëntor 1971.

1

Në fjalën e mbajtur në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit (shkurt 1972) Enver Hoxha trajtoi teorikisht dhe lidhur ngushtë me praktikën e socializmit në vendin tonë raportin dialektik midis masave punonjëse e partisë revolucionare të klasës punëtore në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Shoku Enver Hoxha parashtroi një sërë idesh të rëndësishme për rritjen e rolit të masave në jetën ekonomike, politike e ideologjike të shoqërisë. Duke afirmuar parimin vendimtar të rolit udhëheqës të Partisë në revolucion e në ndërtimin e shoqërisë socialiste, Ai theksoi domosdoshmërinë e një pjesëmarrjeje gjithnjë e më të gjerë, më të ndieshme, më të drejtpërdrejtë të masave në përcak-

2

3

4

timin e vijës së Partisë e të shtetit dhe në realizimin e saj praktik. Ai shtroi si një kërkesë të madhe të kohës rritjen e rolit të masave, të organeve të zgjedhura të pushtetit, vendosjen e raporteve të drejta në organet qendrore të pushtetit midis komunistëve dhe atyre pa parti, sjelljen në forumet dhe organet e Partisë e të shtetit të më shumë punëtorëve, forcimin e kontrollit të masave ndaj kuadrove e drejtuesve. Idetë e rëndësishme të Enver Hoxhës në fjalimin e 26 shkurtit 1972 i dhanë një impuls të ri punës së Partisë, të shtetit, vrullit të masave punonjëse. Ato përbënin një kontribut të ri në luftën e tyre kundër burokratizmit.

1. Duke folur në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit. Shkurt 1972. **2, 4.** Bisedë me anëtarë të plenumit të KP të Rrethit të Matit. **3.** Gjatë një shëtitjeje në qytetin e Burrelit.

1

2

1. Mes fëmijëve që dhanë shfaqje në Koncertin e Yllkave të Partisë. 13 qershor 1972. **2.** Korçë, gusht 1972. **3.** Nga takimi në kooperativën bujqësore të Plasës. **4.** Në Ndërmarrjen e Qilimave, Korçë. **5.** Në Ndërmarrjen e Prodhimit të Rrobave të Gatshme. **6.** Një bisedë me drejtues e punonjës.

Muaji qershor fillon me një festë të bukur,me Ditën e Fëmijëve. Rrugët ushtojnë nga zërat e tyre të gëzuar, mes tyre e ndjen veten në mes të një pranvere. Eshtë e bukur kjo ditë për fëmijët e veçanërisht kur midis tyre është xhaxhi Enveri. Sa herë është ndodhur Ai mes fëmijëve, pjesëtar në gëzimin dhe këngën e tyre. Ja, këta fatosa, që kënduan dhe kërcyen para xhaxhi Enverit, nuk do ta harrojnë 13 qershorin e vitit 1972. Jo se për ndonjërin nga kjo ditë filloi jeta e artit, por sepse ndjeu mbi flokë dorën e ngrohtë të xhaxhi Enverit, sepse iu hodh në qafë dhe e puthi fortAtë. Ka ditë në jetën e njeriut që mbeten të pashlyera. E tillë është edhe kjo ditë për këta fëmijë.

3

4

5

6

Pasqyrim i dëshirës së Enver Hoxhës për të qenë sa më shpesh fizikisht midis njerëzve të punës, për të biseduar personalisht me ta, është edhe kjo vizitë e gushtit të vitit 1972 në Korçë. Vizitat në këtë qytet kishin për të një atmosferë të veçantë. Ai shkonte shpesh në këtë qendër të rëndësishme ekonomike e kulturore të vendit tonë për punët e Partisë e të shtetit apo edhe gjatë pushimeve. Pas takimeve e bisedave për çështjet e mëdha që e preokuponin, i pëlqente të shëtiste në rrugët e qytetit,ku kishte kaluar një pjesë të rinisë, të takonte miqtë e shokët e Tij të atyre viteve.

1

2

3

4

5

Viti 1973 nisi me një ngjarje kuptimplote: krijimi i Akademisë së Shkencave. Pjesëmarrja e Enver Hoxhës në këtë eveniment të shënuar në historinë e kulturës shqiptare ishte simbol i pjesëmarrjes së Tij si udhëheqës i Partisë dhe personalitet i madh i shkencës e i kulturës sonë në atë zhvillim e përparim të paimagjinueshëm kulturor të Shqipërisë socialiste. Në më pak se tri dekada të historisë së vet, populli ynë kishte kapërcyer shekuj të tërë prapambetjeje, injorance, errësire. Tashmë Shqipëria kishte shkencën dhe shkencëtarët e vet,që i paraprinin një armate specialistësh të fushave më të ndryshme.Krijimi i Akademisë së Shkencave të RPSH qe një akt tjetër që konfirmonte kapërcimin që kishte realizuar epoka e socializmit në Shqipëri.

1. Në ditën e krijimit të Akademisë së Shkencave të RPSH me prof. Aleks Budën e prof. Eqerem Çabejn. Janar 1973. **2.** Duke ndjekur punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Nëntor 1972. **3.** Me prof. Foto Çamin, Kahreman Yllin dhe prof. Luan Omarin. Janar 1973. **4.** Me prof. Dhimitër Shuteriqin. Dhjetor 1971. **5.** Gjatë zhvillimit të Kuvendit të Studimeve Ilire. Shtator 1972.

Vjeshtë 1972.

1

2

3

Në fillimin e viteve '70-të, si rezultat i rritjes së përpjekjeve armiqësore për përmbysjen e rendit socialist në Shqipëri nëpërmjet agresionit paqësor ideologjik, u dukën shenja të nxitjes së shfaqjeve moderniste në letërsi, muzikë dhe artet figurative. Viheshin re përpjekje për përhapjen e një fryme liberale,që synonte jo vetëm artin, por edhe ekonominë, shkollën, rininë, mënyrën e jetesës. Në janar 1973, në fjalën e mbajtur në një mbledhje të Presidiumit të Kuvendit Popullor Enver Hoxha tërhoqi vëmendjen për këto dukuri dhe nënvizoi rrezikun e nënvleftësimit të tyre. Më 15 mars, në mbledhjen e komunistëve të aparatit të KQ të PPSH Ai mbajti fjalimin "Si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi im-

4

6

5

1-3. Me shkrimtarët Shevqet Musaraj, Dritëro Agolli e Ismail Kadare. 4-5. Mes artistëve profesionistë e amatorë, pjesëmarrës në Koncertet e Majit 1973. 6. Me një grup gazetarësh e fotoreporterësh.

perialisto-revizionist", ku tregoi burimet e shkaqet e këtyre shfaqjeve dhe theksoi rrezikshmërinë e humbjes së vigjilencës ndaj armikut të klasës në kushtet e vendosjes së pushtetit popullor. Plenumi i 4-t i KQ të PPSH (qershor 1973), goditi veprimtarinë armiqësore të elementëve antiparti në ideologji e në kulturë. Në raportin që mbajti Enver Hoxha tregoi qëllimet e kësaj veprimtarie, zbërtheu përmbajtjen ideologjike e politike të liberalizmit, nënvizoi rrezikshmërinë e tij për Partinë dhe shtetin socialist. Shkatërrimi i kësaj veprimtarie armiqësore i dha një impuls të fuqishëm veçanërisht zhvillimit të artit e të kulturës, forcoi përmbajtjen e tyre popullore e socialiste.

1

2

3

1-6. Mes pjesëmarrësve të Festivalit Kombëtar Folklorik të Gjirokastrës. Tetor 1973.

"Personalisht ndiej një kënaqësi kur dëgjoj muzikë, qoftë atë të kompozitorëve të mëdhenj klasikë e përparimtarë të botës, qoftë krijimet muzikore të kompozitorëve tanë. Por, të them të drejtën, këngët dhe vallet e bukura të popullit më pëlqejnë më shumë, më emocionojnë me bukurinë, me forcën dhe, njëkohësisht, me thjeshtësinë e tyre. Nuk flas kështu vetëm për faktin se jam shqiptar. Jo, por sepse këngët e vallet tona popullore janë me të vërtetë të bukura, shumë të bukura. Partia ka bërë një vepër të madhe që ngriti në një piedestal të lartë dhe përjetësoi gjithë këtë pasuri të rrallë që kemi trashëguar nga e kaluara... Populli ynë ka qenë kurdoherë optimist. Edhe kur ka qarë, edhe në gëzime, ai nuk e ka humbur kurrë besimin në të ardhmen, dhe ky optimizëm, kjo madhështi e tij, është përjetësuar në trashëgiminë e pasur të letërsisë gojore, në këngët, në vaUet, në kostumet dhe në traditat e tjera të mrekullueshme të tij. Kjo është diçka madhështore që e realizon në art në mënyrë të përkryer vetëm gjenia e popullit".

Enver Hoxha

4

5

6

1

2

3

4

5

6

7

8

Vizitat e Enver Hoxhës në rrethe e qytete të ndryshme të vendit ishin gëzime të mëdha për popullin. Pjesëmarrja e Tij në festat e ngjarjet e shënuara ishte pjesë e komunikimit të sinqertë, të ngrohtë e të hapët që ruajti Ai me masat deri në ditët e fundit të jetës. Kudo që shkonte, pavarësisht nga qëllimi i përcaktuar i vizitës ose i qëndrimit të Tij, për një mbledhje pune, për të marrë pjesë në një eveniment të jetës së vendit ose për pushime, kurdoherë Ai do ta kapërcente këtë kufi, për të shkuar sa më shumë atje, mes njerëzve, në familjet e tyre, në një vepër që ndërtohej, në një kolektiv punonjës. Këto foto të qershorit 1973 fiksojnë disa momente nga vizita e shokut Enver Hoxha në Shkodër, në këtë qytet të njerëzve punëtorë e të talentuar, patriotë, plot tradita në art e në kulturë.

1. Në Varrezat e Dëshmorëve në Shkodër. Qershor 1973. **2.** Gjatë vizitës në Hidrocentralin e Vaut të Dejës. **3.** Në uzinën mekanike "Drini" në Shkodër. **4.** Vizitë në Muzeun Historik të Shkodrës. **5.** Në Kongresin e 7-të të Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Qershor 1973. **6.** Midis delegateve të Kongresit. **7-8.** Në seancat e Kongresit.

1

2

3

4

1. Me shokët Adil Çarçani dhe Shevqet Peçi në malin e Dajtit. Gusht 1973. **2-3.** Gjatë ditëve të pushimeve në malin e Dajtit. **4.** Gjatë një shëtitjeje.

1. Urim për ditëlindjen. 16 tetor 1973.



1

2

3

1. Dhjetor 1973. **2.** Në bibliotekë, në shtëpi. 3. Me vajzën, Pranverën.

1. Tiranë 1974. **2-4.** Bisedë e përzemërt me ushtarët. 1974. **5.** Duke përshëndetur kuadrot ushtarakë. 1975.

1

Në vitin 1974 Partisë iu desh të përballonte një veprimtari tjetër armiqësore tepër të rrezikshme, që synonte dobësimin e Forcave të Armatosura e të mbrojtjes së Vendit dhe të organizonte puçin ushtarak për përmbysjen e pushtetit popullor. Drejtuesit e grupit armiqësor, duke përfituar nga funksionet e tyre në Parti, në organet shtetërore e veçanërisht në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, prej vitesh punonin fshehurazi për shtrembërimin e vijës ushtarake të Partisë, për sabotimin e saj. "Tezat teoriko-ushtarake" të përpunuara prej tyre i kundërviheshin hapur kësaj vije. Ato kishin

2

3

4

5

në themel disfatizmin, shmangien e rezistencës frontale ndaj agresorit, lejimin e pushtimit të vendit. Zbulimi i këtyre tezave të përgatitura në fshehtësi ishte sinjali i parë për këtë veprimtari të organizuar. Nën drejtimin e Enver Hoxhës udhëheqja e Partisë analizoi thellë përmbajtjen dhe synimet e tezave armiqësore. Analiza e konkluzionet e Enver Hoxhës dhanë një orientim të saktë për diskutimet e analizat që u bënë në Parti. Gradualisht u zbuluan e u faktuan qëllimet e këtij grupi të rrezikshëm si dhe pjesëtarët e tij.

1

2

3

4

Mendimi dhe veprimtaria e Enver Hoxhës janë në themelet e politikës së jashtme të vendit, e cila i siguroi Shqipërisë të drejtën për të ndjekur vijën e vet të pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare, për të thënë fjalën e vet e çliruar nga çdo kompleks inferioriteti ndaj fuqive të mëdha. Enver Hoxha ishte, gjithashtu, një pjesëmarrës aktiv në zbatimin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar me veprimtarinë e Tij si politikan, burrë shteti edhe në kontaktet e shumta me personalitete politike e shoqërore, me diplomatë e njerëz të kulturës të vendeve të ndryshme, me korrespondencën dhe me publicistikën e Tij. E gjithë kjo veprimtari e gjerë është karakterizuar nga parimësia e sinqeriteti. Enver Hoxha mbrojti çdo

5

6

7

8

veprim që u shërbente popujve, lirisë e revolucionit, duke shprehur njëkohësisht rezervat e qëndrimet e veta kritike për ato veprime që Ai i konsideronte të gabuara apo të dëmshme. Tërë politika e jashtme e RPSSH, e përpunuar nga Enver Hoxha dhe e zbatuar nën udhëheqjen e Tij, ka qenë kurdoherë një politikë e marrëdhënieve të drejta e të barabarta mbi bazën e bashkekzistencës paqësore e të respektit reciprok; politikë e kundërshtimit të armiqve të popujve, e përkrahjes së luftës për çlirim. Është kjo politikë e drejtë, e çiltër e parimore që e ka radhitur Shqipërinë socialiste midis forcave më përparimtare të kohës.

1. Bisedë me Kryetarin e Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, Çu En Lain, gjatë vizitës së tij në Shqipëri. Mars 1965. **2.** Me Kryeministrin e RD të Vietnamit Fam Van Dong. Tetor 1973. **3.** Me kryetarin e delegacionit qeveritar algjerian Budant Omar. Nëntor 1969. **4.** Duke biseduar me anëtarin e udhëheqjes së "Al Fatahut", Abu Xhihad. Gusht 1970. **5.** Takim i përzemërt me Nguen Hu Tho,Kryetar i Frontit të Çlirimit të Vietnamit të Jugut. Nëntor 1974. **6.** Enver Hoxha pret anëtarin e qeverisë së Kongos, Aloiz Mudileno Masengo. Tetor 1970. **7.** Me një delegacion arab të miqësisë. Maj 1958. **8.** Me kryetarin e delegacionit të Frontit Patriotik të Laosit, Nuhak Fumsavan. Qershor 1973.

1



2

1-2. Në stadiumin "Qemal Stafa", ku u zhvillua manifestimi fizkulturor për nder të 30-vjetorit të Çlirimit. Tetor 1974.



1

2

3

4

Këto pamje të Shqipërisë në vitet '70 janë disa detaje në tablonë e transformimit rrënjësor të arritur gjatë 30 vjetëve të pushtetit popullor. Gjatë tri dekadave vendi ynë njohu një zhvillim të paparë e të gjithanshëm në industri e në bujqësi, në arsim e në kulturë e veçanërisht, te njerëzit e vet. Partia dhe Enver Hoxha qenë projektuesit e mëdhenj të këtij zhvillimi që fuqizoi atdheun. Vitet e socializmit janë vite pune e përpjekjesh, fitoresh e sakrificash në emër të lumturisë së popullit. Me besim te vija e Partisë, te perspektivat që hapte ajo, e priti populli shqiptar festën e 30-vjetorit të Çlirimit. Në themel të ecjes së tij përpara janë idealet e Partisë, kjo forcë e pashtershme që i rinon njerëzit, që i frymëzon për fitore gjithnjë e më të mëdha. Kjo ka qenë e do të jetë përherë burimi i përparimit të Shqipërisë, i sigurisë së saj, i besimit në të ardhmen më të bukur.

5

6

7

1-4. Aspekte nga Shqipëria e viteve '70. **5-7.** Në ekspozitën "Shqipëria sot". Dhjetor 1974.

"Kur kaloj për në Pogradec ndalem e shikoj Pojskën dhe monumentin e dhjetë heronjve të saj. Me dhimbje, por me admirim jetoj luftën heroike të partizanëve trima, të cilët në këtë vend, më 16 korrik 1943, treguan edhe një herë, me forcë të madhe, dashurinë për popullin dhe Partinë, treguan edhe një herë se për lirinë e atdheut ata ishin gati të bënin edhe sakrificën më sublime. Monumenti në formë harku e me obelisk në mes shpreh unitetin e çelik-të të partizanëve trima, rreth komandantit të tyre trim. Ai është dhe do të jetë burim frymëzimi, respekti dhe mirë-njohjeje për brezat e sotëm dhe të ardhshëm".

Enver Hoxha

1

2

Së bashku me nënat, baballarët, motrat dhe vëllezërit e të rënë-ve, populli dhe Partia, në çdo 5 Maj,përkujtojnë me respekt të thellë të rënët, ata që i dhanë atdheut rininë e tyre, ata që vunë gjakun në themelet e Shqipërisë së re. Enver Hoxha, që ruajti gja-të gjithë jetës së Tij dasnurinë dhe respektin më të madh për të rënët, në çdo 5 Maj ishte pranë tyre së bashku me nënat dhe baballarët, motrat dhe vëllezërit. Ai ishte pranë të rënëve në këto ditë solemne së bashku me premtimin e mbarë një populli: "Flini të qetë shokë, se Shqipërinë do ta ndërtojmë ashtu siç e ënd-rruat ju!".

3

4

5

6

1-2. Pojskë, gusht 1975. **3,4,6.** Homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. 5 Maj 1976. **5.** Me nënën e Heroit të Popullit Vasil Laçi.

1

2

3

1. Një tufë lule të freskëta. Prill 1976.
2-3. Me kooperativistë të rrethit të Vlorës. Prill 1976.

Viti 1976 ishte viti i Kongresit të 7-të të Partisë, viti i parë i pesëvjeçarit të gjashtë. Detyra të mëdha dhe perspektiva të ndritura hapte Partia për përparimin e gjithanshëm të vendit. Rritja e rolit të masave në ndërtimin socialist, uniteti i çeliktë i popullit rreth Partisë, plotësimi i detyrave të mëdha të kohës, këto janë ndër temat që rrihen në takimet e Enver Hoxhës me popullin, me masat punonjëse në këtë periudhë.

1

Në vitet '70 Enver Hoxha, në disa fjalime të rëndësishme trajton një sërë problemesh të teorisë e të praktikës së revolucionit socialist. Idetë e konkluzionet e Enver Hoxhës qenë një thellim e përpunim i mëtejshëm i vijës marksiste-leniniste të Partisë në përputhje me detyrat aktuale të ndërtimit socialist. Ato përbënin një pasurim të mendimit teorik të PPSH, një përgjithësim të përvojës së saj në revolucion, në ndërtimin e socializmit, si dhe në luftën për mbrojtjen e tij nga veprimtaria armiqësore, e jashtme dhe e brendshme. Pjesëmarrja akoma më e gjerë dhe e ndërgjegjshme e masave punonjëse në jetën politike, ideologjike e ekonomike, rritja e peshës së kontrollit punëtor e fshatar nën udhëheqjen e Partisë, thellimi i luftës kundër burokratizmit e teknokratizmit, përmirësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve midis kuadrove e masave punonjëse, forcimi i rolit udhëheqës të Partisë në çdo hallkë të jetës së vendit, ishin disa nga çështjet kryesore që theksoi Enver Hoxha në këtë periudhë. Konkluzionet e Tij, si dhe veprimtaria praktike e Partisë luajtën një rol të madh për ruajtjen e rendit socialist, për ecjen përpara të vendit në të gjitha fushat. Ato qenë në bazë të masave që mori Partia në këto vite për revolucionarizimin e demokratizimin e mëtejshëm të shtetit socialist, për çrrënjosjen e burokratizmit, për zhvillimin e forcimin e ekonomisë, të kulturës, për fuqizimin e mbrojtjes së vendit. Në nëntor 1976 zhvilloi punimet Kongresi i 7-të i PPSH. Raporti që mbajti Enver Hoxha në emër të Komitetit Qendror, dokument shumë i rëndësishëm në jetën e Partisë e të vendit, një kontribut i PPSH për zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit, përgjithësoi përvojën e Partisë e të masave punonjëse në këtë periudhë. Kongresi i 7-të i Partisë së Punës të Shqipërisë aprovoi veprimtarinë ideologjike e politike të Komitetit Qendror kundër rrymaVe e teorive oportuniste. Ai vuri detyrën e thellimit të mëtejshëm të kësaj lufte, në mbrojtje të teorisë shkencore të proletariatit. Duke ritheksuar rrezikshmërinë e madhe të varianteve sovjetik e titist, eurokomunist etj.të revizionizmit modern, shoku Enver Hoxha u ndal në mënyrë të veçantë në analizën e teorisë antimarksiste kineze "të tri botëve" dhe të koncepteve që e ushqenin atë. Raporti që mbajti shoku Enver Hoxha në këtë Kongres përmbante drejtimet themelore të zhvillimit ekonomik, kulturor e shoqëror të vendit gjatë pesëvjeçarit të gjashtë. Ai nënvizoi edhe një herë vendosmërinë e Partisë e të popullit shqiptar për të ecur pa u ndalur në rrugën e ndërtimit socialist duke zbatuar teorinë marksiste-leniniste e duke u mbështetur në forcat e veta, në pasuritë materiale e shpirtërore të atdheut, në energjitë, talentin dhe vrullin revolucionar të masave.

1. Moment pune në prag të Kongresit të 7-të të PPSH. Tetor 1976. **2.** Duke folur në Kongresin e 7-të. Nëntor 1976.

1

2

3

4

1. Me anëtarë veteranë të Partisë gjatë ditëve të Kongresit. **2-3.** Në pushimet mes seancave. **4.** Duke mbajtur fjalën e mbylljes në Kongresin e 7-të të PPSH.

1

2

3

1,3. Në mitingun e popullit të Tiranës me rastin e përfundimit të punimeve të Kongresit të 7-të të PPSH. **2.** Në shtëpinë ku u themelua Partia. Nëntor 1976. **4.** Në sesionin e Kuvendit Popullor, duke paraqitur për miratim Kushtetutën e re. 28 dhjetor 1976.

4

Më 28 dhjetor 1976 Kuvendi Popullor miratoi Kushtetutën e re të shtetit shqiptar. Në hartimin e këtij dokumenti historik Enver Hoxha, që drejtonte edhe komisionin për hartimin dhe redaktimin e projektit të kushtetutës, kishte dhënë një kontribut të shquar. E gjithë puna për hartimin, diskutimin dhe formulimin përfundimtar të saj u krye nën drejtimin e drejtpërdrejtë të shokut Enver Hoxha. Në Kushtetutën e re shteti shqiptar u quajt Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, duke pasqyruar saktë ndryshimet cilësore socialiste të realizuara në Shqipëri, në bazën dhe në superstrukturën e saj. Kushtetuta e re e shtetit shqiptar mishëronte realitetin e gjallë dhe prirjet e zhvillimit historik të Shqipërisë socialiste. Ky dokument themeltar i shtetit shqiptar përshkohet nga parimet marksiste-leniniste, mishëron përvojën revolucionare të vendit tonë, është vepër e mendimit dhe veprimtarisë revolucionare të Partisë e të udhëheqësit të saj, Enver Hoxhës.

1

2

1-3. Duke festuar Vitin e Ri me pionierët. Dhjetor 1977. **4.** Me gjyshin.

Të rrinte pranë fëmijëve, mes dashurisë së tyre, të bisedonte me këta shokë të vegjël, me qytetarët e ardhshëm të republikës, ishte një dëshirë e përhershme për të. Momente të tilla janë vazhdimisht të pranishme në jetën e Enver Hoxhës, të bukura, çlodhëse, të gëzuara. Në një shkollë, gjatë një shëtitjeje, në festimet e një Viti të Ri, në takime me nxënës të dalluar, në urimet e fëmijëve në ditëlindjet e Enverit, me fëmijët e Tij, me nipërit e mbesat, kudo dhe kurdoherë që të jenë bërë këto fotografi, ato pasqyrojnë çaste të paharruara për fëmijët dhe po aq të gëzuara, përtëritëse për prindin, edukatorin e dashur, për njeriun e shtrenjtë të zemrave të tyre.

3

4

1

2



3

4

1. Gjirokastër, mars 1978. Te monumenti i heroinave Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima. **2.** Vizitë në një familje. **3.** Mes nënave gjirokastrite. **4.** Një bisedë në sofatet e gurta. **5.** Një buqetë për trimat e Rilindjes. **6.** Takim. **7.** Çmallje.

Mars 1978. Pas nëntë vjetësh, përsëri në qytetin e Tij të lindjes, të dashur e të paharruar, në qytetin me të cilin e lidhin kujtimet e fëmijërisë e të rinisë, kujtimi i prindërve që s'janë më, i shokëve dhe i miqve të vjetër, i viteve të largëta kur filloi të burrërohej, të mësonte, të formohej si njeri i së ardhmes, si luftëtar i botës së re. Ditët që qëndroi Enver Hoxha në Gjirokastër ishin një festë e bukur për qytetin, për njerëzit e tij. Por ato ishin përsëri tepër pak për të shuar mallin e Tij. Akoma më të shkurtra ishin këto ditë për gjirokastritët për t'u çmallur me birin, shokun, mikun e tyre të shtrenjtë. Kjo ishte vizita e fundit e Enverit në Gjirokastrën e Tij.

5

6



7

1

1. Në Mashkullorë, vend historik i betejave për liri. Mars 1978. 2. Në mitingun e popullit të krahinës së Dropullit. Grapsh, mars 1978. 3-4. Mes kooperativistëve dhe kuadrove të Dropullit.

Për minoritetin grek në Shqipëri Enver Hoxha ishte gjithnjë udhëheqës i dashur, mik e mësues i shtrenjtë. Vetë Ai, i rritur midis një populli pa paragjykime nacionale, do të ruante dashuri e respekt për ta, do të vlerësonte ndershmërinë, trimërinë dhe dashurinë e tyre për punën. Këto ndjenja të pastra e të sinqerta, më pas, kur Ai u formua si revolucionar e komunist, si udhëheqës i popullit shqiptar, u bënë pjesë e ndërgjegjes dhe e veprimtarisë së Tij. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Partia Komuniste e Shqipërisë e udhëhequr nga Enver Hoxha farkëtoi unitetin e minoritetit grek me popullin shqiptar në luftën e përbashkët krah për krah për lirinë e atdheut. Socializmi e çelikosi këtë unitet, sepse politika e

2

3

4

drejtë dhe e urtë e Partisë u solli minoritarëve jetën e lumtur, përparimin e gjithanshëm, u siguroi barazinë dhe dinjitetin. Vija e Partisë u krijoi atyre kushtet për afirmimin e personalitetit të vet, për zhvillimin e kulturës, të gjuhës, të traditave përparimtare. Përparimi ekonomik i zonës së minoritetit grek në Shqipëri është sot nga më të lartët në vend. Një zhvillim të gjerë, të pakrahasueshëm me të kaluarën kanë marrë arsimi i minoritarëve në gjuhën amtare, zhvillimi i folklorit e i fushave të tjera të kulturës shpirtërore. Qytetarët e RPSSH me kombësi greke kanë të gjitha të drejtat, që gëzojnë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë sonë, ata luajnë rolin e tyre të respektuar si punonjës, si kuadro drejtues në organet e Partisë e të pushtetit, si shkencëtarë e artistë.

1

Këtu, në Lukovë, 12 vjet më parë shoku Enver kishte porositur që i gjithë Bregdeti të gjelbërohej, të bëhej një kopsht i bukur i agrumeve e i ullinjve. Dora e njeriut, puna e djersa e rinisë i shtuan kaltërsisë së Jonit kurorën e gjelbër të brezareve, të plantacioneve në Vlorë, Borsh, Lukovë e Ksamil. Epoka e socializmit, Partia dhe Enver Hoxha ia shtuan bukurinë natyrës shqiptare, e bënë më të begatë dhe pasuritë e saj i vunë në shërbim të njerëzve, të popullit. Natyra, bukuria dhe mirëqenia e popullit ishin për shokun Enver të pandara. Mendja e Tij, bashkë me punën e gjithë popullit, u mishërua në këtë transformim të mahnitshëm.

2

1-2. Lukovë, mars 1978.

1

Enver Hoxha ishte arkitekti dhe frymëzuesi kryesor i luftës që zhvilloi Partia e Punës e Shqipërisë kundër revizionizmit modern. Pas fillimit të polemikës së hapët me revizionistët sovjetikë, Ai dha një kontribut të shquar në mbrojtjen e teorisë marksiste-leniniste dhe në analizën e formave të ndryshme të oportunizmit në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në veprën teorike të Enver Hoxhës gjenden shpjegime të sakta të shkaqeve të lindjes, të rrezikshmërisë dhe të identitetit ideologjik të rrymave të ndryshme të revizionizmit modern, pavarësisht nga nuancat e taktikat e tyre. Enver Hoxha analizoi në mënyrë të plotë revizionizmin hrushovian, titizmin, eurokomunizmin, si dhe teori e praktika të tjera të djathta apo të "majta". Analizat dhe konkluzionet e Enver Hoxhës, vepra e Tij teorike, përbëjnë një pikë themelore referimi, busull orientimi për forcat marksiste-leniniste e revolucionare dhe për popujt që luftojnë për liri e demokraci. Enver Hoxha u bë një figurë e njohur ndërkombëtare jo vetëm se bëri më shumë se kushdo tjetër për vendin e Tij, por edhe sepse mishëroi në shkallën më të lartë shpirtin internacionalist të Partisë e të popullit shqiptar, luftoi me konsekuencë të rrallë për revolucionin dhe lirinë e popujve të tjerë. Në vitet '70 Partia e Punës e Shqipërisë e udhëhequr nga Enver Hoxha arriti në konkluzione të plota e të sakta edhe për vijën oportuniste të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës. Gjatë shumë vjetëve rnidis dy partive ishin zhvilluar debate e ballafaqime parimore për çështje të rëndësishme ideologjike e politike. PPSH i kishte shfaqur hapur rezervat e kundërshtimin e saj udhëheqjes së PKK dhe Mao Ce Dunit për qëndrime të lëkundura e oportuniste të mbajtura nga këta. Analizat e Enver Hoxhës luajtën një rol vendimtar në përcaktimin e qëndrimeve të matura e të drejta të Partisë sonë ndaj partisë kineze. Ndër dokumentet e rëndësishme për këtë problem, me vlerë të veçantë janë libri "Imperializmi dhe revolucioni" (1979) dhe "Shënime për Kinën", në dy vëllime, me pjesë nga Ditari Politik i Enver Hoxhës, në të cilat Ai ka bërë një analizë të plotë historike e dialektike të koncepteve ideologjike e të veprimtarisë politike të PK të Kinës. Nën udhëheqjen e Tij Partia ruajti të paprekur vijën e saj revolucionare dhe dha kontributin e vet në lëvizjen marksiste-leniniste në botë.



2

3

1. Nëntor 1978. **2.** Çast pune. 1978. **3.** Midis seancave në një plenum të KQ të PPSH. 1977.

1

2

1-2. Në ceremoninë e varrimit të eshtrave të patriotëve e luftëtarëve të shquar Naim e Abdyl Frashëri. Qershor 1978. **3.** Me luftëtaren patriote Bije Vokshi. **4.** Me patriotin Rexhep Duraku, babanë e Heroit të Popullit Emin Duraku. **5.** Mes një grupi bashkatdhetarësh nga Kosova.

Historinë e kombit, momentet kyç të saj, luftërat e popullit për ruajtjen e ekzistencës, për liri e përparim, Enver Hoxha i vlerësonte jo si relike të një historie të lashtë, por si pjesë e ndërgjegjes së sotme të kombit, burim mësimesh, krenarie e frymëzimi. Partia lartësoi figurat e mëdha të historisë së kombit, burrat e mëdhenj që e kishin udhëhequr e frymëzuar atë dhe në piedestalin më të lartë vuri masat popullore, që me luftën e tyre brez pas brezi, me shpirtin e paepur patriotik e revolucionar ruajtën kombin, gjuhën, traditat, dhanë jetën për trojet e atdheut. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878) ishte një nga këto momente të spikatura të historisë, ku u shfaqën këto tipare, ku u mishërua uniteti kombëtar, nga Veriu në Jug, në luftë për Shqipërinë e pavarur, të lirë, kundër pushtuesit dhe lakmive të shovinistëve e pazarllëqeve të fuqive të mëdha të kohës.

3

4

5

1

3

4

5



6

1-3. Me bashkatdhetarë që jetojnë në vende të ndryshme të botës. 1963. **4.** Me shkrimtarin rumun me origjinë shqiptare, Viktor Eftimiu. 1975. **5.** Me kryetarin e shoqërisë patriotike "Shqipëria e lirë" Paskal Aleksi. 1968. **6.** Me nipin e patriotit e të shkencëtarit të madh shqiptar Sami Frashëri.1978. **7.** Faksimile nga korrespondenca e shokut Enver Hoxha me bashkatdhetarë në vende të ndryshme. **8.** Takim me përfaqësues të kolonive shqiptare. 1969.

Tek Enver Hoxha të gjithë shqiptarët e ndershëm e patriotë, që jetonin larg atdheut të tyre, shikonin udhëheqësin e shquar të kombit që kishte udhëhequr popullin shqiptar në luftën për liri kombëtare, për përparim e begati. Kushtet e vështira ekonomike i kishin detyruar ata të braktisnin vendin. Tani, pas shumë vitesh, shikonin një tjetër Shqipëri, të pavarur e të fortë, njerëz të lirë e të lumtur, të sigurt në të sotmen e plot besim në të ardhmen. Enver Hoxha mbajti kontakte të vazhdueshme me shumë prej bashkatdhetarëve që jetonin në vende të ndryshme të botës dhe ndiqte me simpati punën e tyre të dobishme patriotike për njohjen e Shqipërisë së re në botë.



7

8

2

1

3

1-3. Në Lezhë, pas zhdukjes së pasojave të tërmetit. Tetor 1979. **4-5.** Në mitingun e popullit të Shkodrës në lagjen Bahçallëk, të ndërtuar rishtas. Tetor 1979. **6.** Takim me banorë të fshatrave të dëmtuara. **7.** Një kurorë te përmendorja kushtuar luftëtarëve patriotë Çerçiz Topulli e Mustafa Qulli.

Më 15 prill 1979 një tërmet shumë i fuqishëm goditi disa rrethe të Veriut. Dëmet ishin veçanërisht të ndieshme në qytetet e Lezhës e të Shkodrës dhe në disa fshatra të këtyre rretheve.Në momente të tilla të vështira populli i këtyre zonave pati pranë Partinë dhe Enver Hoxhën, ndjeu dorën e ngrohtë të shoqërisë sonë, të të gjithë popullit shqiptar.Me propozim të Komitetit Qendror e personalisht të Enver Hoxhës, shteti mori përsipër likuidimin e pasojave brenda pesë muajve, ndërtimin e të gjitha banesave, objekteve ekonomike e kulturore me shpenzimet e veta. E gjithë Shqipëria mori pjesë në këtë aksion të madh. Në tetor të vitit 1979 Enver Hoxha shkoi vetë mes popullit të Lezhës e të Shkodrës, për t'u ndodhur pranë tyre, ashtu siç ka qenë përherë i pranishëm në gëzimet e hidhërimet e çdo fshati e qyteti, të çdo shtëpie shqiptare.

4



5

6



7

1

2

1. Në familjen e veteranit Agush Gjergjevica. Korçë, gusht 1980. **2.** Pas një shfaqjeje të artistëve amatorë. **3.** Me motrën e militantit komunist të Grupit të Korçës, Sotir Gurra. **4.** Me Miha Lakon. **5.** Me Polikseni Theoharin.

Gjatë udhëtimeve, në vizitat në qytete e krahina të atdheut, Enver Hoxha kërkonte takime e biseda të lira, të thjeshta, ku njerëzit flitnin lirisht, me zemër të hapët si me një njeri të dashur e të afërt. Kudo që shkonte do të pyeste për të njohurit e Tij të shumtë, për shëndetin, familjet e hallet e tyre. Veçanërisht do të interesohej për ata që i kishte njohur në luftën e përbashkët për fitoren e lirisë e të socializmit, për patriotë e luftëtarë, për njerëzit që ishin shquar në përpjekjet për lumturinë e popullit. Shumë prej tyre i kishte njohur personalisht në ato vite, disa i kishte takuar më pas, me të tjerë ishte njohur përmes letrave të ngrohta që kishin shkëmbyer.

3

4

5

1

2

3

4

1. Verë e vitit 1981. **2.** Me shokun Manush Myftiu. 1980. **3.** Me shokun Hekuran Isai. 1983. **4.** Në peshkim. 1981.

Për shumë vjet me radhë, gjatë stinës së nxehtë të verës, shoku Enver vinte të pushonte në Drilon, pranë qytetit të Pogradecit. Këtu, në klimën e freskët, mes natyrës së bukur, buzë liqenit të Ohrit, çlodhej, merrte forca, pushonte. Por pushimi për të kishte kuptim vetëm i shkrirë me punën, me veprimtarinë krijuese. Këtu i vinin shokët e bashkëpunëtorët e afërt, me të cilët edhe çmallej, por edhe bisedonte për punët, për problemet që dilnin. Këtu, gjatë shëtitjeve, në studion e punës, në vendet ku i pëlqente të ulej, mendja punonte, idetë lindnin e përpunoheshin, mendimi nxitej. Këtu në Drilon, gjatë pushimeve, lindën konturet e para të shumë prej veprave madhore të Enver Hoxhës.

1

2

1. Meditim. **2.** Montazh i librave të shokut Enver Hoxha në gjuhën shqipe.

Enver Hoxha ishte një mendimtar i shquar marksist-leninist. Personaliteti i Tij shpërtheu me një krijimtari të pasur e të vrullshme mendore e praktike, udhëheqëse e organizuese,që u rrit e u fuqizua pandërprerë që nga 8 Nëntori i vitit 1941 e gjer në çastet e fundit të jetës së Tij. Vepra e Tij e shkruar është dëshmi e gjallë e figurës së Tij poliedrike, e kulturës së gjithanshme historike, filozofike e ekonomike, e përvojës së gjatë prej disa dekadash në krye të luftës e të përpjekjeve të Partisë e të popullit për liri e socializëm dhe si personalitet i shquar i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Nga thesari i Tij teorik, deri më sot, janë botuar në gjuhën shqipe 50 vëllime të serisë, që përfshijnë dokumente të periudhës 1941-1973. Gjatë viteve '70-80 Enver Hoxha krijoi e botoi një sërë veprash, të cilat dëshmojnë për pjekurinë e mendimit

marksist-leninist të Partisë sonë. Të tilla ishin: "Imperializmi dhe revolucioni", "Vetadministrimi jugosllav - teori dhe praktikë kapitaliste", "Eurokomunizmi është antikomunizëm". Janë botuar gjithashtu pjesë të Ditarit Politik të Enver Hoxhës në librat "Shënime për Kinën", "Shënime për Lindjen e Mesme", "Dy popuj miq", "Superfuqitë" etj. Enver Hoxha është, gjithashtu, autor i një serie të pasur kujtimesh e shënimesh historike, fryt i mbresave ei reflektimeve të Tij për periudha të rëndësishme të historisë sonë e asaj botërore. Mes tyre spikatin: "Kur lindi Partia", "Me Stalinin", "Hrushovianët", "Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë", "Titistët", "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re" etj. Shumë nga veprat e Enver Hoxhës janë botuar jashtë vendit nga shtëpi të ndryshme botuese, duke gjetur një jehonë të gjerë në opinionin botëror.

1

2

3

1. Çast pune. Shtator 1981. **2.** Në një mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH. 1981. **3.** Me shokët Ramiz Alia, Foto Çami e Sofokli Lazri. **4. 6-9.** Në ceremoninë e dorëzimit të urdhrave "40-vjetori i PPSH". Tetor 1981. **5.** Shoku Simon Stefani i dorëzon shokut Enver Hoxha Urdhrin "40-vjetori i PPSH".

4

6

7

5

8

9

1

Në fillim të viteve '80 praktika e ndërtimit socialist nxirrte në rend të ditës një sërë problemesh që kërkonin përpunim shkencor e realizim konkret. Çështje të tilla, si përsosja e drejtimit nga organet e Partisë, të shtetit e të ekonomisë, ngritja e organizimit të punës në një shkallë më të lartë, zhvillimi në gjerësi e në thellësi i revolucionit tekniko-shkencor zënë një vend të dukshëm në veprimtarinë e Enver Hoxhës në këto vite. Në krye të udhëheqjes së Partisë, në analizat e përgjithësimet e përbashkëta të saj, me vërejtjet e sugjerimet konkrete, me shënimet e zgjeruara analitike, Ai luan një rol kryesor në hartimin e planit të shtatë pesëvjeçar (1981- 1985), i cili mbështetej tërësisht në forcat e në burimet e vendit dhe, nga përmasat e detyrat që do të zgjidhte, ishte më madhështori. Enver Hoxha trajton me një horizont të gjerë të perspektivës çështje kapitale të planifikimit- shkencor të ekonomisë, të organizimit të punës, të ritmeve të zhvillimit, të futjes së teknologjive e teknikës së re etj., në lidhje të ngushtë dialektike me aspektet e rrjedhimet politike e sociale që i shoqërojnë ato. Më 1-7 nëntor 1981 u mbajt Kongresi i 8-të i PPSH. Enver Hoxha mbajti raportin për veprimtarinë e Komitetit Qendror dhe parashtroi drejtimet themelore të zhvillimit politik, ekonomik e shoqëror të Shqipërisë për pesëvjeçarin e shtatë. Ky ishte Kongresi i fundit ku mori pjesë themeluesi dhe udhëheqësi i Partisë. Roli dhe kontributi i Enver Hoxhës në përpunimin dhe zbatimin e politikës ekonomike të Partisë ishte kryesor edhe gjatë gjithë kohës pas Kongresit të 8-të të Partisë, deri në ditët e fundit të jetës së Tij. Përveç veprimtarisë së Tij në krye të Partisë e të popullit për plotësimin e detyrave aktuale të ndërtimit socialist, Ai orientoi dhe drejtoi personalisht punën e organeve të Partisë e të shtetit, të masave punonjëse për hartimin e projektplanit të tetë pesëvjeçar dhe formuloi skicidenë e këtij plani.

2

1. Shoku Enver Hoxha mban raportin në Kongresin e 8-të të P P S H . 1 nëntor 1981.
2. Në presidiumin e Kongresit, gjatë seancave.

1

2

3



4



5

6

7

1. Duke ndjekur diskutimet në Kongres. **2.** Çast nga votimet për organet udhëheqëse të Partisë. **3.** Me Heroin e Popullit, Hekuran Pobrati. **4.** Duke mbajtur fjalën e mbylljes në Kongres. 5. "Internacionalja". **6.** Mes pionierëve që përshëndetën Kongresin e 8-të. **7.** Pas përfundimit të Kongresit të 8-të të PPSH.

1



2

1-2. Në mitingun e popullit të Tiranës me rastin e përfundimit të Kongresit të 8-të të PPSH. 8 Nëntor 1981.

Garancinë e realizimit të vijës së Partisë, sigurinë e të ardhmes së ndritur të Shqipërisë socialiste Enver Hoxha e shihte te mbështetja e popullit, e masave punonjëse. Kuptimi i strategjisë së Partisë, i orientimeve, i gjithë luftës së saj revolucionare nga masat ishte kyçi i fitoreve të arritura dhe kushti i ecjes përpara pa u ndalur në rrugën e socializmit e të komunizmit. Enver Hoxha e mësoi dhe e edukoi Partinë, që në ditët e para të jetës së saj, të futet thellë në masa, të jetojë me pulsin e tyre, me mendimet, dëshirat e aspiratat e popullit, t'i bindë ato për drejtësinë e vijës së vet, t'i frymëzojë e t'i udhëheqë.

"Në personin e Tij Ai mishëronte virtytet më të vyera të popullit tonë të lashtë, atë karakter luftarak e fisnik, ato tradita të ndritura e heroike, atë shpirt kryengritës e bujar, që janë farkëtuar e kalitur nëpërmjet sa e sa luftërash e vuajtjesh, përpjekjesh shekullore për liri e pavarësi, për dritë e dije, për tokë e për bukë".

Ramiz Alia

1

1. Maj 1980. **2.** Një shportë me karafila të kuq nga vëllezërit kosovarë në vitin e 75-vjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha. 1 Maj 1983.

Në pranverën e vitit 1981 populli shqiptar ndoqi me vëmendje e shqetësim të veçantë ngjarjet në krahinën e Kosovës dhe në vise të tjera shqiptare në Jugosllavi. Shtypja barbare e demonstratave me kërkesat e ligjshme të popullsisë shqiptare nga ushtria dhe tanket e serbomëdhenjve, ngjalli te populli ynë një indinjatë dhe dhimbje të thellë për vëllezërit që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Me mosaprovim i priti këto raprezalje edhe opinioni publik ndërkombëtar. Enver Hoxha dhe udhëheqja e PPSH ngjarjet e pranverës së vitit 1981, si dhe zhvillimet e mëvonshme të situatës në Jugosllavi, i trajtuan me vëmendje, kujdes dhe maturi. Në përcaktimin e qendrimeve të shtetit shqiptar ndaj këtij problemi Enver Hoxha kishte luajtur rol kryesor, si tani edhe në të shkuarën. Fati i asaj pjese të kombit të mbetur padrejtësisht jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë e që shtypej nga udhëheqësit e Federatës Jugosllave, do

2



3

të mbetej për Enver Hoxhën një brengë dhe shqetësim, që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Enver Hoxha kishte ndjekur vazhdimisht me vëmendje politikën shoviniste të Beogradit ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Pas ngjarjeve të vitit 1981 e situatave që u zhvilluan më vonë, PPSH dhe Enver Hoxha, duke hedhur poshtë trillimet absurde të udhëheqësve jugosllavë për gjoja ndërhyrjen e RPSSH në këto ngjarje, mbrojtën të drejtat legjitime të shqiptarëve në Jugosllavi dhe treguan shkaqet e vërteta që çuan në revoltën e tyre kundër gjendjes ekzistuese. Artikujt redaksionalë të "Zërit të popullit" të shkruar nga shoku Enver apo sipas tezave të Tij dhe veçanërisht pjesa për problemet ndërkombëtare e raportit të Enver Hoxhës në Kongresin e 8-të të PPSH u shquan për analizën e saktë dhe për rrugët konstruktive që paraqiteshin për zgjidhjen e problemit.

1. Nëntor 1981. **2-3.** Në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH. Dhjetor 1981. **4.** Gjatë një mbledhjeje të Byrosë Politike të KQ të PPSH. Dhjetor 1981.

1

Në vitet e fundit të jetës së Tij shoku Enver Hoxha ishte në krye të luftës që bëri Partia për zbulimin dhe shpartallimin e grupit armiqësor të M. Shehut. Veprimtaria e kësaj bande , e shtrirë në një periudhë të gjatë kohe dhe e lidhur me fije të shumëfishta me fuqitë e zbulimet e huaja, përbënte rrezikun më të madh që kishin kaluar ndonjëherë Partia dhe rendi socialist në Shqipëri. Principialiteti dhe vigjilenca revolucionare e Enver Hoxhës ndaj veprimeve armiqësore të M. Shehut patën një rol vendimtar për fillimin

2

3

4

e një analize të thelluar të veprimtarisë së këtij armiku të kamufluar. Bashkë me pjesëtarët e tjerë të Byrosë Politike dhe në krye të tyre, me intuitën politike të një udhëheqësi marksist-leninist, Enver Hoxha kritikoi rreptë këto veprime armiqësore dhe këmbënguli në zbulimin e qëllimeve të tij. Analizat dhe konkluzionet e Enver Hoxhës i hapën rrugën zbulimit e shpartallimit të një grupi të rrezikshëm armiqësor e agjenturor, i cili kishte punuar në fshehtësi për vite me radhë për shkatërrimin e rendit socialist në Shqipëri.



1



2

3

1-2. Ditën e përurimit të Muzeut Historik Kombëtar. Tetor 1981. **3.** Bisedë me piktorë e skulptorë në Galerinë e Arteve Figurative në Tiranë. Dhjetor 1981. **4-5.** Gjatë seancave të Kongresit të 9-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Qershor 1982. **6-7.** Në Kongresin e 8-të të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Tetor 1982.

Enver Hoxha ishte një njeri me kulturë të gjerë, i pasionuar pas vlerave të vërteta të artit botëror e shqiptar, njohës i historisë së tij. Ai vlerësonte lart rolin e artit përparimtar në zhvillimin shoqëror,njihte e çmonte artin e krijuar nga populli shqiptar në shekuj, vlerësonte veprën e artistëve që historia e kombit i kishte skalitur në kujtesën e vet. Epoka e socializmit i ngriti letërsinë dhe artet në lartësi të reja. Enver Hoxha i frymëzoi artistët që veprën e tyre t'ia kushtonin qëllimit të madh të Partisë, të revolucionit, që arti t'i shërbente përparimit material e shpirtëror, të zbukuronte e të pasuronte jetën e njerëzve. Arti i madh, i mësonte Enver Hoxha artistët, ka në qendër krijuesin më të madh, popullin, njerëzit, të cilët vënë në lëvizje historinë, revolucionin. Nuk mund të kuptohet socializmi pa art, pa kulturë, se këto i frymëzojnë njerëzit, i emancipojnë, u hapin horizonte të reja drejt përparimit.

4

5



6

7

1

2

3

4

5

1. Verë e vitit 1982. **2.** Dëborë në Tiranë. **3-5.** Në familje.

1

2

1. Bisedë me një shok nga Zelanda e Re. **2.** Me Sekretarin e Parë të KQ të PK të Brazilit, Zhoao Amazonas dhe anëtarin e udhëheqjes së PKB, D. Arruda. **3.** Mes një grupi të rinjsh revolucionarë të huaj në Tiranë. **4.** Pamje nga një miting në Portugali.

Enver Hoxha është një figurë e shquar e komunizmit ndërkombëtar. Në mendimin teorik dhe veprimtarinë praktike revolucionare të Tij, lufta për interesat kombëtare të vendit tonë është shkrirë me luftën dhe përpjekjet për fitoren e revolucionit në shkallë ndërkombëtare. Internacionalizmi militant përshkon të gjithë veprën teorike e praktike të Enver Hoxhës që në vitet e Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht pas saj, me daljen në skenë të revizionizmit modern. Me veprën e Tij teorike Ai dha një kontribut të shquar për mbrojtjen e teorisë marksiste-leniniste dhe për demaskimin e argumentuar të thelbit ideologjik e politik të teorive e rrymave të ndryshme oportuniste. Shoku Enver Hoxha iu gjend kurdoherë pranë marksistë-leninistëve. Me një ndjenjë të thellë internacionaliste, Ai, në takime e biseda të shumta shoqërore me ta, në një numër të madh veprash e shkrimesh, ka trajtuar gjerësisht pro-

3

4

blemet e organizimit, të edukimit e të kalitjes së partive të reja marksiste-leniniste, që u krijuan në procesin e diferencimit që ndodhi në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore, pas tradhtisë së revizionistëve modernë. Ai i ka këshilluar vëllazërisht e i ka inkurajuar në aksionin revolucionar, i ka ndihmuar konkretisht partitë dhe forcat marksiste-leniniste për t'u ndërtuar mbi baza të shëndosha marksiste-leniniste, për të vepruar në përshtatje me kushtet konkrete të veprimtarisë e të luftës në vendet e tyre. Kontributi i Enver Hoxhës në çështjen e luftës revolucionare e çlirimtare të proletariatit e të popujve, përkrahja e Tij e paepur internacionaliste për këtë luftë kanë gjetur njohjen dhe vlerësimin e lartë nga ana e forcave marksiste-leniniste, revolucionare e përparimtare të popujve liridashë liridashës kudo në botë.

1

2

3

4

5

1. Me Sekretarin e Parë të KQ të PK të Ekuadorit (m-l),Rafael Eçeverria. **2.** Me Kryetarin e PK të Gjermanisë (m-l), Ernst Aust. **3.** Me Sekretarin e Përgjithshëm të PK (m-l) të Perusë, Saturnino Paredes Macedo. **4.** Me Sekretarin e Parë të KQ të PK (m-l) të Danimarkës, Klaus Riis Klausen. **5.** Botime të veprave të shokut Enver Hoxha në vende të ndryshme të botës.

„Qysh në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe për dyzet vjet me radhë unë e kam ndier nga afër dorën dhe kujdesin atëror të shokut Enver. Por 25 vjetët e fundit, që nga 1960-ta e këtej, në punën e përbashkët në Sekretariatin e Komitetit Qendror të Partisë, ndihma e pakursyer dhe këshilla e urtë e Tij kanë qenë për mua të përditshme. Në tërë këto vite shoku Enver ka qenë për mua udhëheqës dhe shok, mik i ngushtë e vëlla më i madh, por mbi të gjitha mësues i dashur e i durueshëm. Në shkollën e Tij mësova si të punoj e të luftoj më mirë për popullin e Partinë. Në çdo rast, në kontaktet e bisedat e vazhdueshme, në shkëmbimin e lirë të mendimeve, ndihma e Tij për mua ka qenë vendimtare dhe e gjithanshme. Këshillat e Tij të pakursyera dhe inkurajimi i Tij kanë ndikuar drejtpërsëdrejti që të njoh më mirë e më thellë punët e kohës dhe ato të perspektivës. Shokut Enver i detyroj formimin tim si kuadër revolucionar, i detyroj çdo gjë të mirë që Partia vlerëson tek unë".

Ramiz Alia

1

1

2

1-2. Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të RPSSH bën homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë. 28 Nëntor 1982.

Tek Enver Hoxha populli shqiptar shikonte udhëheqësin e madh, arkitektin e fitoreve historike, njeriun që i kishte hapur rrugën e lirisë e të përparimit, që me mendimin dhe guximin e vet i ndriçonte të ardhmen. E gjithë jeta e shokut Enver ka qenë një luftë e vazhdueshme,në krye të Partisë, për lumturinë e popullit. Çdo hap që ka hedhur historia e atdheut në më shumë se katër dekada është lidhur me emrin dhe veprën e Tij. Për popullin, për të gjithë brezat e Shqipërisë Ai mbeti i skalitur në zemër e në mendje, në komunikimin e natyrshëm të njerëzve me emrin e thjeshtë, me të cilin e quajtën që në vitet e luftës: Komandanti.



1

2

1-3. Në ceremoninë me rastin e 40-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Popullore. 10 korrik 1983. **4.** Me veteranë të Luftës Nacionalçlirimtare e kuadro të Ushtrisë Popullore. **5.** Në tribunën e stadiumit "Qemal Stafa", ku u zhvillua manifestimi fizkulturor - sportiv me rastin e 40-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Popullore. Korrik 1983.

Shoku Enver, si përherë edhe në këto vite.ndiqte me vëmendje të veçantë zhvillimet aktuale në botë, situatat e turbullta e të rrezikshme të krijuara nga politika hegjemoniste e imperializmit. Acarimet politike e ushtarake në botë, bashkë me rreziqet që i ishin kanosur gjithmonë Shqipërisë socialiste nga forcat e errëta të reaksionit ndërkombëtar e komplotet që thurnin ata aktualisht, e bënin gjithnjë e më jetike çështjen e mbrojtjes së atdheut. Në krye të Partisë, të shtetit e si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të vendit, Enver Hoxha, veçanërisht në këto momente, i kushtoi kujdes të veçantë çelikosjes së mbrojtjes së vendit. Nën udhëheqjen e Tij, Partia e bëri Shqipërinë socialiste një kështjellë të pathyeshme, të mbrojtur nga tërë populli i armatosur, i mbështetur në forcat e veta, i pajisur me Artin Ushtarak të Luftës Popullore.

3

5

4

1

I dashur shoku Enver,

Jeta dhe veprimtaria Juaj revolucionare janë për ne një shembull i shkëlqyer, nga i cili mësojmë e udhëhiqemi që t'ua kushtojmë të gjitha forcat tona idealeve të larta komuniste, çështjes së madhe të Partisë, të revolucionit e të socializmit, mbrojtjes së interesave të popullit e të atdheut tonë të dashur socialist. Ne, shokët e nxënësit Tuaj, që kemi fatin e madh të punojmë nën drejtimin Tuaj, mësojmë e frymëzohemi nga lufta dhe puna Juaj si të forcojmë pareshtur Partinë tonë të shtrenjtë, si të forcojmë unitetin e mendimit e të veprimit të saj, lidhjet e saj të pandashme me popullin, rolin e saj udhëheqës, si të ruajmë kurdoherë të pastër ideologjinë tonë fitimtare, marksizëm-leninizmin. Ne mësojmë shumë nga metoda e stili Juaj në punë, nga principialiteti i lartë në zgjidhjen e çdo çështjeje, nga vigjilenca revolucionare ndaj armikut e ndaj çdo gjëje të huaj, nga urtësia e gjykimeve dhe vendosmëria në qëndrime, nga shpirti i iniciativës e guximi komunist. Ne mësojmë e përvetësojmë nga Ju virtytet e mëdha të popullit e të klasës sonë punëtore, atdhedashurinë e flaktë, frymën luftarake dhe shpirtin e sakrificës, dashurinë e thellë për shokët e për njerëzit e punës, thjeshtësinë proletare dhe fisnikërinë e popullit tonë. Me shembullin Tuaj, Ju na mësoni se puna e palodhur për ndërtimin e socializmit, devotshmëria ndaj marksizëm-leninizmit, dashuria dhe besnikëria pa kufi për popullin e Partinë janë ato tipare themelore që duhet të karakterizojnë komunistin aktiv e militant. Ju sigurojmë, shoku Enver, se do të ecim kurdoherë të papërkulur në rrugën marksiste-leniniste që na tregoni Ju dhe do të zbatojmë me besnikëri e konsekuencë mësimet Tuaja të çmuara. Nën udhëheqjen Tuaj të sigurt, Partinë dhe popullin tonë i presin gjithnjë fitore të mëdha. Me rastin e 75- vjetorit të lindjes Ju urojmë edhe një herë i dashur shoku Enver, jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, punë e luftë të frytshme për të mirën e Partisë, për lumturinë e popullit tonë, për përparimin dhe forcimin e mëtejshëm të socializmit në Shqipëri, për lavdinë e marksizëm-leninizmit.

Nga Përshëndetja e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

1. Shoku Ramiz Alia i dorëzon shokut Enver Hoxha Përshëndetjen e KQ të PPSH me rastin e 75-vjetorit të lindjes. 16 tetor 1983. **2.** Portret i vitit 1983.



1

75-vjetori i lindjes së shokut Enver Hoxha ishte një ditë e shënuar, një festë e bukur për gjithë popullin shqiptar. Në ditë të tilla shprehej me një forcë të veçantë dashuria dhe respekti për të, që ishin rrënjosur në shpirtin e çdo shqiptari. Për komunistët, për qytetarët e Shqipërisë socialiste, për punëtorët, fshatarët, për inteligjencien, për rininë shqiptare emri dhe figura e Enver Hoxhës ishin të shenjta, ashtu sikurse ishin gjithçka për Enverin populli dhe atdheu.

2

4

3

1-4. Me punëtorët që i uruan 75-vjetorin e lindjes.

1

2

3

4

5

6

7

1-3. Mes shokëve në ditën e 75-vjetorit të lindjes. **4.**16 tetor 1983. **5-7.** Shokut Enver Hoxha i dorëzohen mesazhet e urimit nga organizatat e masave.

1

2

3

4

Deri në ditët e fundit të jetës së vet shoku Enver Hoxha luftoi e punoi në krye të Partisë e të popullit. Ashtu sikurse në gjithë jetën e Tij si militant e udhëheqës, edhe në vitet e fundit, Enver Hoxha gjithçka ia kushtoi çështjes së madhe, idealit të komunizmit. Mosha, sëmundja, ngarkesa e jashtëzakonshme e veprimtarisë së Tij bënin të vetën. Ai bënte gjithçka dhe arrinte të mposhtte çdo pengesë për të punuar gjithnjë me vitalitet të rrallë e me pasion të flaktë për të mirën e atdheut. Me gjithë shqetësimet e problemet shëndetësore të kësaj periudhe, Enver Hoxha ishte përherë në krye të Partisë, në veprimtarinë e gjithë jetës së vendit, mori pjesë në një sërë ngjarjesh të rëndësishme, drejtoi organet udhëheqëse të Partisë.

5

1, 3. Në Kongresin e 3-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Prill 1984. **2,4.** Në Koncertet e Majit 1984. **5.** Me shokun Ramiz Alia në Drilon. Verë e vitit 1984.



1

2

3

1-3. Në mbledhjen solemne për 40-vjetorin e Çlirimit të atdheut. 28 Nëntor 1984. **4-5.** Në paradën ushtarake dhe manifestimin e popullit të kryeqytetit më 29 Nëntor 1984.

Më 29 Nëntor 1984 populli shqiptar festoi 40-vjetorin e Çlirimit e të fitores së revolucionit popullor. Në katër dekadat e socializmit Shqipëria kishte realizuar transformime të tilla revolucionare që kishin bërë të mundur kapërcimin e shekujve të shtypjes, prapambetjes, errësirës. Lufta heroike e Partisë dhe e popullit shqiptar, fitoret e arritura në këta 40 vjet qenë të lidhura ngushtë me emrin e Enver Hoxhës, me mendimin e Tij marksist-leninist, me veprimtarinë e Tij të gjithanshme në krye të Partisë e të shtetit. Ai

4

5

ka qenë formuluesi kryesor i strategjisë së Partisë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe i programit të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Përshëndetja që i drejtoi Enver Hoxha popullit shqiptar në këtë datë të shënuar përmban sintezën e luftërave heroike, fitoreve të mëdha, të cilësive të larta e virtyteve të shquara që e kishin dalluar në shekuj kombin shqiptar. T'i ruajmë si sytë e ballit atdheun dhe fitoret e t'i çojmë ato më tej, kjo ishte porosia e Enverit. Ky ishte amaneti i madh që u la Ai Partisë, popullit, të gjithë brezave të kombit.

Portret i nëntorit 1984.



1

2

1. Gjatë punimeve të sesionit të Kuvendit Popullor. Dhjetor 1984. **2.** Mes shokëve e bashkëluftëtarëve. Nëntor 1984. **3.** Janar 1985. **4.** Çast pune. **5.** Me motrat, Sanon e Haxhon. **6.** Me djalin, Ilirin dhe nipin e porsalindur. **7.** Me djalin, Sokolin. **8.** Me njerën nga mbesat.

Në fund të vitit 1984 gjendja shëndetësore e shokut Enver Hoxha, si pasojë e sëmundjes së diabetit, e moshës dhe e ngarkesës së jashtëzakonshme mendore e fizike që kishte përballuar, u rëndua. Edhe në këtë periudhë me kurajë e optimizëm, me vullnet të papërkulur Ai bëri gjithçka që deri në çastet e fundit të jetës të punonte për çështjen e Partisë e të popullit. Në muajt janar e shkurt merr pjesë e drejton mbledhje të Byrosë Politike e të Plenumit të Komitetit Qendror, orienton për probleme korente e të perspektivës. Dëshira e Tij më e madhe është që të rikthehet tërësisht në veprimtarinë e pandërprerë krijuese e udhëheqëse, aq të dobishme për atdheun e popullin. Por, në mëngjesin e 9 prillit 1985, papritur goditet nga një arrest kardiak. Mjekimi intensiv, kujdesi i jashtëzakonshëm i mjekëve nuk mundën të riparojnë pasojat e pakthyeshme që shkaktoi kjo goditje. Më 11 prill 1985, në orën 02 të mëngjesit, zemra e Enver Hoxhës pushoi së rrahuri.

3



4

5



6

7



8

6 prill 1985.

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ZERI i POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Nr. 87 (11.457) E premte, 12 prill 1985

Jeta dhe vepra o shokut Enver Hoxha është historia e gjallë e Shqipërisë së sotme. Emri i Tij është i lidhur me të gjitha betejat klasore dhe me të gjitha fitoret e Partisë e të popullit shqiptar.

DHIMBJE E THELLE PER PARTINE E GJITHE POPULLIN SHQIPTAR

VDIQ UDHEHEQESI YNE I DASHUR SHOKU ENVER HOXHA

Vendim mbi krijimin e komisionit për organizimin e varrimit të shokut Enver Hoxha

KOMUNIKATE MJEKESORE

1

2

3

4

5

1

2

3

4

1-2. Në mitingun e përmortshëm të popullit të Tiranës. 15 prill 1985. **3-5.** Në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

1. Udhëheqësit e Partisë e të shtetit nderojnë mësuesin dhe shokun e shtrenjtë. **2-4.** Në ditët e dhimbjes së thellë. **5.** Duke dëgjuar lajmin e hidhur. 11 prill 1985.

LAVDI PARTISE SE PUNES TE SHQIPERISE
JEMI PIONIERE TE ENVERIT

5

''E tërë jeta e ndërgjegjshme e shokut Enver Hoxha ka qenë luftë. Luftë për lirinë e atdheut, luftë për ndërtimin e socializmit, luftë për emancipimin e popullit, luftë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm që kërkonin të na kthenin mbrapsht në skllavërinë e mëparshme. Ashtu siç qëndroi në ballë të betejave e të përleshjeve të Luftës Nacionalçlirimtare, po ashtu me një guxim të rrallë politik e pjekuri të thellë ideologjike e udhëhoqi Partinë e popullin në ndeshjet me komplotet, presionet e ndërhyrjet e shumta të armiqve gjatë këtyre 40 vjetëve të jetës sonë socialiste... Shoku Enver Hoxha është arkitekt i Shqipërisë së re, organizator dhe udhëheqës i drejtpërdrejtë i gjithë atyre transformimeve revolucionare që janë bërë pas Çlirimit, frymëzues i gjithë atyre veprave monumentale që ia kanë ndryshuar pamjen vendit tonë''.

RAMIZ ALIA

15 prill 1985.

Përherë pranë Enverit. Prill 1986.

Pionierët e Enverit.

''Ta ruajmë si sytë e ballit gjithçka kemi arritur, ta zhvillojmë me konsekuencë më tej, t'u lëmë brezave të ardhshëm një Shqipëri kurdoherë e më të fortë, kurdoherë të kuqe, si flakë e pashuar e zemrave dhe e idealeve komuniste e partizane, një Shqipëri që të rrojë e të përparojë në shekuj. Jam i bindur se populli e Partia lart e më lart do ta mbajnë flamurin tonë fitimtar, lart e më lart do ta ngrenë nderin, prestigjin dhe emrin e Shqipërisë socialiste në botë''.

Enver Hoxha

LART FRYMEN REVOLUCIONAR

FOTOGRAFITE

ARKIVI QENDROR I PPSH
(Fotot me ngjyra Sulo Gradeci, Dashnor Andoni)
AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE
ARKIVI I MINISTRISE SE MBROJTJES POPULLORE
Jani Ristani
Petrit Kumi
Mehmet Kallfa
Mihal Progonati
Petrit Omeri

PERPUNIMI FOTOGRAFIK

LABORATORI FOTOGRAFIK I AQP
(Katjusha Ushtelenca, Abedin Musabelliu)
LABORATORI QENDROR I SHERBIMIT TË SHTYPIT I ATSH

NDIHMUAN PER PERGATITJEN E MAKETIT TE ALBUMIT
Shtëpia Botuese "8 Nëntori"
Kombinati Poligrafik

Viti i botimit - 1986
TIRAZHI 25000 kopje